
Vlerësim i Përbashkët për Vendin

Shqipëria



2002

Vlerësim i Përbashkët për Vendin

Shqipëria

Përgatitur për Sistemin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE)
Tiranë, Qershor 2002

Kopertina:
Kel Marubi, "Pamje nga Boga", Shqipëria e Veriut, vitet 1900 – 1919

Nicolas Philips
Editor i Versionit në Gjuhën Angleze

E drejta e autorit:
Informacioni i përfshirë në këtë raport nuk i nënshtrohet të drejtës së autorit. Megjithatë, në rastet e përdorimit të këtij informacioni, kërkohet të tregohet qartë autorësia e burimit.

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
Rr: "Ismail Qemali", P 34/1, Kati i 5, Ap. 4
Kutia Postare 2934, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 225021; 229069; 259637
Fax: +355 4 225021
E-Mail: zpreci@interalb.net
Http://www.acer.org.al

Ky Raport mund të gjendet edhe në Internet në adresën:
http://www.undp.org.al

Design & Shtypi: Studio "Klevis-AS" & "albPAPER" shpk.

UN Resident Coordinator
Rr: "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Nr.35, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 233148-9
Fax: +355 4 232 075
E-mail: registry.al@undp.org
Http://www.undp.org.al

1 PERMBLEDHJE 5

2 HYRJE 9

2.1 Një Vështrim i Shpejtë mbi Shqipërinë 9
2.2 Çfarë është Vlerësimi i Përbashkët për Vendin? 11
2.3 Metodologjia 11
2.4 Çfarë është Siguria Njerëzore? 12
2.5 Kostot e Tranzicionit në Shqipëri dhe Rajoni 12
2.6 Pamje e Përgjithshme Makroekonomike 13
2.7 Kuadri i Planifikimit Kombëtar dhe Rajonal 14
2.8 Kapërcimi i Mendësisë së Krizës 15

3 SIGURIA EKONOMIKE 17

3.1 Varferia 17
3.2 Migrimi 24

4 BARAZIA E SIGURISË SË MUNDËSIVE 29

4.1 Fuqizimi i Gruas 29
4.2 Diskriminimi i Pakicave 33
4.3 Femijët në Kushte të Pafavorshme 35

5 SIGURIA SOCIALE 41

5.1 Sistemi i Sherbimit Shendetesor 41
5.2 Sistemi i Arsimit 48

6 SIGURIA E MJEDISIT 53

6.1 Mjedisi Natyror 53
6.2 Infrastruktura Dhe Sherbimet Baze 56

7 SIGURIA PERSONALE 61

7.1 Krimi i Organizuar 61
7.2 Trafikimi dhe Kontrabanda me Njerëzit 63
7.3 Shtimi i Armeve te Vogla 66
7.4 Sistemi i Strehimit të Imigrantëve 69

8 SIGURIA POLITIKE 73

8.1 Korrupsioni 73
8.2 Fuqizimi i Institucioneve 76

9 PERFUNDIME 85

10 SHTOJCAT 87

10.1 Treguesit 87
10.2 Referimet 103
10.3 Perberja dhe Organizimi i Grupeve Tematike 108
10.4 Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Internet 108
10.5 Adresat e Tjera me Interes në Internet 109
10.6 Shkurtimet 110

1 Përmbledhje

Cilat janë sfidat me të cilat përballen shqiptarët në rrugën e tyre drejt sigurisë dhe zhvillimit, në nivel lokal dhe kombëtar? Cilat janë modelet dhe prirjet që po shfaqen? Çfarë shkaqesh rrënjësore qëndrojnë mbrapa simptomave? Dhe më e rëndësishmja, si mund të nxiten qytetarët dhe institucionet e interesuara që të punojnë për zbutjen e varfërisë, të pakësojnë pabarazinë e vazhdueshme dhe të arrijnë një zhvillim njerëzor të qëndrueshëm?

Ky Vlerësim i Përbashkët për Vendin (VPV) Shqipëria 2002, është një përpjekje e përbashkët e agjencive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri-me mbështetjen e përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare dhe Shoqërisë Civile-për të analizuar këto çështje dhe për të shkuar drejt një qëndrimi të përbashkët. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE), një OJQ lokale, koordinoi bashkëpunimin, kërkimet dhe raportin përfundimtar.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Koffi Annan, ka autorizuar krijimin e raporteve të VPV në çdo vend ku janë të pranishme Kombet e Bashkuara, si pjesë e një procesi reformash për të patur një koherencë më të madhe në veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara brenda secilit vend. Shpresohet se VPV do të jetë një mjet i vlefshëm referimi, një platformë për përpunimin e programeve dhe të politikave dhe një nxitës për bashkëpunimin e mëtejshëm midis Kombeve të Bashkuara dhe partnerëve të saj të zhvillimit.

VPV është ndërtuar prej 10 kapitujsh dhe diskutimi i problemeve kyçe të zhvillimit bëhet në kapitujt 3 deri 8. Këto probleme janë grupuar në kapituj sipas kuadrit të Sigurisë Njerëzore, një koncept që thekson rëndësinë e aftësimit të njerëzve për të përdorur burimet dhe për të marrë vendime, duke qenë të lirë nga shtrëngimet dhe nga frika për ta humbur këtë aftësi në të ardhmen. Çdo kapitull i Sigurisë Njerëzore vë në dukje konventat dhe marrëveshjet botërore të pranuara nga Shqipëria, veçanërisht mbi Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs), që janë një grup synimesh kryesore të zhvillimit, të pranuara në vitin 2000 nga 191 vendet e përfshira, të cilat duhen përmbushur deri në vitin 2015.

KAPITULLI 2: HYRJE: "Një vështrim i Shpejtë mbi Shqipërinë" jep një pamje të shkurtër të bazuar në treguesit gjeografikë, demografikë, qeveritarë dhe të zhvillimit. Ai plotësohet nga statistika të kombinuara me tekste dhe pasqyra në Shtojca, veçanërisht Pasqyra 1 e Treguesve Kryesorë të VPV. "Çfarë është Vlerësimi i Përbashkët për Vendin", "Metodologjia" dhe "Çfarë është Siguria Njerëzore"? janë shtjelluar në paragrafët e mësipërm. "Kostot e Tranzicionit në Shqipëri dhe Rajoni" i vendosin problemet e zhvillimit të Shqipërisë në kuadrin e forcave historike dhe politike në rajon dhe tërheqin vëmendjen mbi rolin kritik të Institucioneve Shtetërore në harmonizimin dhe mbështetjen e efektivitetit dhe barazisë së institucioneve të tregut, duke ndërtuar Sigurinë Njerëzore dhe duke nxitur rritjen ekonomike.

"Pamja e Përgjithshme Makroekonomike" hedh shikimin mbi prirjet konkrete ekonomike në Shqipëri që nga fillimi i tranzicionit drejt një sistemi tregu në fillimet e viteve 1990, duke përfshirë rënien e menjëhershme të industrisë dhe mbizotërimin e bujqësisë në ekonomi. Vetëm kohët e fundit Shqipëria ka arritur një nivel prodhimi ekonomik të krahasueshëm me nivelin e para-tranzicionit. "Kuadri i Planifikimit Rajonal dhe Kombëtar" trajton zotimin e Qeverisë Shqiptare për një Strategji të Rritjes Ekonomike dhe të Uljes së Varfërisë (GPRS), Paktin e Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore dhe anëtarësimin e mundshëm në Bashkimin Evropian nëpërmjet Procesit të Stabilizim-Asociimit. "Kapërcimi i Mendësisë së Krizës" tregon nevojën për qëndrime pozitive dhe veprime parandaluese, si dhe sugjeron se suksesi i mëparshëm në fushën e rritjes ekonomike, ndërtimin e institucioneve dhe shtimin e lirive personale, duhet ndjekur nga

përpjekjet për të përmirësuar barazinë, aftësinë ekzekutuese të institucioneve dhe strukturën shoqërore.

KAPITULLI 3: SIGURIA EKONOMIKE: Ky seksion fillon me një vështrim shumë-dimensional mbi "Varfërinë" dhe shkallën e lartë të "Migrimit" të brendshëm dhe të jashtëm. Pasojat me luhatje të reformave strukturore kanë përkeqësuar normat e varfërisë, që janë më të larta në zonat rurale dhe që priren të mbështeten në bujqësinë sa për të mbajtur veten; fermerët që kanë prodhime të tepërta kanë vështirësi në shitjen e prodhimeve për shkak të praktikave jokonkurruese dhe rrjeteve të dobëta të transportit. Disa familje të zonave rurale i plotësojnë të ardhurat e tyre me të hollat e dërguara nga punonjësit migrantë dhe nga ndihma ekonomike relativisht e ulët, e siguruar nga Qeveria. Shërbimet bazë, shërbimi parësor shëndetësor dhe arsimor kanë pësuar rënie gjatë periudhës së tranzicionit, ndërsa punonjësit e kualifikuar së bashku me banorët e zakonshëm vazhdojnë të shpërngulen drejt qendrave dhe periferive urbane, duke shtuar ngarkesën mbi mangësitë e ndjeshme ekzistuese në shërbimet sociale dhe infrastrukturën e këtyre zonave. Trajtimi i ekonomisë së gjerë informale, futja në punë e të ardhurave nga emigrantët dhe mbështetja e bujqësisë ofrojnë shpresë për nxitjen e rritjes ekonomike të të varfërve, si dhe masat siç janë iniciativat e mikrokredisë dhe përpjekjet për të ulur rreziqet dhe përmirësuar arsimin. Raporti i emigrimit të paligjshëm ndaj atij të ligjshëm duket se po pëson rënie, por vazhdon të ketë pasoja serioze mbi komunitetet pritëse dhe mbi vetë emigrantët. Përmirësimi i mundësive ekonomike, shërbimeve, infrastrukturës dhe nxitësve për t`u kthyer janë shpresa më e mirë për ngadalësimin dhe stabilizimin e mundshëm të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm.

KAPITULLI 4: BARAZIA E SIGURISË SË MUNDËSIVE: "Fuqizimi i Gruas", "Diskriminimi i Pakicave" trajtojnë përkeqësimin e gjendjes së grave dhe të romëve gjatë periudhës së tranzicionit, kur u hoqën garancitë e punësimit, u rrit varësia ekonomike e grave dhe u ringjallën rolet patriarkale të gjinive dhe stereotipat tradicionalë. Shumë gra vuajnë nga dhuna në shtëpi dhe kanë pak fuqi vendim-marrëse, ndërkohë që informacioni i besueshëm tregon se shumë romë gjenden në fund të tabelave me treguesit social-ekonomikë si një nga grupet më të rrezikuara të shoqërisë Shqiptare. "Fëmijët në Kushte të Pafavorshme" hedh vështrimin mbi fëmijët e paaftë, fëmijët e mbyllur për edukim në institucione fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët e pastrehë dhe punën e fëmijëve. Për shkak të qëndrimit të përgjithshëm dhe moszbatimit të ligjit mbi masat mbrojtëse të fëmijëve, të drejtat e fëmijëve në këto grupe nuk respektohen plotësisht. Këta fëmijë në kushte të pafavorshme kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave të tyre arsimore dhe zhvilluese, duke penguar kështu zhvillimin afatgjatë të Shqipërisë.

KAPITULLI 5: SIGURIA SOCIALE: "Sistemi i Shërbimit Shëndetësor" dhe "Sistemi i Arsimit" janë gjendur në kushte të ngjashme gjatë periudhës së tranzicionit, duke përfshirë një rënie të cilësisë për shkak të burimeve të pamjaftueshme, infrastrukturës së vjetër dhe largimit të punonjësve të kualifikuar; si dhe një rënie të mundësisë për t'i shfrytëzuar për shkak të presioneve të migrimit të shpejtë dhe një praktikë së ryshfeteve, që ua mohon shërbimin atyre që nuk mund të paguajnë. Buxheti i shërbimeve po rritet, por proceset e decentralizimit dhe privatizimit duhen monitoruar duke u nisur nga këndvështrimi i grupeve të pambrojtura. Shëndeti publik po kërcënohet nga normat e larta të vdekshmërisë foshnjore dhe të nënave, rritja e përdorimit të drogës, përdorimi jo i shpeshtë i kontraceptivëve, varësia e shpeshtë nga abortet për planifikimin familjar dhe njohuritë e dobëta mbi infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS, që mund të rriten shpejt për shkak të sjelljes së disa grupeve me rrezik të lartë. Institucionet arsimore kanë nevojë për klasa më të përshtatshme, disa ndryshime në programet mësimore, një sistem kualifikimi për mësuesit, një ndjekje më të madhe të arsimit para-shkollor dhe masa për reduktimin e braktisjes së shkollës.

KAPITULLI 6: SIGURIA E MJEDISIT: Njerëzit varen nga siguria dhe dobishmëria e mjedisit të tyre, që nga furnizimi me ujë të pijshëm e deri në rrjetet rrugore të papërshtatshme. Si "Mjedisi Natyror" ashtu dhe "Infrastruktura dhe Shërbimet Bazë" janë jetike për shëndetin publik, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunitetit dhe potencialin e veprimtarive si turizmi i zakonshëm dhe ekoturizmin. Ministria e Re e Mjedisit dhe partnerët e saj duhet të merren me ndotjen e ajrit, tokës dhe të ujit, gërryerjen e tokës, peshkimin e pakontrolluar dhe rënien e biodiversitetit, si dhe prerjet e paligjshme të pyjeve, duke zbatuar ligje më të mira dhe duke

nxitur praktika më të qëndrueshme në fushat e trajtimit të mbeturinave, lëshimit të gazeve në ajër dhe zgjerimit të vendbanimeve. Kapërcimi i mungesave kronike të energjisë në dimër, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugëve dytësore dhe të dorës së tretë, pas plotësimit të korridoreve kryesore Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim, ulja e kostos dhe zgjerimi i telekomunikimeve e shërbimeve të Internetit, si dhe përmirësimi i sigurimit të shërbimeve bazë, duke patur parasysh problemet afatgjata të mjedisit.

KAPITULLI 7: SIGURIA PERSONALE: Ngjarjet e shkaktuara nga mungesa e stabilitetit rajonal dhe mungesës së ligjit i kanë dobësuar institucionet e rendit publik dhe kanë rritur kërcënimet ndaj sigurisë personale. Ky seksion përqendrohet në rritjen e "Krimit të Organizuar" dhe "Trafikimit dhe Kontrabandës me Njerëzit" si disa nga kërcënimet më të mëdha të sigurisë personale, ku zyrtarët publikë janë të përfshirë ndonjëherë dhe ku bashkëpunimi ndërkombëtar është i nevojshëm. Trafikimi, si një veprimtari që përfshin grabitjen dhe mashtrimin, dallohet nga kontrabanda si një shërbim i paguar për një hyrje të paligjshme në një vend.

"Shtimi i Armëve të Vogla" tregon se si mundësia për të patur armë të vogla rrit mundësinë për dhunë dhe si përpjekjet e suksesshme për mbledhjen e këtyre armëve kanë çuar në uljen e kriminalitetit dhe përmirësimin e jetesës së njerëzve, duke iu dhënë atyre një ndjenjë sigurie. "Sistemi i Strehimit të Imigrantëve" trajton pozicionin e Shqipërisë si një vend destinacioni dhe tranzit për migrantët e parregullt. Ky kapitull përshkruan vështirësinë në ofrimin e mundësive për integrim lokal të tyre dhe trajton përpjekjet për të krijuar aftësinë për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare ndaj kërkuesve të strehimit.

KAPITULLI 8: SIGURIA POLITIKE: Në këtë seksion, "Korrupsioni" trajton faktin se si mungesa e transparencës dhe përgjegjshmërisë është shfaqur si një nga pengesat më të mëdha në zhvillimin e Shqipërisë, pasi shkakton humbjen e burimeve dhe çon në vendime joefektive, u kushton shumë individëve dhe bizneseve, si dhe ul të ardhurat e shtetit. Korrupsioni rrezikon të rritet deri në pikën e përfshirjes në kulturë, nëse nuk kontrollohet shpejt, duke kufizuar fuqinë e njerëzve dhe të institucioneve dhe kthehet në nxitjen për t`u marrë me praktikat e korrupsionit. Ulja e korrupsionit kërkon një zotim me fjalë dhe me vepra nga të gjithë elementet e shoqërisë shqiptare për zbatimin e nismave të reja anti-korrupsion. "Fuqizimi i Institucioneve" trajton zhvillimet më të fundit në përmirësimin e mëtejshëm të Institucioneve Demokratike, Sistemit Gjyqësor, Procesit të Decentralizimit, Shërbimit Publik, Mediave dhe Shoqërisë Civile. Këtu parashtrohet se si këto grupe, institucione dhe procese mund të bëhen më të përgjegjshme, më transparente, efektive, si dhe të ndërgjegjshme ndaj nevojave të shtetasve, si një kërkesë e domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm.


KAPITULLI 9: PËRFUNDIME: Ky seksion rithekson rëndësinë e konsolidimit të arritjeve që janë bërë gjatë periudhës së tranzicionit deri tani, ndërkohë që kërkohet zgjerimi i përfitimeve për një pjesë më të gjerë të popullsisë duke përfshirë më të dobëtit, përmirësimi i funksionimit të institucioneve dhe edukimi me ndjenjën e bashkësisë. Nëpërmjet një qëndrimi bashkëpunues ndaj procesit në vazhdim të vlerësimit, analizës dhe të zhvillimit të politikave kombëtare, duke përfshirë këtë VPV dhe të dhënat e ardhshme në VPV, Kombet e Bashkuara dhe partnerët e saj në Qeveri dhe në Shoqërinë Civile mund ta gjejnë pozicionin e tyre, ku secili mund të përdorë aftësinë e tij për të mbështetur Sigurinë Njerëzore dhe Zhvillimin në Shqipëri. Ky seksion ndiqet nga **KAPITULLI 10: SHTOJCAT** që përmbajnë "Treguesit" për të plotësuar statistikat e cituara në tekst, dhjetëra "Referime" – shumë nga të cilat kanë lidhje Interneti, për të lehtësuar kërkimet e mëtejshme, si dhe një listë "Shkurtimesh" të përdorura në tekst.

2 Hyrje

KY KAPITULL PËRFSHIN:

- Një Vështrim i Shpejtë mbi Shqipërinë
- Çfarë është Vlerësimi i Përbashkët për Vendin?
- Metodologjia
- Çfarë është Siguria Njerëzore?
- Kostot e Tranzicionit në Shqipëri dhe Rajoni
- Pamje e Përgjithshme Makroekonomike
- Kuadri i Planifikimit Rajonal dhe Kombëtar
- Kapërcimi i Mendësisë së Krizës

Kjo hartë është dhënë nga UNHCR Shqipëri dhe nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e Kombeve të Bashkuara lidhur me statusin ligjor të vendit, të territorit, të qytetit apo zonës, të organeve të tyre ose me përcaktimin e kufijve.



2.1 Një Vështrim i Shpejtë mbi Shqipërinë

Rrënjët e popullit shqiptar gjenden në fiset e njohura si Ilirët, të cilët u vendosën në Ballkan rreth 2000 vjet para erës së re. Shqipëria ra nën sundimin e fuqive të huaja që në vitin 165 para erës së re, kur u bë pjesë e Perandorisë Romake deri ne vitin 1912, kur Shqipëria fitoi pavarësinë nga Perandoria Osmane.[1] Pas Luftës së Dytë Botërore (Dita e Çlirimit është 29 Nëntor 1944) Shqipëria u bë një shtet diktatorial i izoluar, deri në vitin 1990 kur u bashkua me vendet e tjera në tranzicion, në rrugën drejt një qeverie demokratike dhe ekonomisë së tregut. Pengesa dolën gjatë trazirave të vitit 1997 dhe gjatë krizës së refugjatëve Kosovarë të vitit 1999. Forca të fuqishme e pengojnë zhvillimin e Shqipërisë, siç janë shkalla e lartë e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, përhapja e korrupsionit dhe të ardhurat e ulta shtetërore. Ato kanë një ndikim shumë të madh mbi përdorimin dhe cilësinë e shërbimeve, duke përfshirë shërbimin shëndetësor dhe atë arsimor. Pabarazitë e mëdha e ndërlikojnë më tej zhvillimin në kuptimin e pabarazisë së të ardhurave, marrëdhënieve ndërmjet burrave dhe grave, ndryshimeve ndërmjet zonave rurale e urbane dhe gjendja e rëndë e disa grupeve në pozita të vështira.

[1] Shënim historik: Profili i Shqipërisë, Departamenti i Shtetit i ShBA, 2002. http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/. Shifrat janë marrë gjithashtu edhe nga: Rezultatet Paraprake të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001, INSTAT, 2001; Femrat dhe Meshkujt , INSTAT, Dhjetor 2001.

Territori

Pozita Gjeografike Shqipëria ndodhet në rajonin jug-perendimor të Gadishullit Ballkanik; e kufizuar nga Deti Adriatik dhe Jon, (362 km vijë bregdetare); me Greqinë në Juglindje, nga Mali i Zi në Veriperëndim (pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë[2]), nga Kosova në Verilindje (sot një territor i administruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara) dhe nga Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në Lindje. (1,094 km kufi)

Sipërfaqja 28,748 km²

Gjeografia fizike Pjesa më e madhe përbëhet nga male (28%) dhe kodra (47%); fusha të vogla (25%) përgjatë bregdetit; Pika më e ulët: Deti Adriatik 0 m; Pika më e lartë: Maja e Korabit (Golem Korab) 2,753 m

Populisia

Populisia 3.087 milion

Dendësia e Populisisë 113.3 banorë për km²

Shtesa Natyrore e Populisisë 0.88%

Struktura Sociale Demografike 42% e populisisë jeton në zona urbane, ndërsa 58% në zona rurale.

Gjuha Zyrtare Shqip, dialekti toskë

Shteti

Emri Zyrtar Republika e Shqipërisë

Qytetet më të Mëdha Tirana (kryeqyteti, 700,000); Të tjerë: Durrës (400,000), Shkodër (81,000), Vlorë (72,000)

Sistemi Politik Demokraci Parlamentare; Kushtetuta e miratuar nga referendumi popullor 28 Nëntor 1998.

Degët Ekzekutivi: Presidenti (kryetar shteti)
Kryeministri (kryetari i Qeverisë)
Këshilli i Ministrave (kabineti)
Legjislativi: Kuvendi Popullor me 140 vende, (afat kohor 4-vjeçar)
Gjyqësori: Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Kasacionit, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e rretheve

Ndarja Administrative dhe Territoriale Vendi ndahet në 12 Rajone/Prefektura si dhe 36 + 1 Rrethe (Bashkia e Tiranës ka status rrethi). Janë 65 Bashki dhe 309 Komuna

Zhvillimi Social dhe Njerëzor

Shkalla e Treguesit të Zhvillimit Njerëzor (2001) Rradhitet e 85ta ndër 162 vende

PBB për frymë Në vitin 2000 PBB-ja për frymë ishte 1,094 dollarë, ku bujqësia zinte më shumë se gjysmën (51%)

Shkollimi 88% në vitin 2000

Papunësia 14.4% në vitin 2001

Varfëria 46.6% e shqiptarëve jetojnë nën kufirin e varfërisë të 2 USD për frymë në ditë, ndërsa 17.4% jetojnë nën kufirin e varfërisë së 1USD për frymë në ditë

Zgjatja mesatare e Jetës 76.4 vjeç femrat, 71.7 vjeç meshkujt

Vdekshmëria Foshnjore 28 (për 1000 lindje të gjalla) në vitin 2000

[2] Përfaqësues të Serbisë dhe Malit të Zi vendosën më 14 Mars 2002 të ndryshonin emrin e shtetit të tyre të përbashkët nga 'Republikë Federale e Jugosllavisë' në 'Serbi dhe Mal i Zi". Por në kohën kur u shkrua ky VPV vendimi nuk ishte miratuar akoma nga Parlamenti i Serbisë dhe i Malit të Zi.

2.2 Çfarë është Vlerësimi i Përbashkët i një Vendi (VPV)?

Procesi i VPV është një mundësi për agjencitë e Kombeve të Bashkuara brenda një vendi për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe

Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin

- Çrrënjosja e urisë dhe varfërisë ekstreme
- Arsimimi fillor i përgjithshëm
- Promovimi i barazisë midis gjinive dhe fuqizimi i gruas.
- Ulja e vdekshmërisë foshnjore.
- Përmirësimi i shëndetit të nënës.
- Luftimi i HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera.
- Sigurimi i mirëmbajtjes së mjedisit.
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim

Shënim: Objektivat specifik janë shtjelluar në kapitujt përkatës.

me përfaqësuesit e Qeverisë e të Shoqërisë Civile, për të përgatitur për Kuadrin e Ndihmës së Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDAF) dhe për të vlerësuar dhe analizuar çështjet kyçe të zhvillimit të dialogut këshillimor dhe politik.[3] Është pjesë e paketës së reformave të filluara nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve Të Bashkuara Koffi Annan në vitin 1997 për të krijuar një koherencë më të lartë në Kombet e Bashkuara. Struktura e raportit të VPV pasqyron metodologjinë e filluar nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Vend (UNCT) dhe përmbajtja pasqyron temat e Sigurisë Njerëzore, strategjitë kombëtare, rolin e Kombeve të Bashkuara dhe zotimet ndërkombëtare, veçanërisht Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin[4] dhe Konventat kryesore të të Drejtave të Njeriut.

2.3 Metodologjia

2.3.1 PËRGATITJA

UNCT u mblodh në fillimin dhe mesin e vitit 2001 dhe punoi me përfaqësuesit e agjencisë së Kombeve Të Bashkuara për të hartuar një listë të çështjeve të zhvillimit për përfshirje në VPV, për të përgatitur kuadrin e referimit dhe planifikuar një afat kohor. Sesioni i parë me diskutime i Kryetarëve të Agjencive nxori si sfidat kryesore për zhvillim: Pabarazia e Gjinisë dhe e Grupmoshave, Të Ardhurat, Ekonomia e Zezë, Institucionet e Dobëta, Korrupsioni, Migrimi/ Emigrimi, Varfëria, Trafikimi i Njerëzve, Armët, Droga, Papunësia dhe Infrastruktura.

Më pas u shqyrtuan çështjet dhe përfaqësuesit e agjencisë së Kombeve të Bashkuara u grupuan në dy grupe tematike: "Qeverisja Demokratike" dhe "Siguria Njerëzore". Çështjet e Qeverisjes Demokratike ishin Forcimi i Ligjit, Institucionet e dobëta, Administrata Publike dhe Reformat në Shërbimin Civil,

6 Konventat e të Drejtave të Njeriut me Raportimin e Detyruar të Vendit

- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial
- Konventa Ndërkombëtare kundër Torturës
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të Gruas
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve

Decentralizimi dhe Pushteti Lokal, Drejtësia, Infrastruktura, Integrimi dhe Gatishmëria në raste emergjence. Çështjet e Sigurisë Njerëzore ishin Varfëria, Punësimi, Fëmijët që Punojnë, Barazia mes Gjinive dhe Fuqizimi i Gruas, Arsimi, Shëndeti, Krediti Rural dhe Mjedisi.

Të dy grupet tematike përgatitën një kornizë të përshtatshme, me tregues sasiorë dhe cilësorë për secilën çështje. UNCT vendosi të caktojë një Këshilltar Kombëtar dhe të monitorojë 11 OJQ lokale dhe individë në Shtator 2001. Qendra Shqiptare Për Kërkime Ekonomike (QShKE) u zgjodh për të koordinuar procesin, që të bërë punën kërkimore dhe përgatitur raportin. Agjencitë e Kombeve të Bashkuara i kryen përgatitjet gjatë dy takimeve të Grupeve Tematike dhe më pas u kërkuan Ministrive të sigurojnë pikat më të rëndësishme për analizat e ardhshme.

2.3.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE E INFORMACIONIT

Me ndihmën e agjencive të Kombeve të Bashkuara, Këshilltari Kombëtar mblodhi të dhëna, në fundin e vitit 2001 dhe në fillimet e vitit 2002, nga burime të publikuara, elektronike si dhe direkt nga Ministritë dhe Instituti Kombëtar i Statistikave (Instat).

[3] Udhëzimet për VPV, Kombet e Bashkuara, 1999. http://rescoor.undp.org.tt/INITIATIVES/English-VPV.pdf
[4] Një zotim i marrë nga 191 vende në vitin 2001 për të arritur 8 objektiva kryesore, deri në vitin 2015.

2.3.3 VLERËSIMI DHE ANALIZA

Kërkimet u paraqitën nga Këshilltari Kombëtar në një total prej 8 takimesh të dy Grupeve Tematike, ku përfaqësuesit e agjencive të Kombeve të Bashkuara vlerësuan cilësinë e të dhënave empirike dhe domethënien e prirjeve të vrojtuara. Gjithashtu, Këshilltari Kombëtar përdori intervista të fokusuara në çështjet e Shoqërisë Civile, Qeverisë dhe përfaqësuesve të agjensive të Kombeve të Bashkuara mbi një bazë individuale. Në janar të vitit 2002 u mblodhën në një Seminar delegatë dhe të ftuar nga këta tre sektorë, për të thelluar idetë, analizat dhe rekomandimet në VPV, duke bërë analizën e këtyre katër çështjeve që kryqëzohen: Shkalla e Lartë e Migrimit të Brendshëm dhe të Jashtëm, Mungesa e Pjesëmarrjes në Shoqëri, Korrupsioni dhe Krimi i Organizuar.

2.3.4 HARTIMI I DOKUMENTIT TË CCA

Nga dhjetori 2001 deri në qershor 2002, Këshilltari Kombëtar përgatiti një sërë projektesh, që u shpëndanë me e-mail, gjendeshin në faqen e Internetit të UNDP dhe u paraqitën në Seminar. Projektet paraqitnin kontributin e fituar gjatë Takimeve të Grupeve Tematike, reagimin e pjesëmarrësve të VPV, shënimet nga intervistat këshillimore, paraqitjet e bëra nga grupet e caktuara në përfundim të Seminarit dhe rishikimet nga UNCT. Pjesëmarrësit e VPV vendosën Sigurinë Njerëzore si temën gjithëpërfshirëse, përderisa mbulonte pjesërisht edhe Qeverisjen Demokratike dhe është një koncept më i njohur, që do të rrisë koherencën e dokumentit dhe rëndësinë për sistemet e Kombeve të Bashkuara.

2.4 Çfarë është Siguria Njerëzore?

Zhvillimi Njerëzor është procesi i zgjerimit të aftësisë së njerëzve pë të zgjedhur midis mundësive që ata vlerësojnë, ndërsa Siguria Njerëzore nënkupton që njerëzit mund t'i bëjnë zgjedhjet lirisht pa frikën e humbjes në të ardhmen të mundësive që aktualisht kanë.[5]

Koncepti i Sigurisë Njerëzore, fillimisht, u përmend në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1945 dhe u zgjerua më tej në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të vitit 1994 (HDR). Ka një ndryshim duke e zhvendosur theksin nga sigurimi i territorit nëpërmjet armatimit tek sigurimi i njerëzve nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm.

Shumë kërkues nga bota dhe nga Qeveritë e Japonisë dhe Kanadasë në veçanti, kanë vënë re lidhje të fuqishme dhe dallime të rëndësishme

7 Përmasat e Përgjithshme të Sigurisë Njerëzore, të identifikuara nga UNDP në vitin 1994

- Siguria Ekonomike
- Siguria e Ushqimit
- Siguria e Shëndetit
- Siguria e Mjedisit
- Siguria personale nga dhuna dhe krimi
- Siguria e bashkësisë
- Siguria Politike

ndërmjet Sigurisë Njerëzore dhe Zhvillimit Njerëzor; Zhvillimi Njerëzor priret ta bëjë të përparojë Sigurinë Njerëzore dhe anasjelltas, ndërsa një pjesë e caktuar e Sigurisë Njerëzore mund të konsiderohet një kusht paraprak i Zhvillimit Njerëzor. Kthimet prapa të çdonjërës do të pengonin tjetrën.

Në Shqipëri janë të shumta kërcënimet ndaj Sigurisë Njerëzore, por shumica e tyre përmblidhet në 7 kategori të përshkruara në HDR e vitit 1994. 6 kategori u zgjodhën si kuadër analizash për çështjet e diskutuara në këtë Vlerësim të Përbashkët të Një Vendi për Shqipërinë, me disa përshtatje të vogla. Siguria e Shëndetit u vendos në kategorinë e gjerë të Sigurisë Sociale për të përfshirë çështjen kryesore të Arsimit;[6] përcaktimi i Sigurisë së Mjedisit u zgjerua për të përfshirë Infrastrukturën; çështjet e ndërthurura të Fuqizimit të Gruas, Diskriminimit të Pakicave dhe Fëmijët që Punojnë u bashkuan në temën e përbashkët të Barazisë së Mundësive; dhe Siguria e Ushqimit diskutohet shkurtimisht në Sigurinë Ekonomike.

2.5 Kostot e Tranzicionit në Shqipëri dhe Rajoni

Shqiptarët dhe banorët e shumë vendeve të tjera në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk gëzonin shumë liri themelore gjatë regjimit të mëparshëm, përfshirë këtu edhe të drejtën e pronësisë. Por ata përfitonin indirekt nga shumë burime prodhuese nëpërmjet Qeverisë së tyre, që u jepte siguritë themelore, duke përfshirë të ardhura relativisht të qëndrueshme, punësimin, banimin, shërbimet sociale, mbrojtjen sociale dhe sigurinë e ushqimit. Kjo u lejoi këtyre vendeve të arrijnë nivele më të larta të Zhvillimit Njerëzor, sesa vendet e tjera me ekonomi relativisht më të zhvilluara, por i jepnin më pak përparësi Sigurisë Njerëzore.

Këto përfitime dhe të drejta themelore nuk mund të mbijetonin pa miratimin e gjerë dhe mbrojtjen e institucioneve të tyre ekonomike, politike dhe sociale, të qëndrueshme dhe të fuqishme. Zbutja e kontrollit nga ana e Qeverisë, e cila filloi me

[5] Përmasat e reja të sigurisë njerëzore, Kreu 2 i HDR 1994
[6] Siç thuhet në raportin mbikqyrës të UNDP/RBEC të vitit 1999 mbi Sigurinë Njerëzore në Evropën Juglindore.

vdekjen e diktatorit të mëparshëm Enver Hoxha në vitin 1985 dhe që u përshpejtua në fillim të viteve 1990, lejoi përparime të mëdha drejt lirisë personale dhe politikë, por gjithashtu dëmtoi mundësinë e njerëzve për të pasur mjete prodhuese dhe përfitimet e tyre, duke ulur Sigurinë Njerëzore dhe Zhvillimin Njerëzor në Shqipëri.

Në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të vitit 1999[7] për rajonin, u diskutua mbi kostot e përbashkëta të tranzicionit duke përfshirë:

- Nivelet e larta të vazhdueshme të sëmundjeve- vdekshmëria foshnjore dhe e nënave është shumë e lartë, kujdesi për shëndetin ka rënë dhe është shfaqur rreziku i një rritjeje të shpejtë të të sëmurëve me HIV/SIDA, si dhe sëmundje të tjera ngjitëse.
- Një rritje e varfërisë, si nga pikëpamja e të ardhurave, ashtu edhe nga pikëpamja e elementëve të tjerë të varfërisë njerëzore, të tilla si keq-ushqyerja - disa grupe u varfëruan më tepër se të tjerët, përfshirë këtu pensionistët, të paaftët, migrantët e refugjatët dhe fëmijët. Një e treta e Shqiptarëve konsiderohen të varfër.
- Rritje në pabarazinë e të ardhurave dhe të pasurisë – një simptomë është numri i madh i njerëzve që zhvendosen dhe normat e larta të migrimit.
- Rritje në pabarazinë mes gjinive – shumë pak gra marrin pjesë në jetën publike, tani që kuotat janë hequr, ndërsa siguria ekonomike dhe personale ka rënë për gratë. Kjo vjen për shkak të faktorëve, siç janë: vështirësia e tyre për të gjetur një punë, trafiku i grave, i fëmijëve dhe reduktimi i shërbimeve sociale e i mbrojtjes nga shteti.
- Rënie e cilësisë së arsimit dhe mundësisë për të vazhduar – kostoja e arsimit për studentët dhe familjet po rritet dhe cilësia e arsimit po bie. Institucionet private po rriten shpejt.
- Rritje e papunësisë, e punësimit të pjesshëm dhe punësimit të paligjshëm - treguesi zyrtar i papunësisë 14.4% në vitin 2001 nuk paraqet të vërtetën dhe shumë njerëz me punësim në sektorin privat janë pjesë e një ekonomie të gjerë informale, ku punësimi nuk është i qëndrueshëm dhe ata nuk janë të siguruar për programet sociale. Ekonomia informale, gjithashtu, lehtëson veprimtaritë e paligjshme, duke përfshirë krimin e organizuar dhe ul aftësinë e pushtetit për të mbledhur të ardhurat nga taksat.

Në njëfarë mënyre, këto ishin të pashmangshme në afatet e mesme kohore dhe në një farë shkalle u shkaktuan nga vendimet për ecurinë e reformave dhe nga ripërcaktimi i rolit të Qeverisë. Dalja nga faza e tranzicionit do të kërkojë kohë dhe rindërtimin e një sistemi ekonomik dhe qeveritar që mbështet dhe është në harmoni me Sigurinë Njerëzore dhe lirinë personale.[8]

Lidhur me rolin e Qeverisë në Shqipëri, lavjerrësi ka lëvizur shumë. Gjatë periudhës së tranzicionit prirja ka qenë për të minimizuar rolin e Shtetit në emër të privatizimit, decentralizimit, liberalizimit dhe forcave të tregut. Shteti po tërhiqet nga garantimi i përgjithshëm i disa formave kryesore të shërbimit dhe mbrojtjes sociale. Në këtë proces është shpërfillur roli kritik i Institucioneve Shtetërore për të plotësuar dhe mbështetur efektivitetin dhe barazinë e institucioneve të tregut, në mënyrë që të sigurojë një bazë të fortë për Zhvillimin Njerëzor, duke ndërtuar Sigurinë Njerëzore dhe nxitur më tepër rritjen ekonomike "në dobi të të varfërve".

2.6 Pamja e Përgjithshme

Shqipëria, me një sipërfaqe 28.748 kilometra katrorë, ka një popullsi prej 3.087 milion banorë. Që nga fillimi i tranzicionit në Shqipëri, në fillimet e viteve 90, u shfaq një fenomen i ri i shkallës së lartë të emigrimit dhe papunësisë dhe ka patur një rënie të madhe të veprimtarisë ekonomike, (PBB[9] ra rreth 40% nga niveli i vitit 1989) të shoqëruar nga norma të larta të inflacionit. Destabiliteti politik, social dhe ekonomik në vitet 1997-98 çoi në humbje të më tepër se 1.3 miliard dollarësh[10] në kursimet private dhe çoi prapa zhvillimin e vendit, por tani inflacioni është relativisht i stabilizuar dhe ekonomia po vjen duke u rritur që nga viti 1998, rritje kjo që vazhdoi edhe gjatë destabilizimit prej krizës së vitit 1999 në Kosovë. Rritja e popullsisë është vlerësuar rreth 1% në vit dhe PBB-ja për frymë është rreth 1.100 USD. Nga 7.3% në vitin 2001, norma reale e rritjes së PBB pritet të mbetet përafërsisht 7% gjatë viteve të ardhshme.[11] Shih Pasqyrën 2 Treguesit Kryesorë Makroekonomikë. Norma mesatare e rritjes vjetore të PBB për frymë në vitet 1990-2000 ishte 3.2%.[12]

Pengesat apo kërcënimet e mundshme ndaj investimeve dhe rritjes ekonomike të vazhdueshme janë korrupsioni dhe institucionet pushtetare joefiçente, pasiguria mbi pronësinë, transporti i dobët, infrastruktura e keqe e ujit dhe mungesa e

[7] Tranzicion 1999, UNDP. www.undp.org/rbec/pubs/hdr99/
[8] Po aty.
[9] Produkti i Brendshëm Bruto – vlera e të gjitha të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend gjatë një viti. Statistikat e PBB-së në Shqipëri nuk janë të besueshme për shkak të raportimit jo të plotë të veprimtarisë ekonomike.
[10] Konferenca Kombëtare mbi Vlerësimin e Kushteve të Jetesës së Familjeve, Instat, 2001.
[11] PBB dhe statistikat e popullsise nga Ministria e Financave dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2002.
[12] Gjendja e Fëmijëve të Botës 2002, UNICEF. http://www.unicef.org/sowc02/

zgjatur e energjisë elektrike; një sektor i pazhvilluar financiar, ku Qeveria i përjashton huatë private, si dhe varësia e madhe nga të ardhurat e paqëndrueshme të dërguara në vend nga punëtorët emigrantë (dërgesat).

Aktiviteti bujqësor llogaritet se jep më tepër se 51% të PBB në vitin 2001, përderisa sektori i industrisë së rëndë pësoi rënie në vitet e para të tranzicionit dhe pjesërisht u kompensua nga një rritje në industrinë e lehtë për eksport. Ndërtimi është përbërësi kryesor në sektorin e shërbimeve. Rritja në pjesë më të madhe vjen prej investimeve private, shumica e të cilave bëhen me të ardhurat e dërguara në shtëpi nga emigrantët. Investimet e huaja janë të papërfillshme për shkak të problemeve të vazhdueshme të infrastrukturës së dobët dhe rrezikut të humbjes së investimeve apo të drejtave të pronësisë.

Italia është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, i ndjekur pastaj nga Greqia; tregtia jashtë Bashkimit Evropian përbën vetëm një pjese të vogël të tregtisë së përgjithshme. Deficiti i madh tregtar është afër me 20% të PBB-së, i financuar kryesisht nga ndihmat e huaja dhe dërgesat. Fondi Monetar Ndërkombëtar e konsideron të përballueshëm deficitin fiskal, të financuar nga ndihmat e huaja dhe huamarrjet e brendshme.

2.7 Kuadri i Planifikimit Rajonal dhe Kombëtar

Gjatë tranzicionit Shqipëria pati shumë kërkesa për nënshkrime, miratime dhe zbatime të qindra marrëveshjeve, konventave, protokolleve, strategjive dhe plan-veprimeve. Në veçanti, ishin tre iniciativa që tërhoqën vëmendjen e qeverisë: Strategjia e Reduktimit të Varfërisë dhe e Rritjes (GPRS), Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit (SAP) dhe Pakti i Stabilitetit (SP) për Evropën Jug-Lindore. Në vitin 2001 Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë.

Përgatitja e GPRS për vitet 2002-2004 me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar ishte një kusht i domosdoshëm për kontributet e mëtejshme ndërkombëtare dhe strategjia u bë dokumenti kryesor i planifikimit të qeverisë shqiptare. E quajtur Strategji Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik nga Qeveria, ajo është përpunuar si nënstrategji dhe plane të veprimit në shumë Ministri dhe është integruar me mjete të tjera të planifikimit, përfshirë Kuadrin e Shpenzimeve Afat-Mesme (MTEF), Programin e Investimeve Publike (PIP) dhe Strategjinë për

Objektivat Kryesorë të Strategjisë së Zhvillimit dhe Uljes së Varfërisë për Shqipërinë

- Norma reale e rritjes së PBB 22-25% gjatë periudhës 2002-2004
- Pakësimi i numrit të njerëzve që jetojnë në varfëri me synimin e zbutjes së varfërisë, në veçanti, për zonat dhe grupet shoqërore më të prekura nga kjo
- Përmirësimi konkret i infrastrukturës dhe i shërbimeve të lidhura me të, siç është furnizimi me ujë të pijshëm, energjia elektrike, ujërat e zeza etj., duke rritur mundësinë e të varfërve për të përdorur këto shërbime
- Ulja e shkallës së vdekshmërisë së nënës, asaj foshnjore si dhe të sëmundjeve
- Rritja e nivelit të regjistrimit në arsimin tetëvjeçar (fillor), të mesëm si dhe të periudhës shkollore mesatare

Burimi: http://www.seerecon.org

Decentralizim. GPRS megjithatë ende nuk është marrë seriozisht me ekonominë e gjerë informale të Shqipërisë.

Qeveria tashmë ka filluar ta sjellë legjislacionin në përputhje me standardet Evropiane, meqë strategjia afat-gjatë e Shqipërisë është futja në Bashkimin Evropian (EU). Negociatat u hapën në vitin 2001 për fazën e parë të këtij procesi, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (SAA).[13] Në përgjithësi, Shqiptarët janë optimistë për rezultatet e pritshme të marrëveshjes, duke theksuar përfitimet, siç është lëvizja e lirë e njerëzve brenda Bashkimit Evropian. Ndërgjegjësimi dhe diskutimi i publikut për disa aspekte të tjera pothuaj mungon, si psh. ndikimi i mundshëm në sektorin e gjerë konkurrues bujqësor të Shqipërisë. Përfundimi i një Marrëveshjeje Stabilizim-Asociimi të Shqipërisë me Bashkimin Evropian do ta detyrojë Shqipërinë të bëjë bisedime me vendet e tjera që kanë nënshkruar një SAA me Bashkimin Evropian për Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë Bilaterale. Kjo përfshirje rajonale duhet të ndodhë përpara se Bashkimi Evropian të lejojë vendet e SAA të futen në të.

Tashmë Shqipëria ka përfitime nga preferencat[14] e ndryshme të njëanshme tregtare që i jep Bashkimi Evropian dhe nga viti 1991 deri në vitin 2000, Shqipëria ka përfituar 1021 milion Euro ndihmë nga Bashkimi Evropian[15]. Shqipëria është njohur për rolin konstruktiv që ka luajtur në

[13] Kroacia dhe Maqedonia nënshkruan SAA në vitin 2001

[14] Preferencat e Tregtise Autonome (ATP), Nëntor 2000 – Dhjetor 2005.

[15] http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/albania. Për përparësitë në ndihmat e Evropës së Bashkuar shih http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/news/ip01_1464.htm

rajon. Kohët e fundit, Shqipëria, nënshkroi marrëveshjen e tregtisë së lirë me Maqedoninë në janar të vitit 2002 dhe është në proces të rivendosjes së marrëdhënieve normale me Serbinë dhe Malin e Zi. Iniciativa më e madhe për mbështetjen e integrimit rajonal dhe koordinimin

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian

- 1992: Marrëveshja e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, Shqipërisë i akordohen fondet e PHARE
- 1997: "Qëndrimi Rajonal" i Bashkimit Evropian ndaj Evropës JugLindore përcaktoi kushtet ekonomike dhe politike për marrëdhënie bilaterale
- 1999: Pakti i Stabilitetit, procesi i Stabilizim-Asociimit dhe Preferencat e Tregtisë Autonome
- 2000: Shqipëria fitoi të drejtën për të shitur në tregjet e Bashkimit Evropian pa shumë produkte
- 2001: Komisioni PSA rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë mbi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

e veprimtarisë donatore është Pakti i Stabilitetit.

I nënshkruar ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe donatorëve të huaj, Pakti i Stabilitetit i grupon veprimtaritë në tri kategori: Demokratizimi dhe Të Drejtat e Njeriut, Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik si dhe Siguria (përfshin mbrojtjen, drejtësinë, rendin dhe anti-korrupsionin). Gjithashtu, ai i mbledh udhëheqësit rajonalë për

"Pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, bazuar në institucione publike funksionale dhe të krijuar mbi baza të një Shoqërie të fortë Civile, përqendrimi në kërkesat formale për harmonizim dhe integrim me Bashkimin Evropian do të jenë të dëmshme".

Burimi: Vlerësimi i Strategjisë së Komunitetit Evropian, 2001.

të diskutuar idetë dhe për të bashkëpunuar nëpërmjet agjencive apo strategjive rajonale, në fusha si migrimi dhe energjia, duke marrë parasysh problemet ndërkufitare që lindin. Pakti i Stabilitetit përfshin një Grup Pune për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë të përfshirë në "Kontratën e Investimeve" dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të vitit 2001 (MOU) mbi liberalizimin e tregtisë në rajon. Rezultatet nga Pakti vijnë ngadalë; disa Projekte të Fillimit të Shpejtë, që planifikohen të fillojnë brenda një viti nga nënshkrimi i paktit në vitin 2000, nuk kanë filluar ende.

Shih Pasqyrën 3 Shoqatat dhe Anëtarësimet e Rëndësishme të përzgjedhura, Pasqyrën 4 Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën Jug-Lindore, janar, 2002 dhe Pasqyrën 5 Marrëveshjet mbi Doganat dhe Taksat deri në gjysmën e vitit 2001.

2.8 Kapërcimi i mendësisë të krizës

Një karakteristikë themelore e Sigurisë Njerëzore është se kushton më pak të garantohet Siguria Njerëzore me anë të investimeve mbrojtëse, sesa nëpërmjet shpenzimeve si përgjigje pas shfaqjes së një problemi. Për shembull, nuk është e mundur të parandalohet një tërmet, por është e mundur të përmirësohen dhe të bëhen të detyrueshme rregullat e ndërtimit, në mënyrë që të preken sa më pak njerëz nga tërmeti. Llojet e tjera të krizave mund të parandalohen apo lehtësohen, nëse kryhen shpejt veprimet e përshtatshme[16]; është e rëndësishme të mbikqyren treguesit e hershëm paralajmërues në mënyrë që të ndërmerren në kohën e duhur iniciativat diplomatike apo investimet social-ekonomike të nevojshme. Shih Pasqyrën 31 Profili i Fatkeqësive Natyrore të Shqipërisë dhe Faqen e Internetit të Sistemit të Hershëm Kombëtar të Paralajmërimit (NEWS).[17] Në fund të fundit është përgjegjësi e Qeverisë për të qenë e përgatitur për emergjenca, por komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmojë pë përgatitjen dhe monitorimin e treguesve, dhënien e informacionit dhe promovimin nga vendim-marrësit të mekanizmave kryesore për të vepruar, pa të cilat procesi nuk funksionon.

Cili është pozicioni i Shqipërisë midis krizës, vendosjes së paqes dhe zhvillimit? Disa shqiptarë mendojnë se vendi i tyre ka ngecur në tranzicion, se është shkëputur nga komunizmi pa ndërtuar një sistem të ri. Të tjerë shohin tashmë ndryshime të mëdha në shoqërinë shqiptare pas më shumë se dhjetë vitesh, që pas daljes së Shqipërisë nga 48 vjet izolim dhe kontroll të centralizuar.

Ashtu si në shumë vende të tjera, mendësitë mund të bëhen profeci, që realizohen vetvetiu.

[16] UNCT shqiptare ka përgatitur Planet e Emergjencës që në vitin 1995, duke përfshire Planin e Emergjencës së Agjencive të Kombeve të Bashkuara të vitit 2001, të bazuara në mundësinë e ardhjes së refugjatëve. Një dokument më i gjerë do të përgatitet për ngjarjet e pritshme në vitin 2002.

[17] http://undp.org.al/

Të rinjtë në Shqipëri janë të etur dhe ndihen se e meritojnë lirinë dhe cilësinë e jetës, që ata shohin në perëndim dhe, shumicës prej tyre u mungon besimi te aftësitë e tyre se mund ta arrijnë atë nëpërmjet punës së madhe në vendin e tyre. Eshtë e vështirë të kënaqësh shpresat e këtyre të rinjve në një periudhe afat-shkurtër. Shqiptarët e përkushtuar duhet të jenë si model, që mund të tregojnë suksesin, integritetin dhe pasionin për vendin e tyre dhe një qëndrim më tepër për të mësuar sesa pë të imituar Perëndimin.

Ndërsa Shqipëria mbetet e prekshme nga krizat, nuk duhet të ketë një braktisje pasive të përgjegjësive për zhvillim. Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme gjatë tranzicionit në fushën e rritjes ekonomike, ndërtimit të institucioneve dhe lirisë personale. Këto arritje duhet të njihen dhe të konsolidohen, ndësa theksi duhet të zhvendoset nga rritja ekonomike te trajtimi i pabarazisë, nga ndërtimi i institucioneve drejt përmirësimit të aftësive ekzekutuese institucionale dhe nga zgjerimi i lirive personale drejt përkrahjes së kohezionit shoqëror.

3 Siguria Ekonomike

3.1 Varfëria

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

- **Çrrënjosja e urisë dhe e varfërisë së skajshme**
  - Përgjysmimi, midis viteve 1990 dhe 2015, i numrit të njerëzve, të ardhurat e të cilëve janë më të ulta se 1 dollar në ditë
  - Përgjysmimi, midis viteve 1990 dhe 2015, i numrit të njerëzve që vuajnë nga uria

Dokumente të Rëndësishme për të Drejtat e Njeriut

- **Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**
  - Pranimi i të drejtës së secilit për të mos qenë i uritur

Arsyet për kujdesin në përdorimin e të dhënave mbi punësimin në Shqipëri:

- Ligji i vitit 1995 mbi punësimin i konsideron të gjithë banorët e zonave rurale, që kanë marrë tokë prej privatizimit, të vetëpunësuar dhe nuk i lejon ata të regjistrohen si të papunësuar dhe të kërkojnë shërbime nga qeveria.
- Nuk ka të dhëna zyrtare mbi punësimin në sektorin e gjerë jo zyrtar të ekonomisë.
- Është Instat ai që llogarit punësimin dhe MPÇS ajo që llogarit papunësinë.
- Statistikat janë të ndërlikuara më tej nga punësimi i përkohshëm, siç është ai sezonal dhe programi i punës publike i MPÇS, që punëson njerëz për një muaj dhe i heq nga lista e të papunëve.
- Nga ana tjetër, është e mundur që disa njerez të regjistruar në zyrën e punës nuk njoftojnë gjithmonë kur gjejnë punë. Ekziston gjithashtu një fenomen i ri i punonjësve të paregjistruar nga vende si Kina apo Egjipti, që vijnë në Shqipëri për të punuar, veçanërisht në sektorin e ndërtimit.

Ne zotohemi që të punojmë për çrrënjosjen e varfërisë së skajshme në botë, nëpërmjet veprimeve kombëtare vendimtare dhe bashkëveprimit ndërkombëtar, si një nevojë etike, politike, sociale dhe ekonomike e njerëzimit.

-1995 Deklarata e Kopenhagenit, Mbledhja Botërore e Nivelit të Lartë për Zhvillimin Social

3.1.1 PËRKUFIZIM

Varfëria ka shumë përmasa, ndër të cilat të ardhurat e ulta janë vetëm një nga treguesit.

Për njerëz të ndryshëm apo grupe, varfëria mund të tregojë se goditen më shumë nga rreziqe si të keq-ushqyerit, sëmundjet, papunësia apo dhuna, se kanë mundësi të pamjaftueshme për sigurimin e nevojave themelore, ujit, ushqimit dhe strehimit, se nuk sigurojnë shërbimet shëndetësore dhe arsimim për të mbajtur dhe formuar aftësitë personale, si dhe nuk e thonë dot fjalën e tyre në vendimet e komunitetit. Këto përmasa mund të përmblidhen si mungesë e mundësive, mungesë e aftësive dhe ballafaqim më i madh me rreziqet. Metoda më e mirë është të analizohet një gamë e gjerë treguesish dhe të paraqiten disa vrojtime të përgjithshme.[18]

3.1.2 VLERËSIM

Pavarësisht nga stabiliteti makroekonomik dhe përparimi, Shqipëria mbetet vendi evropian lindor me nivelin më të lartë të varfërisë, duke u radhitur e 85-ta nga 162 vende për Indeksin e vitit 2001 të Zhvillimit Njerëzor.[19] Shqipëria ka një rrugë të gjatë për të bërë që të arrijë objektivin qendror të komunitetit ndërkombëtar për reduktimin e varfërisë

[18] GPRS 2002-2004, Nëntor 2001.
[19] Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2001, UNDP. Treguesi llogaritet në bazë të pritshmërisë së jetës, alfabetizmit, regjistrimit në shkollë dhe treguesve të PBB-së.

Vrojtime të Përbashkëta mbi Varfërinë nga Instat/Banka Botërore

- Familjet e mëdha dhe të reja përgjithësisht janë më të varfra.
- Arsimi është i rëndësishëm në uljen e varfërisë, veçanërisht mbi arsimin fillor. Regjistrimi i përgjithshëm në shkollat e mesme është një strategji e reduktimit të varfërisë.
- Në tërësi, kryefamiljaret femra nuk duket sikur janë në rrezik të madh varfërie. Megjithatë, mes femrave që janë kryefamiljare, femrat që jetojnë vetëm dhe ato që nuk kanë burra, janë mbi 60% më të prirura për të qenë të varfra sesa burrat në të njëjtat kushte.
- Dërgesat nga jashtë janë një mënyrë për të dalë nga varfëria, më shumë për femrat kryefamiljare.
- Higjiena është problem në zonat rurale; dendësia e madhe në zonat urbane.
- Varfëria lidhet ngushtë me burimet kryesore të të ardhurave. Punonjësit bujqësorë kanë rrezikun më të madh për të qenë të varfër, 2 ndër 5 të varfër punojnë në bujqësi.
- Kryefamiljarët që nuk punojnë janë më të varfër dhe shkalla ndryshon mes zonave urbane dhe rurale.
- Një ndër pesë të varfër është pensionist. Pensionistët në zonat urbane janë më pak të varfër krahasuar me ato të zonave rurale (rreth pesë herë më pak).
- Më të pasurit bëjnë udhëtime të gjata për kujdesin e shëndetit. Ky është një shembull i cilësisë së dobët të shërbimit mjekësor.

Burimi: Konferenca Kombëtare mbi Vlerësimin e Kushteve të Jetesës së Familjeve, Instat dhe Banka Botërore, 2001.

në gjysmën e nivelit të vitit 1990 deri në vitin 2015. Shkalla e regjistruar e papunësisë ishte 14.4% në vitin 2001 sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, më e lartë se përllogaritja administrative e Ministrisë së Punës dhe e Çështjeve Sociale. Papunësia është më e lartë në Veri të vendit. Shkalla e pabarazisë në shpërndarjen kombëtare e matur sipas Koeficientit Gini[20] në vitin 1998 me bazë të ardhurat ishte 0.43[21] (i lartë për Evropën Qendrore dhe Lindore), më e lartë se në vitin 1996 që ishte 0.28[22] me bazë konsumin dhe duke përjashtuar Tiranën. Ndryshimi shpjegohet pjesërisht nga diferencat metodologjike dhe pjesërisht nga thellimi i varfërisë.

Sipas Strategjisë së Rritjes Ekonomike dhe Uljes së Varfërisë,[23] (i) të matur me shifra relative, 29.6% e shqiptarëve janë të varfër, gjysma e të cilëve jetojnë në kategorinë e varfërisë ekstreme, me shifra absolute, 46.6% e Shqiptarëve janë nën linjën e varfërisë së 2 USD për frymë në ditë, ndërsa 17.4% janë nën linjën e varfërisë prej 1USD për frymë në ditë; (ii) një në tre familje ka probleme me cilësinë e ulët të strehimit; (iii) ekzistojnë probleme serioze me furnizimin me ujë të pijshëm, ujërat e zeza dhe rrugët (veçanërisht rrugët urbane dytësore dhe rurale); (iv) shkallët e vdekshmërisë së nënës, asaj foshnjore dhe fëmijëve nën 5-vjeç janë relativisht të larta krahasuar me vende të tjera të rajonit; (v) 14% e fëmijëve nën moshën 5 vjeç janë të ushqyer keq; (vi) analfabetizmi është rritur (vetëm 88% e popullsisë mbi 15 vjeç është e aftë të lexojë dhe të shkruajë); dhe (vii) përveç mungesës së të ardhurave, 75% e familjeve të varfëra ka probleme të rënda sociale.

Varfëria është më e përhapur në zonat e izoluara dhe rurale të vendit: katër nga pesë njerëz të varfër jetojnë në zona rurale. Treguesit e varfërisë në zonat rurale, të krahasuar me ata në zonat urbane, janë pothuaj dyfishi në secilin nivel të arsimit, me përjashtim të arsimit të lartë, ku nivelet e varfërisë janë të njëjta. Sipas LCS

Më shumë se një e treta e të varfërve kanë vetëm arsimin fillor.

më tepër se gjysma e familjeve, që e kanë kryetarin e familjes të papunësuar, janë të varfëra. Shanset për të qenë të varfër janë rreth 6 herë më të larta për njerëzit e punësuar, të cilët jetojnë në zonat rurale (32.6%) sesa për njerëzit e punësuar, por që jetojnë në zonat urbane (5.3%). Pensionistët përbëjnë rreth 20% të njerëzve të varfër. Probabiliteti i numrit të pensionistëve në zonat rurale, duke përfshirë të paaftët që marrin pension për të jetuar në varfëri, është dyfish më i lartë se i atyre që jetojnë në zonat urbane. Mundësia e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave jetike nuk është e kufizuar vetëm në zonat rurale, 40% të familjeve urbane u mungojnë

[20] Një masë e radhitjes së pabarazisë nga 0 (barazi e plotë) deri në 1 (pabarazi absolute).
[21] Rezultate të Anketës të Nivelit të Jetesës (LCS) Tetor 1998, Instat, Korrik 2001.
[22] APNSHS Vrojtim mbi Varfërinë, i përmendur në Konferencën Kombëtare mbi Vlerësimin e Kushteve të Jetesës së Familjeve, Instat dhe Banka Botërore, 2001.
[23] Ky dhe paragrafi i mëposhtëm bazohen në pjesë të nxjerra nga GPRS, që ka marrë të dhënat mbi varfërinë nga (a) Vlerësimi Cilësor i Varfërisë në 10 zona të Shqipërisë nga Banka Botërore (WB) dhe Qendra e Studimeve Ekonomike dhe Sociale (QSES) në vitin 2001, dhe (b) studimi i përbashkët Instat /WB i përmendur më sipër. Studimi i mëvonshëm mbështetet në të dhëna nga (c) Vrojtimi i Hallkave Shumëfishe të Treguesve i vitit 2000 (MICS) nga Instat në vitin 2000, dhe (d) LCS i përmendur në shënimin 21.

SIGURIA E USHQIMIT,[24] bashkë me shëndetin e mirë, higjienën, kujdesin për fëmijët dhe praktikat e të ushqyerit janë përcaktuesit kryesorë të niveleve të të ushqyerit. Shpenzimet për ushqim zënë 49.2% të buxhetit të familjeve urbane në vitin 2000 të krahasuar me 67.7% në vitin 1993.[25] Një mision i Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) dhe Programi Botëror i Ushqimit (WFP) në Shqipëri në vitin 1999 zbuloi se vështirësitë e ushqimit ishin më tepër rezultat i situatës së përgjithshme ekonomike, sesa i krizës së refugjatëve në atë periudhë. Sipërfaqja e punuar dhe koha e mbjelljeve prekën furnizimin e përgjithshëm të ushqimit dhe janë të ndikuara nga koha dhe rënia e shirave nga problemet e tjera siç janë dëmtuesit dhe sëmundjet, taksat mbi plehrat kimike e pesticidet, si dhe përfitimet nga të korrat. Para vitit 1990 rreth 70% e tokës së punueshme ujitej, duke mundësuar korrje të mëdha në vit, por rreth gjysma e infrastrukturës së ujitjeve dhe kullimeve u dëmtua gjatë tranzicionit. Ilaçet dhe vaksinat për gjënë e gjallë janë të kufizuara për ata që mund t'i përballojnë, me përjashtim të disa shërbimeve të ofruara nga shteti. Ndërkohë që disa bashkësi në veri janë të varur nga ndihmat ushqimore të dhëna nga shteti në dimër, shumica e fermerëve mbijetojnë nga bujqësia e vogël. Disa familje fitojnë para nga shitja e gjësë së gjallë, frutave, perimeve, por bimët kryesore janë drithërat. Rreth gjysma e prodhimeve bujqësore të konsumuara në Shqipëri importohen nga sektori privat kryesisht për të përmbushur nevojat e zonave urbane, veçanërisht me drithëra, vajëra dhe sheqer. Çmimet dhe tregtia janë liberalizuar. Disa familje të varfra, veçanërisht më të varfërit në zonat veriore, shpenzojnë rreth tri të katërtat e të ardhurave të tyre për ushqim dhe nuk mund të përballojnë shpenzimet për një ushqim të shëndetshëm dhe të shumëllojshëm. Mungesa e sigurisë së ushqimit vjen nga të ardhurat e ulta, dhe jo nga mungesa e ofertës. Rreziqe të tjera të mundshme për sigurinë e ushqimit janë tërmetet, përmbytjet përgjatë brigjeve jugpërendimore, stuhitë e dëborës, shpyllëzimet dhe erozioni i tokës.

dy ose më shumë nevoja jetike.

Këto të dhëna shpesh nuk gjenden për zonat rurale dhe periferike, ku kushtet ekonomike kanë prirje të jenë më të vështira. Disa nga zonat periferike urbane me rritje të shpejtë, janë më të varfra sesa zonat e izoluara; ato përbëhen nga njerëz që kanë lënë zonat rurale dhe kanë krijuar vendbanime jozyrtare përreth qyteteve kryesore të Shqipërisë, ku u mungon infrastruktura dhe disa shërbime sociale themelore. Rinisë në disa nga këto vendbanime i mungon mundësia për arsimim.

Një vrojtim nga Instat në vitin 1998[26] zbuloi se rreth 44% e shqiptarëve, 63% e atyre mbi moshën 15 vjeç, ishin ekonomikisht aktivë. Të ndarë sipas gjinive, 53% e grave dhe 73% e meshkujve mbi 15 vjeç ishin ekonomikisht aktivë. Totali i pjesëve varion sipas grup-moshave; moshat nga 15-29 vjeç ishin më pak aktive dhe grupmosha 40-49 vjeç ishte më aktive ekonomikisht. Përllogaritja e Instat-it e një koeficienti të varësisë ekonomike, duke përdorur këto të dhëna, tregon se çdo punëtor mban një person që nuk punon mbi moshën 15 vjeç. Në Shqipëri duhet të bëhet një vrojtim i përgjithshëm dhe i besueshëm i Fuqisë Punëtore.

Shih Pasqyrën 6 Përqindja dhe Shkalla e Varfërisë sipas Zonave Rurale dhe Urbane, Pasqyrën 7 Varfëria sipas Prefekturave, Pasqyrën 8 Varfëria e Matur sipas UBN për Prefekturë, Pasqyrën 9 Mospërmbushja e Nevojave bazë (UBN) sipas zonave Urbane/Rurale, Pasqyrën 10 Shkalla e Varfërisë së Familjeve, Pasqyrën 11 Kushtet Ekonomike sipas Burimit Kryesor të të Ardhurave, Pasqyrën 13 Të Dhënat e Punësimit dhe Papunësisë, Pasqyrën 14 Punësimi dhe Papunësia sipas Gjinisë dhe Moshës, 1998 dhe Pasqyrën 15 Përbërja e Burimeve Më Të Mëdha të të Ardhurave sipas Të Varfër/Jo Të Varfër.

Grupet e rrezikuara[27] japin një perspektivë të dobishme, përderisa shumë prej tyre lidhen me varfërinë. Shih Pasqyrën 12 Vendosjet kryesore të Disa Grupeve të Rrezikuara në Shqipëri dhe për grupe të tjera të rrezikuara shih kapitujt mbi Fuqizimin e Gruas, Diskriminimin e Pakicave dhe Fëmijët në Kushte të Pafavorshme. Shumë njerëz që nuk konsiderohen të varfër janë të prekshëm ndaj këtij fenomeni, përderisa të ardhurat e tyre janë të paqëndrueshme dhe të ulta, për shembull, sipërmarrjet e vogla familjare kanë një normë të lartë falimentimi. Pagat reale pësuan rënie të thellë në vitet e para të tranzicionit (duke rënë mbi 50% nga vitet 1991-1996[28]) dhe Paga Minimale është orientuar drejt inflacionit që nga viti 1992. Pagat e sektorit privat janë tri herë më të larta se ato të

[24] Një gjendje që ekziston kur të gjithë njerëzit, në çdo kohë, kanë mundësi fizike, sociale dhe ekonomike për një ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe me vlera ushqimore që përmbush nevojat e tyre të të ushqyerit dhe parapëlqimet për ushqim për një jetë aktive dhe të shëndetshme (FAO). Të dhënat këtu janë marrë nga Raporti special:FAO/WFP Misioni i Vlerësimit të Furnizimit të Ushqimit dhe i të Korrave në Shqipëri, 1999.

[25] Vjetari i Treguesve Sociale, Instat, Dhjetor 2000.

[26] Rezultate të Anketës të Nivelit të Jetesës (LCS) Tetor 1998, Instat, Korrik 2001.

[27] Një grup njerëzish me karakteristika të përbashkëta, te cilëve u mungon ose rrezikojne humbjen e disa formave të sigurisë.

[28] Shqipëria në Shifra, Instat, 2000.

sektorit publik.[29] Të ardhurat familjare në zona me më pak se 10.000 banorë janë një e treta më pak se në zonat me më shumë se 10.000 banorë,[30] megjithëse shumë familje të zonave rurale mbijetojnë me të ardhura jo financiare në formën e prodhimit bujqësor shtëpiak apo atij blegtoral.

Banka Botërore i ka dhënë Shqipërisë tri hua lidhur me Strategjinë e Rritjes Ekonomike dhe Uljes së Varfërisë (GPRS), për t'u financuar gjatë periudhës 2002-2004, mbi arritjen e disa kushteve. Kushtet për GPRS e parë përfshinin, mes të tjerash, rritjen e shpenzimeve për shëndetin dhe arsimimin si pjesë e PBB, përgatitjen e një plani të përgjithshëm për shëndetin për Tiranën dhe rritjen e kontributit minimal për sigurimet shoqërore.[31]

3.1.3 ANALIZË

Varfëria dhe papunësia e fshehtë ishin të pranishme në regjimin e mëparshëm dhe janë përkeqësuar nga pastabiliteti politik dhe rajonal, bashkë me sfidat e tranzicionit në një ekonomi tregu. Reformat ekonomike, siç është privatizimi dhe liberalizimi i çmimeve, i kanë lënë shumë njerëz dhe organizata të paafta për të gjetur mundësitë, kurse inflacioni i lartë e rënia në të ardhurat kombëtare shkaktuan varfërinë në të ardhura. Përfundimi i izolimit i hapi njerëzit ndaj

Mjetet e përgjithshme për përmirësimin e gjendjes së zonës rurale përfshijnë

- Përmirësimi i fuqisë së tregut përmes kooperativave dhe shoqatave
- Aftësitë e Marketingut
- Informacionin
- Ngritje e efektivitetit përmes rritjes së madhësisë së fermave do të kërkojë një treg veprues toke dhe fuqizimin e të drejtave mbi pronësinë.
- Teknika/mekanizim me kushte të leverdisshme
- Mënyra të reja të trajtimit të rrethanave lokale dhe burimeve natyrore
- Kosto më të ulta transporti nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës
- Kredi rurale

kulturës së huaj dhe të importeve, gjithashtu çoi në rritjen e perceptimit të varfërisë relative. Zonat rurale mbajnë gjurmët e trashëguara të prapambetjes dhe një pjesë e infrastrukturës kombëtare u dëmtua në krizat e vitit 1992 dhe 1997-98. "Klasa e mesme" në Shqipëri është ende mjaft e vogël dhe niveli i përgjegjësisë së grupeve sociale është i ulët.

Të ardhurat e ulta nga punësimi i lënë shumë punëtorë në varfëri, ose shumë afër saj, përderisa shumë nuk mund të mbështeten në punë afat-gjata. Ndihma ekonomike, sigurimet për papunësinë dhe pensionet nga Qeveria janë shumë të ulta, ndërsa shumat për kontributet po rriten. Qeverisë i mungojnë burimet për të përmbushur zotimet e marra për të varfërit. Në përgjithësi skema e mbrojtjes sociale ka një ndikim të ulët në zbutjen e varfërisë dhe as nuk parandalon mënjanimin nga shoqëria, as nuk lejon ri-integrimin në shoqëri, përderisa nevojat e grupeve, veçanërisht atyre të rrezikuara, rrallë merren parasysh. Për shembull, shumë të rinjve që gëzojnë një kujdes u mungon rrjeti mbështetës dhe përgatitja që nevojitet kur ata dalin prej institucioneve ku jetonin dhe duan të bëjnë një punë produktive dhe të zhvillojnë marrëdhëniet. Papunësia urbane priret të jetë më e lartë në qytetet që ishin qendra industriale në regjimin e mëparshem, siç janë Kukësi, Dibra, Elbasani dhe Korça.

ASPEKTET E VARFËRISË NË ZONAT E THELLA: (Ky paragraf trajton veçanërisht zonat malore dhe shtrihet më pak në zonat kodrinore dhe bregdetare). Klima është më e ashpër dhe toka e punueshme është e paktë dhe më e copëzuar. Pothuajse një e treta e familjeve rurale kanë më pak se 0.5 ha tokë të punueshme secila. Familjet janë të izoluara nga tregjet, aktivitetet sociale dhe nga sherbimet jetike si uji i pijshëm. Atyre u mungon infrastruktura e duhur e transportit. Këta faktorë sjellin të keq-ushqyerit, vdekshmërinë e lartë dhe prekjen prej infeksioneve dhe sëmundjeve. Veçanërisht gratë janë të prekshme prej sëmundjeve dhe të keq-ushqyerit.

PAMJA E PËRGJITHSHME E VARFËRISË RURALE: Ka patur një revolucion në sektorin e bujqësisë me fillimin e reformave ekonomike e politike, në fundin e vitit 1991. Shqipëria kaloi nga 600 kooperativa dhe 110 ndërmarrje bujqësore në rreth 450.000 njësi ekonomike bujqësore private,[32] por rendimenti për hektar është i ulët. Prodhimi bujqësor dhe standardi i jetesës në zonat rurale kanë rënë në mënyrë të ndjeshme, të ushqyera nga papunësia dhe mungesa e një sistemi të përshtatshëm social. Mekanizmat e përkohshëm, si migrimi për punë, ndihmojnë në ngritjen e të ardhurave të familjeve, por gjithashtu mund ta bëjnë situatën më të vështirë për anëtarët

[29] Vlerësimet gjenden në MICS, Instat, 2000.
[30] Rezultate të Anketës të Nivelit të Jetesës (LCS) Tetor 1998, Instat, Korrik 2001.
[31] Kushtet që duhen përmbushur, 2002, UNICEF. http://www.unicef.org/albania/prsc.htm
[32] Informacioni Statistikor në Shqipëri, 2001, Instat dhe Banka e Shqipërisë.

Meqë rreth 53% e shqiptarëve jetojnë në zona rurale dhe bujqësia zë rreth 50% të PBB-së, masat për të zgjidhur problemet e zonave fshatare dhe të sektorit bujqësor janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë. Kjo ndërhyrje bëhet edhe më kritike duke marrë parasysh se shumica e të varfërve në Shqipëri jetojnë në zonat rurale dhe që gratë e vajzat fshatare janë ndër më të prekshmet e Shqipërisë.

e familjeve që kanë mbetur në fshat dhe t'i dobësojnë më tej strukturat shoqërore të fshatrave. Nivelet e ulta të arsimimit dhe shërbimit shëndetësor në zonat rurale pengojnë shumë veta që të dalin nga cikli i varfërisë.

Historia e politikës për tranzicionin e sektorit bujqësor përfshin marrëveshjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar të vitit 1992, "Programi Makro-Ekonomik i Stabilitetit dhe Ristrukturimit"; një "Strategji Bujqësore për Shqipërinë", që përfshiu vitet 1992-1996, e përgatitur nga ekspertë shqiptarë, Banka Botërore dhe Komuniteti Evropian, e shoqëruar nga një plan-veprim për kalimin në tregun e lirë dhe "Strategjinë e Gjelbërt" për periudhën 1998-2002. Strategjia Bujqësore u përqëndrua në privatizimin së pari të kooperativave bujqësore dhe më vonë të fermave shtetërore; në nxitjen e tregjeve të lira me metoda që përfshijnë liberalizimin e çmimeve, fillimisht të perimeve e më pas të prodhimeve të bulmetit dhe mishit; punësimin e njerëzve në përmirësimin e infrastrukturës rurale; mbajtjen e inflacionit nën kontroll, rritjen e mundësive për të marrë kredi sektori bujqësor, ndarja e burimeve në shoqata private fermerësh, ngritjen e efektivitetit dhe transparencën e tregut të tokës dhe duke u ofruar fermerëve më tepër informacion mbi zhvillimet dhe shërbimet e reja. Strategjia e Gjelbër u përqëndrua në zhvillimin e sektorit bujqësor, duke përfshirë eliminimin e ndihmave financiare të shtetit për sektorin bujqësor dhe një tërheqje të shtetit për të pasur rol në politikën bujqësore dhe promovim. Privatizimi i sektorit është i plotë, por jo regjistrimi i tokës. Kanë nisur iniciativa për nxitjen e tregut për tokën në zonat rurale.

Mundësitë për të krijuar ndërmarrje të shkallës tregtare janë të kufizuara për më të pasurit. Në përgjithësi, popullsia rurale ka mundësi të vogla për të lëvizur nga sistemet shumë-funksionale pothuaj vetëm për të mbajtur veten te ndërmarrjet me orientim tregun, për shkak të mungesës së kapitalit.[33]

KREDIA RURALE

Mikrofinanca shpesh quhet si zgjidhje për të tilla probleme në botë dhe disa institucione po hetojnë iniciativa të mundshme të mikrokredive rurale dhe ndërmarrjeve me bazë familjare, për t'i bërë zonat rurale më të qëndrueshme. Shih Pasqyrën 16 Institucionet Kryesore Që Ofrojnë Mikro Kredi Rurale. E vlen të analizohet nëse një zgjerim apo ndryshim i këtyre veprimtarive është i dëshirueshëm. Programet e mikrofinancës priren të kenë si objektiva qëndrueshmërinë financiare, zbutjen e varfërisë, fuqizimin e gruas ose një kombinim të të treve. Ka një prirje që të vendoset theksi në qëndrueshmërinë financiare, por metodat e kostos efektive, që kërkohen, mund t'i pengojnë këta objektiva.

Në kundërshtim me optimizmin e shumë këshilltarëve të mikrofinancës, metodat ekonometrike nuk janë të afta të tregojnë se mikrofinancat automatikisht e fuqizojnë gruan, kur kontrollohen variablat e tjerë. Kërkimet tregojnë se zgjerimi i programeve të mikrofinancës nuk mund të mendohet se ndihmon në fuqizimin, nëse nuk është i shoqëruar nga masa direkte dhe të dukshme, që përqendrohen në fuqizimin e gruas.[34]

Përveç pengesave të përgjithshme për hua/investime në Shqipëri, të tilla si rreziku politik, institucionet e kreditit përballen me këto sfida në zonat fshatare

- Madhësia e kërkesës për kredi
- Bankat nuk kanë infrastrukturë rurale
- Perceptimet se mikro-kredia është e rrezikshme (Bankat parapëlqejnë klientët me kolateral, të cilin fermat e vogla nuk e kanë)
- Kreditë e vogla, të cilat zakonisht vihen re në zonat rurale, janë të shtrenjta për t'u menaxhuar nga bankat.

Fermerët dhe komunitetet rurale nuk dëshirojnë të angazhohen në një bashkëpunim, i cili ndihmon ta bëjë mikrokredinë më të lirë dhe më efektive. Dekadat e kooperimit të detyruar kanë shkaktuar reagime kunder bashkëpunimit; shumica e fermerëve, tani, zotëron tokën që punon dhe ka një hezitim për shkak të pasigurisë mbi avantazhet e kooperimit. Institucionet konvencionale financiare nuk kanë qenë të afta ose nuk kanë patur dëshirë, të kënaqin nevojat për kredi të familjeve rurale, fermave dhe bizneseve.

[33] Raport Special: FAO/WFP Misioni i Vlerësimit të Furnizimit të Ushqimit dhe të Korrjeve në Shqipëri, 1999.
[34] Mikro-Financa dhe Fuqizimi i Gruas: Një Rishikim i Çështjeve Kyçe, Linda Mayoux - ILO, 2000. http://www.ilo.org/public/english/employment/finance/papers/mayoux.htm

3.1.4 "BARAZIA E SHOQËRUAR ME RRITJEN"

Si mundet Shqipëria të arrijë Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për përgjysmimin e varfërisë në vitin 2015? Pabarazia e lartë e Shqipërisë tregon se vetëm rritja e shpejtë ekonomike është e pamundur të përmirësojë situatën e të varfërve, normat e larta të rritjes nuk garantojnë reduktimin e varfërisë.[35] Kërkohen si barazi më e madhe, ashtu edhe zhvillim i qëndrueshëm. Sigurisht, në vendet ku pabarazia është e madhe, reduktimi i pabarazisë mund të ketë një ndikim më të madh mbi varfërinë, sesa rritja ekonomike. Barazia më e madhe dhe zhvillimi, jo medoemos, janë në konflikt dhe ato mund ta forcojnë njëra-tjetrën, nëse do të zbatohen politikat e duhura për situatën e Shqipërisë. Reduktimi i varfërisë bëhet më mirë kur të varfërit bëhen më produktivë, kështu që të mund të kontribuojnë vetë në rritjen ekonomike. Si mund të bëhen të varfërit më produktivë, që të çojnë në rritjen ekonomike dhe në një reduktim të varfërisë absolute dhe relative?

Burimet duhet të drejtohen në mënyrë të pabarabartë drejt:[36]

FAKTORËVE TË PRODHIMIT TË KONTROLLUAR NGA TË VARFËRIT

- Puna e tyre – shpesh është gjithçka që ata kanë, kështu që ata duhet të bëjnë një punë intensive. Përmirësimi i aftësive mund të ndihmojë, por përparësi janë sigurimi i produktivitetit të punës, ulja e rrezikut të paaftësisë dhe rritja e numrit të viteve të punës gjatë jetës, që kërkojnë mundësi të mëdha për të përfituar prej shërbimeve bazë shëndetësore dhe të arsimit.
- Toka, veçanërisht ajo e punueshme. Të zgjerohen mundësitë ligjore e praktike për të pasur tokë, të forcohen të drejtat e pronësisë dhe të vendoset një treg pune funksionues, në mënyrë që tokat e punueshme të zgjerohen.

SEKTORËVE KU PUNOJNË TË VARFËRIT

- Të fokusohet në përmirësimin e produktivitetit bujqësor nëpërmjet përdorimit më të gjerë të teknologjisë së përshtashme dhe metodave bujqësore dhe të rritjes së të ardhurave nga ekonomia bujqësore, duke nxitur rritjen e çmimeve. Shembuj janë mbarështimi i tufave më të mira për prodhim të mishit dhe të qumështit, financimi i vaksinave, zvogëlimi i humbjeve të stoqeve, etj. Marketimi i prodhimit shqiptar do të kërkojë një informacion më të mirë mbi produktin dhe kontrollet e cilësisë.
- Më pas të fillohet promovimi i punësimit industrial me kualifikim të ulët dhe nxitja e ekspertëve që mbështeten në burimet natyrore dhe përpunimin.

ZONAT KU JETOJNË TË VARFËRIT

- Të investohet në infrastrukturë, veçanërisht në zonat rurale më pak të zhvilluara

Strategjia e Varfërisë e Kombeve të Bashkuara 2000 Përparësitë e Veprimit

- Promovimi i të Drejtave, Përgjegjësive dhe Aftësimit të të Varfërve për të Bërë Ndryshime
- Ndërmarrja e Vrojtimeve, Hartimeve, Planifikimeve dhe Vlerësimeve lidhur me Varfërinë dhe Rrezikun
- Forcimi i Aftësive Bazë të të Varfërve për të Siguruar Shërbimet Sociale Bazë për të Gjithë
- Forcimi i Bazës së Aseteve dhe Mundësive të Jetesës për të varfërit
- Nxitja e Politikave Makroekonomike dhe Sociale në Favor të të Varfërve dhe Barazisë

3.1.5 REKOMANDIME

- Synimet e stabilitetit Makroekonomik dhe rritjes ekonomike duhet të shoqërohen me politika për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e gjerë të të ardhurave, vlerave dhe të mundësisë për të përdorur burimet. Nevojiten politika në favor të të varfërve në fushat e shpenzimeve dhe mbledhjes së të ardhurave nga ana e qeverisë. Hartuesit e politikave duhet të jenë të kujdesshëm për të mos cënuar gratë dhe pakicat, nëpërmjet politikave makroekonomike dhe sipas sektorëve.
- Përderisa çështjet e barazisë prekin zhvillimin, paqen dhe sigurinë, Kombet e Bashkuara duhet ta nxisin Qeverinë të zbatojë një metodë shumë-dimensionale ndaj varfërisë, duke publikuar të dhëna dhe analiza të bazuara në gjininë, moshën, përbërjen etnike, rajonin dhe diferencat rurale dhe urbane. Për të qenë të dobishme, këto vëzhgime duhet t'u paraqiten hartuesve të politikave në kohën e duhur dhe duhet të zbatohen në partneritet me Qeverinë. Një qëndrim i bazuar mbi të drejtat për zhvillim është një kontribut i rëndësishëm i sistemit të Kombeve të Bashkuara.
- Për të luftuar varfërinë dhe nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, marrëdhëniet e ndihmës kërkojnë elasticitet dhe ndjeshmëri kundrejt

[35] Raporti mbi Varfërinë Globale 1998: Kapërcimi i Varfërisë së Njerëzve, UNDP.
[36] Politikat Ekonomike dhe Reduktimi i Varfërisë, 2001, UNDP. http://www.undg.org

Prirjet Globale në Ndihmën e Huaj

Përmbushja e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, siç është çrrënjosja e urisë dhe varfërisë së skajshme, kërkon zotime serioze nga Qeveria Shqiptare dhe Shoqëria Civile, por gjithashtu edhe nga donatorët e huaj.

- Ndihma totale ka pësuar rënie (mes donatorëve nga Komisioni i Asistencës së Zhvillimit (DAC) i OECD)
  - Ndihma Totale DAC ne vitin 2000 (56.2 miliardë USD) ishte 12% më e ulët se piku në vitin 1992 (63.7 miliardë USD) në terma reale.
- Ndihma si përqindje e të ardhurave kombëtare dhe buxheteve të qeverive të vendeve donatore ka rënë
  - Mesatarja e ndihmës nga të gjithë donatorët DAC si përqindje e PKB shkoi nga 0.37% në 1980 në 0.22% në 2000. Vetëm Danimarka, Holanda, Suedia, Norvegjia dhe Luksemburgu përmbushën synimin e 0.7% të vendosur nga Kombet e Bashkuara më 1970.
  - Ndihma si përqindje e shpenzimeve qeveritare të donatorëve ka rënë nga 0.82% në 1990 në 0.58% në 2000.
- Pjesa e Ndihmës shumëpalëshe e transferuar nëpërmjet Kombeve të Bashkuara lidhur me IMF dhe Bankën Botërore po bie.
- Praktika e vënies së kushteve për ndihmat dhe huatë u rrit në vitet 1990
- Që prej vitit 1960 përqindja e ndihmës së dhënë është rritur nga 13% në 33%.
  - Në vitin 1999 67% e ndihmës ishte dypalëshe, 9% erdhi nga Komuniteti Evropian, dhe 24% nga burime të tjera multilaterale (Kombet e Bashkuara, WB, etj)
- Çdo donator, me përjashtim të Danimarkës shpenzon për ushtrinë të paktën dyfishin e asaj që shpenzon për ndihmat.
  - Mbretëria e Bashkuar shpenzon 8 herë, Franca 9, Italia 15, Greqia 23, dhe USA 33 herë më shumë.
- 3.5% e ndihmës dypalëshe në 2000 shkoi për shërbimet bazë shëndetësore dhe arsimore
- 8% e ndihmës nga donatorët DAC në 2000 u shpenzua në Evropë

Burimi: Realiteti i Ndihmës 2002

rrethanave unikale të barazisë politike, ekonomike, sociale, kulturore, ekologjike dhe të gjinive me të cilat përballen njerëzit që rrojnë në çdo vend. Çdo kusht i lidhur me ndihmën duhet të negociohet ndërmjet Shqipërisë dhe donatorëve në përputhje me vlerat e përbashkëta dhe kujdesin për grupet shoqërore të përjashtuara.[37]

- Kombet e Bashkuara duhet të nxitin zhvillimin e atyre sektorëve, që përmirësojnë direkt standardet e jetesës si: shëndetin, arsimin dhe infrastrukturën.
- Kombet e Bashkuara duhet të mbështesin përparësitë e shpenzimeve publike, të cilat kontribuojnë në zhvillimin njerëzor afatgjatë, siç janë e drejta e përdorimit të tokës, kredisë, sigurimi i ushqimit, shërbimet jetike dhe mundësi të tjera.
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (ShKP) do të ketë nevojë për ndihmë të mëtejshme për formimin e aftësive dhe zhvillimin profesional. Ekziston një nevoje e madhe për programe kualifikimi profesional dhe përshtatje për punë të ndryshme, si dhe kërkesa për shërbimet e ShKP do të vazhdojë të rritet, me rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve.
- Kombet e Bashkuara në Shqipëri dhe pjesa tjetër e komunitetit ndërkombëtar mund të ndihmojnë për ngritjen e prestigjit të ShKP, duke regjistruar vendet e lira të punës.
- Kombet e Bashkuara ose partnerët e tyre mund t'i sigurojnë Instat-it asistencë teknike, për të nisur një Vrojtim të Fuqisë Punëtore, për të cilin ka shumë nevojë. Ky do të lejonte një kuptim më të mirë të varianteve të punësimit e të të ardhurave në Shqipëri dhe do të mundësonte përcaktimin më të mirë të synimeve për reduktimin e varfërisë dhe strategjitë e punësimit.
- Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Vend duhet të luajë një rol të rëndësishëm në koordinimin e ngushtë të aktiviteteve të tij me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Qeverinë.
- Përditësimi periodik i këtij Vlerësimi të Përbashkët për Vendin dhe Raportit Kombëtar të Objektivave të Zhvillimit për Mijëvjeçarin duhet bërë në afate për të siguruar të dhënat në fazat kyçe të hartimit të politikave qeveritare dhe të rishikimeve të Strategjisë së Rritjes dhe Uljes së Varfërisë. Kuadri i Asistencës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe këto rishikime duhet të mbështesin këto strategji kombëtare.
- Kombet e Bashkuara, së bashku me

[37] Realiteti i Ndihmës 2002.

Qeverinë, duhet të vendosin etapat për arritjen e Objektivave të Zhvillimit për Mijëvjeçarin në vitin 2015, siç janë synimet në intervale 5-vjeçare. Procesi i planifikimit kombëtar mund të përmirësohet, duke vendosur SRRV në një kuadër afat-gjatë.

- Kombet e Bashkuara duhet të mbështesin forumet për anëtarët e Qeverisë në vendet e rajonit, për t'u njohur me mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira për reduktimin e varfërisë.
- Të promovohet mundësia e përdorimit dhe pronësisë së tokës, duke mbështetur zbatimin e detyrueshëm të garancive ligjore kundër dëbimit me forcë dhe të pengimit të të varfërve.
- Të mbështeten investimet në teknologjitë me kosto të ulët, që mund të ndihmojnë komunitetet në përmirësimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.
- Të mbështetet zgjerimi i mundësive të mikrofinancës për bashkësitë rurale dhe të varfra, si pjesë e ristrukturimit të sistemit të kredisë në Shqipëri.
- Të përkrahë heqjen e pagesave për përdoruesit në komunitetet e varfra të shërbimeve sociale jetike.
- Të nxiten drejtuesit e Qeverisë të zotohen publikisht për sigurimin e shërbimeve sociale jetike për të varfërit.
- Të përkrahet parimi se shërbimet sociale jetike duhet pjesërisht të planifikohen dhe menaxhohen në nivel komuniteti dhe të kërkohet integrimi i këtij parimi në strategjinë e decentralizimit.
- Bizneset Shoqërore[38] të drejtuara nga dhe për grupet e prekshme mund të plotësojnë sistemin e mbrojtjes sociale dhe në disa raste mund të lejojnë individët e përjashtuar nga shoqëria të bëhen shtetas më aktivë dhe më produktivë. Numri i individëve të prekur direkt mund të jetë i ulët, por indirekt pamja e grupeve të dobëta dhe e të interesuarve mund të përmirësohet. Megjithëse investimi fillestar mund të jetë i kushtueshëm, bizneset shoqërore mund t'i shpëtojnë paratë e shoqërisë në periudha afat-gjata dhe ato përbëjnë një alternativë të qëndrueshme për asistencë pasive. Sektori privat dhe Qeveria në Shqipëri kanë shprehur zotimin ndaj modelit të bizneseve shoqërore dhe kjo është pjesë e GPRS. Shërbimi i Ri Shpërndarës i Shqipërisë (YAPS) është i pari i këtij lloji në Shqipëri. I krijuar në gusht 2001, ai ka të punësuar 32 jetimë të rinj dhe njerëz me të meta dhe e ka arritur pikën e tij të konsolidimit financiar në mars 2002.[39]
- Të zgjerohet dhënia e mbështetjes së menjëhershme ndaj grupeve të prekshme, siç është ndihma për ushqim në Veri, në bashkëpunim me partnerë të tjerë dhe Qeverinë.
- Kombet e Bashkuara duhet të mbështetin programet, të cilat përfshijnë Administratën Publike dhe Shërbimin Civil, që përmirësojnë transparencën, përgjegjësinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen e gjerë.
- Të promovohet ndërgjegjësimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe standardet e punës mes komuniteteve të biznesit në Shqipëri.
- Politikat e prokurimit të donatorëve duhet t'u japin përparësi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në Shqipëri.
- Të promovohet puna, zhvillimi dhe pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me bashkësitë e varfra, për përmirësimin e fuqisë kontraktuese sociale, politike dhe ekonomike të të varfërve dhe grave.

3.2 Migrimi

3.2.1 PËRKUFIZIM

Duhen bërë disa diferenca konceptuale kyçe ndërmjet kategorive të ngjashme të lëvizjes së popullsisë. Migrimi mund të jetë:

a) emigrimi i jashtëm ose i brendshëm (siç është migrimi ekonomik, shmangia e gjakmarrjeve dhe urbanizimi – lëvizja nga zonat rurale drejt zonave më të populluara);

b) ligjor (me viza zyrtare apo procedura strehimi, etj.) ose i paligjshëm (kontrabanda dhe trafiku i grave dhe fëmijëve);

c) i vullnetshëm (një vendim i menduar jo i detyruar) ose i pavullnetshëm (për mbrojtje apo si pasojë e trafikimit);

d) i përkohshëm (punëtorët migrantë) ose i përhershëm (që mund të çojë në "migrimin e trurit" - humbja e individëve me aftësi të larta produktive) dhe;

e) migrantët mund ta kenë origjinën në Shqipëri ose të jenë tranzit nga një vend tjetër. Trafikimi dhe Kontrabanda me Njerëzit dhe Sistemi i Strehimit janë trajtuar në Kapitullin 7 mbi Sigurinë Personale.

3.2.1 VLERËSIM

Ka një shkallë të lartë të migrimit të jashtëm dhe të brëndshëm në Shqipëri. Forma më e

[38] Fitimet riinvestohen për të përmbushur objektivat shoqërore, siç janë rritja e mundësive të punësimit për personat e pafavorizuar. Shih Biznesi Shoqëror, ISB, 2001. http://www.unicef.org/albania/what_we_do/rulihoxa.pdf

[39] Shih http://www.unicef.org/albania/what_we_do/yaps.htm dhe një artikull në Financial Times, 13 Prill 2002, http://globalarchive.ft.com/globalarchive/article.html?id=020413001735

zakonshme e migrimit të brendshëm është urbanizimi. Popullsia qytetare është rritur nga 31.8% në 1970 në 42.0% në vitin 2000[40]. Migrimi i jashtëm është në pjesën më të madhe i përkohshëm dhe përfshin punëtorët emigrantë, dhe një pjesë e madhe e tyre, por në rënie janë të paligjshëm. Urbanizimi dhe emigrimi nuk tregojnë shenja ngadalësimi. Destinacionet më të zakonshme të brendshme janë Tirana dhe Durrësi, ndërsa destinacionet më të zakonshme të jashtme janë Italia dhe Greqia. Migrantët është më e mundshme të jenë meshkuj se femra. Shumë migrantë, siç janë refugjatët, kërkuesit e strehimit dhe personat subjekt të trafikimit, kalojnë nga Shqipëria prej vendeve të tjera si Turqia dhe Kina. Migrimi i fëmijëve të pashoqëruar nëpërmjet shokëve apo familjes, jashtë, është nganjëherë i krahasueshëm me trafikimin, kur janë të përfshirë grupe kriminale trafikantësh, prostitucioni dhe droge. Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe komuniteteve të diasporës janë të dobëta në krahasim me kulturat e tjera dhe migrantët shqiptarë kanë një imazh të keq jashtë, duke u përballur kështu me përbuzjen.

Statistikat janë shumë të dobëta, pjesërisht nga natyra e parregullt e pjesës më të madhe të migrimit, por vlerësimet mbi migrimin tregojnë se rreth 15%[41] e popullsisë së Shqipërisë jeton jashtë, në çdo kohë të caktuar. Shumë emigrantë dërgojnë në shtëpi para të fituara jashtë (dërgesat), zakonisht në formë parash në dorë. Ky është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet, që mund të sjellë dallim mes varfërisë dhe jo-varfërisë. Statistikat mbi dërgesat janë gjithashtu të pakta, për shkak se nuk janë zyrtare, por vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për dërgesat janë rritur nga 152 milionë USD në vitin 1992 në 568 milion në vitin 2001, në shkallën e moderuar të 15-20% të PBB-së së Shqipërisë. Emigracioni mund të jetë pozitiv, kur u mundëson emigrantëve të përkohshëm të fitojnë aftësi dhe përvojë pune, kur i bën emigrantët të njihen me kultura të tjera dhe kur i mundëson familjet të mbijetojnë.

Shkalla e lartë e migrimit konsiderohet një problem në Shqipëri për shkak të:[42]

a) Ndikimit mbi bashkësinë nga e cila ikin (largimi i "trurit", rritja e ngarkesës dhe e izolimit për gruan që duhet të bëjë punët e përditshme shtëpiake, punën bujqësore dhe rritjen e fëmijëve, braktisja e tokës bujqësore);

b) Ndikimi mbi komunitetin pritës (presioni mbi tregjet e punës, infrastrukturën, kujdesin për shëndetin, arsimin, racizmin dhe ksenofobinë dhe mbingarkesa në sistemet sociale, veçanërisht në rastin e migrimit të brendshëm);

c) Ndikimi mbi vetë migrantët (vështirësitë për t'u integruar në komunitetin pritës dhe tregun e punës, vështirësitë në përdorimin e shërbimeve të mjaftueshme qeveritare[43] dhe infrastruktura, mund të çojnë në përqindje të larta papunësie, kriminaliteti dhe përfshirje në ekonominë informale, rritjen e numrit të fëmijëve që punojnë, si dhe cilësi të ulët ose mungesë në kujdesit për shëndetin e mundësitë për arsimin; si dhe udhëtimi jashtë mund të jetë i kushtueshëm e i rrezikshëm në rastin e emigrimit të paligjshëm). Të rinjtë, veçanërisht ata nga zonat rurale, janë në një pozitë të pafavorshme, sepse niveli i tyre i ulët i njohurive të edukimit seksual i vë ata para rrezikut të HIV dhe STI-ve të tjera dhe niveli i tyre i ulët i njohurive të gjuhëve të huaja i vë ata para rreziqeve më të mëdha për shkak të paaftësisë për të gjetur zgjidhje që të shpëtojnë kur ndodhen në gjendje abuzimi.

3.2.3 ANALIZË

Liria më e gjerë për të zgjedhur vendin e banimit dhe të punës, që shqiptarët e fituan në fillimin e viteve 90-të, solli rritjen e shpejtë të qyteteve kryesore dhe zvogëlimin e popullsisë së përgjithshme, siç mund të shihet sot në Shqipëri. Arsyeja e drejtpërdrejtë për migrim është dëshira apo nevoja për të marrë përfitime në përdorimin e mundësive, relativisht më të mëdha, diku tjetër. Arsyet e veçanta për migrim shkojnë nga migrimi si mjet për përballimin e varfërisë tek migrimi, si mjet i futjes së fëmijëve në një sistem më të mirë arsimi, me arsye të ngjashme për migrimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Mungesa e përgjithshme e mundësive ekonomike dhe e arsimit të duhur, shëndetit dhe sigurisë, sidomos në zonat rurale të Shqipërisë, shtyn shumë individë dhe familje të migrojnë. Niveli i ulët i fuqizimit të grave dhe komuniteteve fshatare mund t'i lërë ata pa alternativa për migrim. Zonat rurale është më e mundshme që të kenë mësues të pakualifikuar dhe është vlerësuar se, gjysma e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor,

[40] Rezultatet paraprake të regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001, Instat
[41] Komunikim Direkt me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, 2001.
[42] Shkaqet dhe Pasojat e emigrimit Shqiptar gjatë periudhës së tranzicionit, EBRD, 1999.
[43] Strategjia e Zhvillimit dhe e Reduktimit të Varfërisë (GPRS), Banka Botërore dhe Ministria e Financave, 2001.

në zonat rurale, kanë dalë jashtë funksionimit që në vitin 1997. Në disa raste migrimi i brendshëm është i motivuar nga nevojat urgjente për të mbijetuar dhe mund të konsiderohet si zhvendosje humanitare.

Rastet e mëposhtme japin arsyet tipike për migrimin e brendshëm: Një familje Veriore mund ta braktisë fermën, për shkak të madhësisë së vogël të saj, teknikave të vjetra dhe klimës së pafavorshme dhe zhvendoset në një vendbanim të rastit pranë qytetit, (të quajtur periferi, ku varfëria është nganjëherë më e egër se në zonat e largëta). Një familje mund ta dërgojë fëmijën për të punuar në një qytet ose mund të dërgojë një të rritur ose një fëmijë të pashoqëruar apo të ri, jashtë, për të gjetur punë dhe për t'i dërguar të ardhurat në shtëpi. Në rastin e emigrimit, një familje mesatare mund të emigrojë për t'i dhënë fëmijës mundësinë e një cilësie më të mirë arsimi. Një profesionist mund të emigrojë për shkak të ndjenjës së tij se mund të pushohet nga puna dhe shpresës së një page më të lartë, sigurisë së punës dhe mundësive të punësimit jashtë. Një student apo një profesionist, duke studiuar apo u specializuar jashtë, mund të mos ketë një motiv për t'u kthyer në Shqipëri dhe kështu mund të zgjedhë të vazhdojë të jetojë jashtë. Shumë të rinj nuk kanë shpresa për të ardhmen e tyre në Shqipëri dhe e konsiderojnë migrimin si mundësinë e vetme për rritje personale.

Në përgjithësi, shërbimet bazë të dobëta, mundësitë e papërshtatshme për punësim, kriminaliteti i lartë dhe gjakmarrjet janë faktorë të zakonshëm nxitës. Një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve njihet si refugjatë në vende të tjera, gjë që është tregues i mungesës së sigurisë dhe perceptimeve të kërcënimeve ndaj të drejtave të njeriut. Flukset e refugjatëve nga Shqipëria kanë përkuar me krizat e brendshme, siç ishte rënia e rendit publik në vitin 1997.

Në përgjithësi, ka patur një mungesë reagimi institucional, si nga Qeveria, ashtu edhe nga Shoqëria Civile. Mungojnë nismat për trajtimin e emigrimit nga Shoqëria Civile si në nivelin qendror nga pikëpamja e kërkimeve dhe të promovimit dhe në nivel lokal, nga pikëpamja e trajtimit të problemeve dhe nevojave të emigrantëve. Ndërsa kuadri ligjor ka përbërës modernë, ai ka nevojë për t'u plotësuar dhe rregulluar në tërësi. Decentralizimi i përgjegjësive dhe kalimi i autoriteteve fiskale te komunitetet lokale mund t'i mundësojë ata të krijojnë të ardhurat e nevojshme dhe të ofrojnë shërbime më të mira.

Një perceptim i gabuar, por i zakonshëm është vështrimi i migrimit, si rezultat i situatës makroekonomike jo funksionale dhe mendimi se migrimi mund të zhduket, kur të përmirësohet ekonomia. Është e rëndësishme të merret parasysh ndikimi i vetë emigrimit në zhvillimin, psh. të ardhurat nga dërgesat i kanë dhënë një shtytje zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Sidoqoftë, kjo e ardhur duhet zhvendosur në sektorin bankar dhe duhet drejtuar drejt investimeve publike më tepër sesa drejt importeve. Emigrantët duhet të nxiten të kthehen e ta transferojnë kapitalin njerëzor dhe teknologjinë në Shqipëri, si dhe të përmirësojnë aftësinë e sektorit shtetëror.

Lidhjet e fuqishme ndërmjet diasporës dhe komuniteteve emigrante dhe vendit të tyre të origjinës, duke përfshirë kulturën, arsimin, votimin dhe gjuhën, mund të ndihmojnë të nxisin dhe të mundësojnë kthimin e emigrantëve, mundësisht duke zvogëluar ikjen e trurit. Ministria e Punëve të Jashtme ka një Institut për Diasporën, por niveli i aktivitetit të tij është i ulët dhe përqendrimi i tij në pakicat historike shqiptare i përjashton shumë emigrantë shqiptarë jashtë.

Bashkëpunimi rajonal dhe iniciativat e zhvillimit rajonal, siç është Pakti i Stabilitetit, duhet të jenë pjesë e strategjisë së gjerë për të zvogëluar presionin për migrim dhe për të përmirësuar përfitimet që vendet e nisjes dhe pritëse marrin nga migrantët. Zbatimi i ligjit është vetëm një mënyrë për të reduktuar emigrimin dhe mund të funksionojë, kur i jepet e njëjta rëndësi zhvillimit të brendshëm të vendit, rritjes së respektit për të drejtat e njeriut, përmirësimit të perceptimeve mbi sigurinë personale dhe krijimit të mundësive ligjore për migrim.

3.2.2 REKOMANDIME

- Mungesa e të dhënave të besueshme mbi nevojat e migrimit duhet të zgjidhet nëpërmjet studimeve të reja, por kjo nuk duhet të shtyjë masat e menjëhershme për të lehtësuar problemet e shkaktuara nga shkalla e lartë e migrimit. Grupet e synuara janë gratë, fëmijët, të rinjtë dhe biznesmenët, duke marrë parasysh diferencat në zonat rurale, periferike urbane dhe pabarazinë e shërbimeve.
- Kombet e Bashkuara dhe partnerët e tyre, duke përfshire IOM, mund të ndërmarrin studime cilësore dhe sasiore për dërgesat nga emigrantët si një motor për rritjen ekonomike, motivimet e prirjet për të migruar dhe ndikimin e emigrantëve tek vendet pritëse.
- Kombet e Bashkuara duhet t'u kushtojnë vëmendje vështirësive të banorëve të zonave

periferike dhe të punojnë për lehtësimin e gjendjes së tyre, duke nxitur dhe mbështetur koordinimin dhe harmonizimin e politikave Qeveritare, shërbimeve dhe infrastrukturës, për t'i bërë ata që t'u përgjigjen më mirë ndryshimeve demografike.

- Në periudha afat-gjata, infrastruktura e përmirësuar, shërbimet Qeveritare dhe mundësitë ekonomike, në zonat rurale, janë të nevojshme për të ulur emigrimin e mëtejshëm. Kombet e Bashkuara mund të mbështesin përpjekjet humanitare, fuqizimin e zonave rurale, krijimin e të ardhurave dhe përpjekjet për të fuqizuar komunitetin që të punojë për këtë objektiv.
- Veprimtari urgjente mund të ndërmerren për të trajtuar nevojat kritike, siç janë mundësia pë të pasur shërbimin shëndetësor dhe institucionet arsimore në disa nga zonat më të përkeqësuara rurale dhe periferike, të cilat së bashku me partnerët e tyre, Kombet e Bashkuara mund të ndihmojnë për t'i identifikuar, promovuar dhe financuar.
- Kombet e Bashkuara dhe partnerët e tyre mund të vazhdojnë të mbështesin respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë zgjidhjet juridike të paanshme dhe efektive.
- Një sistem më i fuqishëm arsimi me diplomë të njohur edhe jashtë vendit, do ta ulë motivimin e familjeve për të emigruar për hir të fëmijëve të tyre. Kombet e Bashkuara mund të mbështesin Qeverinë për përpunimin dhe zbatimin e strategjisë së saj të arsimit dhe të nxisin edhe institucionet e huaja ta mbështesin atë.
- Studentët që studiojnë jashtë kanë nevojë për nxitës për t'u kthyer në Shqipëri dhe specialistët mund të nxiten për t'u kthyer ose për të mos u larguar përmes nxitësve, siç është një pagë më e lartë, garancia e sigurisë së punës dhe e përparimit në karrierë. Kombet e Bashkuara mund të nxisin zhvillimin dhe zbatimin e këtyre stimujve ose të financojnë projekte pilote.
- Kombet e Bashkuara dhe partnerët e tyre mund të ndihmojnë në uljen e shkallës së emigrimit të paligjshëm, duke rritur ndërgjegjësimin për mënyrat dhe përfitimet e të emigruarit të ligjshëm dhe duke siguruar asistencë teknike për të përmirësuar aftësinë e Qeverisë, për të negociuar dhe mbështetur uljen dhe heqjen e barrierave ligjore ndaj emigrantëve shqiptarë. Kjo do ta lehtësojë integrimin e emigrantëve në vendet pritëse, do ta zvogëlojë rrezikun shoqërues të emigrimit të paligjshëm dhe t'u ofrojë migrantëve më tepër alternativa për të mos hyrë në ekonominë informale dhe kriminale.

4 Barazia e Sigurisë së Mundësive

Objektivat e zhvillimit të Mijëvjeçarit

- **Të përkrahet barazia mes gjinive dhe të fuqizohet gruaja**
  - Eliminimi i pabarazisë mes gjinive në arsimin fillor dhe të mesëm mundësisht që nga viti 2005 dhe në të gjitha nivelet e arsimimit jo më vonë se viti 2015

Dokumentet Përkatëse për të Drejtat e Njeriut

- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas (CEDAW)
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve

Në Kushtetutën e vitit 1998 thuhet se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare dhe filozofike, gjendja ekonomike, arsimore dhe sociale ose përkatësia prindërore.

Meqë disa grupeve të shtypura në Shqipëri vijon t'u mohohen sistematikisht e drejta e mundësive kryesore dhe të drejtat e njeriut, ky seksion i kushtohet sigurisë së njeriut lidhur me pakicat, gratë dhe fëmijët.

4.1 Fuqizimi i Gruas

4.1.1 VLERËSIM

Treguesi i Zhvillimit Gjinor i UNDP[45] për vitin 2001 (GDI), e radhiti Shqipërinë në vendin e 74-t nga 146 vende, më i ulti në Evropën Lindore. Gratë Shqiptare priren të kenë një nivel të ulët

Statusi i Pjesëmarrjes së Gruas Mars 2002[44]	Totali	Femra	%
Anëtarë Parlamenti	140	8	5.7
Ministra	19	2	10.5
Zv/ Ministra	23	1	4.3
Drejtor Departmenti/Drejtorë të Përgjithshëm	171	41	24.0
Nëpunës Civilë	1,368	617	45.1
Anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë	14	1	7.1
Kryetarë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Larte	2	0	0.0
Anetarë të Gjykatës së Lartë	11	5	45.4
Kryetarë të Gjykatës së Apelit	24	12	50.0
Kryetarë të Gjykatës së Shkallës së Parë	26	3	11.5
Gjykatës	158	103	65.2

pjesëmarrjeje në procesin e vendim-marrjes dhe ato janë të pambrojtura ndaj dhunës në familje. Normat e përdorimit të kontracepsionit janë të ulta dhe ato të abortit janë të larta. Shih seksionin e Shëndetit. Burrat mund të martohen me ligj në moshën 18 vjeç, ndërsa vajzat 16 vjeç, por mosha mesatare e martesës së parë për djemtë dhe vajzat është shumë më e lartë, përkatësisht 29.3 dhe 23.5 në vitin 1999. Shih Pasqyrën 25 Martesat, Divorcet, Shtëpitë e Fëmijës dhe Birësimet. Jetëgjatësia e pritshme e grave në vitin 1999 ishte 76.4 e krahasuar me 71.7 për burrat[46]. Gratë më të arsimuara priren të përdorin kontraceptiva më modernë, kanë fëmijë më pak dhe martohen dhe lindin në një moshë më të vonë.[47] Gratë shpesh emigrojnë, por jo aq sa meshkujt dhe shumë gra dhe fëmijë janë të rrezikuara prej trafikut dhe prostitucionit. Dhuna në shtëpi duket se po rritet, por shumë pak çështje dalin në gjykatë.

Në periudhën nga viti 2001-2002 kishte 5 gra Kryetare Bashkie, 1 grua Prefekte, dhe 2 gra Ministre. Në periudhën nga viti 1994-2002 kishte 189 gra notere.[48] Gratë hynë në Parlament për të parën herë në vitin 1945 dhe arritën të kenë 1/3 e Parlamentit, gjatë periudhës 1974-1990. Sot situata ka ndryshuar. Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2001 ishin një dështim për gratë; pak gra u

[44] Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, HDPC, 2002.
[45] Bazuar në barazinë mes gjinive në shëndet, arsim dhe në standardet e jetesës. http://www.undp.org/hdr2001/
[46] Femrat dhe Meshkujt. në Shqipëri, Dhjetor 2001, Instat.
[47] Vështrim mbi Njohuritë, Qëndrimet, Praktikat dhe Besimet (KAPB), 2001. http://www.unicef.org/albania/publications/kapb.pdf
[48] Komunikim i drejtpërdrejtë me Shoqatën e Noterëve në Shqipëri, 2002.

zgjodhën si kandidate edhe më pak fituan, kurse gratë nuk përfaqësohen sa duhet në institucionet zgjedhore zyrtare. Eshtë pozitive që shumë parti përfshinë çështjen e gjinive në fushatën e tyre të vitit 2001. Raporti përfiundimtar i OSCE mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 vinte në dukje se është e vështirë për gratë për të marrë pozita udhëheqje në politikë, edhe pse disa parti politike u garantojnë grave një pjesë të pozitave

Kuadri Ligjor për Barazinë mes Gjinive

- Parimi i barazisë u shpall zyrtarisht në vitin 1946
- Barazia u garantua në Kushtetutën e vitit 1998, që ndalon diskriminimin mbi bazën e gjinisë. Përfshin të drejta të barabarta në arsimim dhe pronësi.
- Shqipëria është nënshkruese e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut
- Kodi Civil (të drejtat në procedurat ligjore)
- Kodi Penal (mbrojtje & ndëshkim)
- Kodi i Punës (e drejta për të punuar dhe pagat e njëjta)
- Kodi i Familjes (e drejta për t'u martuar dhe divorcuar, të drejtat dhe detyrimet lidhur me familjen dhe fëmijët)
- Ligji mbi sigurimet shoqërore i jep gruas të drejta të veçanta lidhur me mbajtjen e fëmijëve

udhëheqëse dhe gratë janë mjaft të përfshira në nivelin e bazës. Gratë fituan 5.7% të vendeve në Parlamentin e vitit 2001, duke rënë nga 7.1% në vitin 1997.[49] Shih Pasqyrën 18 Anëtarët e Parlamentit sipas Gjinisë dhe Pasqyrën 17 Gratë e Zgjedhura në Pushtetin Lokal.

Përderisa sistemi Parlamentar Shqiptar është një përzierje e zgjedhjeve direkte dhe përfaqësimit proporcional, kishte dy lista kandidatësh në vitin 2001. 7% e kandidatëve direkt (78 nga 1.114) dhe 15% e kandidatëve proporcionalë (120 nga 823) ishin gra. Shifra e dytë e zmadhon kandidaturën e grave përderisa një pjesë më e vogël ishte në krye në radhitjen e dhënë nga partitë për të patur një mundësi për t'u zgjedhur. Ashtu si për institucionet zgjedhore, nuk kishte asnjë grua anëtare të përhershme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe jashtë zonave të vizituara nga vëzhguesit e huaj gratë përbënin 7% të anëtarëve të KQZ dhe 8% të anëtarëve të KQV[50]. Eshtë interesante se në Zgjedhjet e majit 2001 në 4 nga 12 Prefekturat për vendet në Parlamentin e Rinisë, rreth 35.000 të rinj votuan, ndër të cilët 60% e atyre të zgjedhur ishin femra.[51]

Shumë gra ishin analfabete para Luftës së Dytë Botërore. Zhdukja e analfabetizmit dhe arsimimi u përmirësuan shumë gjatë regjimit të mëparshëm si për burrat ashtu edhe për gratë, por situata u përkeqësua gjatë periudhës së tranzicionit.[52] Shkolla tetëvjeçare është e detyrueshme për burrat dhe gratë dhe nga Kushtetuta u janë garantuar të drejta të barabarta, por ende ka diferenca në arsimim. Ndërsa shumica e përgjithshme e mësuesve janë gra, ato vazhdojnë të përfaqësohen më pak si pedagoge në arsimin e lartë. Gratë përbëjnë 63.2% të 28.293 vendeve në arsim në vitet 2000-2001, por vetëm 38.7% e rreth 1.700 pedagogëve në arsimin e lartë, 5.8% prej 222 profesorëve të universiteteve dhe 30.2% të 288 asistentë profesorë ishin gra.[53] Nga ana tjetër, gratë janë mbi përpjesëtimet si studente në arsimin e lartë. Shumë drejtues të shkollave janë meshkuj, megjithëse gratë përbëjnë shumicën dërrmuese të punonjësve në sektorin e arsimit. Shih Pasqyrën 20 Niveli 0-5 – Përqindja e Femrave Studente dhe Pasqyrën 21 Numri i Femrave të Diplomuara dhe Mësueseve.

Kodi i Punës përcakton pagë të njëllojtë për punën e njëllojtë, por diskriminimi në paga në Shqipëri tregon se sipas burimeve pagat e grave priren të jenë 80-85% e atyre të burrave.[54] Ka prirje që gratë të mos paguhen për punën jashtë orarit dhe norma e papunësisë për gratë është më e lartë se për burrat, si dhe është rritur gjatë periudhës së tranzicionit. Gratë nëpër burgje kanë kushte shumë të këqija higjienike dhe praktikisht nuk kanë shërbimet për fëmijët e vegjël apo vizitat e bashkëshortëve.

Iniciativat për të përmirësuar situatën dhe fuqinë e gruas përfshijnë aktivitetet e shumë grave të OJQ-ve dhe krijimin e Nënkomisionit Parlamentar për të Rinjtë dhe Gratë në vitin 1997 dhe Departamentit të Grave dhe Familjes brenda Ministrisë së Punës në vitin 1994. Ky departament u bë Komitet Shtetëror për Gratë dhe Familjet (SCWF) me dekret të Këshillit të Ministrave në vitin 1998 dhe në vitin 2001 Këshilli i Ministrave e ndryshoi emrin e këtij komiteti në

[49] Raport Final, OSCE, 2001.
[50] Po aty
[51] Parlamenti i të Rinjve paraqiti zgjedhjet nëpër Shqipëri, UNICEF, 2001. Dy Prefektura të tjera mbajtën zgjedhjet e Parlamentit të të Rinjve në vitin 2000.
[52] Gratë më 2000: Shqipëri, Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për Të Drejtat e Njeriut. http://www.ihf-hr.org/reports/women/albania.pdf
[53] Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, HDPC, 2002.
[54] Raporti Kombëtar për Gratë në Shqipëri i vitit 1999, UNDP. http://www.undp.org.al/publications.htm
Burimi origjinal i kësaj statistike nuk specifikohet.

Komitet Shtetëror për Mundësi të Barabarta (SCEO). Mandati kryesor i Komitetit është të hartojë e të zbatojë politikat, si dhe të koordinojë përpjekjet jo shtetërore për nxitjen e barazisë mes gjinive. Ky Komitet po bën përkthime zyrtare shqip të konventave mbi të drejtat e njeriut, por atij i mungon aftësia në këtë fushë për të trajtuar probleme të ndërlikuara. Ai përgatiti Platformën e Qeverisë Shqiptare për Gratë për vitin 1999-2000, por problemet sociale, veçanërisht ato mes gjinive, akoma nuk kanë tërhequr shumë vëmendjen dhe zotimin e Qeverisë. Plani Kombëtar i Veprimit për Përparimin e Grave dhe Barazinë mes Gjinive kërkon që problemet e gjinive duhet të merren parasysh në iniciativat e Qeverisë dhe të garantohen nga Komitetit i Shtetit për Mundësi të Barabarta.

4.1.2 ANALIZË

Ushtrimi real i të drejtave politike të grave është i lidhur ngushtë me ushtrimin e të drejtave ekonomike dhe sociale.

Burimi: Raporti Kombëtar Shqiptar për Gratë 1999

Ngarkesa dyfishe e grave si punëtore dhe nëna është një mentalitet i vjetër socialist, që mbetet akoma në Shqipëri. Gratë fshatare bëjnë punët e përditshme, siç është sigurimi i ujit dhe i drurëve të zjarrit, larja dhe pastrimi, e gjithashtu, marrin pjesë përbri burrave në punët bujqësore, që janë të vështira për shkak të përdorimit të vogël të plehrave dhe mekanizmave. Gjatë regjimit të mëparshëm për gratë zbatohej barazia në fushën e arsimit dhe të punësimit (së bashku me pozitat e larta në politikë). Aktualisht, në mungesë të barazisë sa për sy e faqe, pabarazia është përkeqësuar për gratë dhe traditat e vjetra e të dëmshme, kufizuese, kanë rifituar fuqitë, sidomos në disa zona rurale, ku është ringjallur kodi i njohur si Kanuni. Mentalitetet dhe traditat janë në themel të barazisë mes gjinive dhe priren të jenë më konservatore në zonat rurale.

Është i nevojshëm zbatimi i detyruar dhe përkrahja e të drejtave të barabarta dhe statusit ligjor të grave. Kuadri ligjor është i lavdërueshëm për statusin e barabartë që u jep grave, por ai nuk merr parasysh rolin e gjinive të përcaktuar nga tradita dhe në përgjithësi nuk ndërmerr hapat e nevojshëm për të zgjidhur diskriminimin e vazhdueshëm që rezulton nga e kaluara.

Për shembull, ndërsa nuk ka ligje diskriminimi lidhur me kredinë për gratë, është akoma e vështirë për ta marrë atë, në disa zona rurale, ku vlerat tradicionale janë të forta, madje edhe bankat në zonat qytetare ngurrojnë t'u japin hua grave. Raporti Kombëtar për Gratë argumenton se natyra e politikës shqiptare i pengon disa gra për të hyrë në politikë.

Akoma vazhdojnë të ndodhin aborte të rrezikshme. Shumë grave u mungon informacioni mbi shërbimin shëndetësor të riprodhimit dhe problemet lidhur me të, kurse shumë prej tyreve u mungon fuqia brenda marrëdhënieve të tyre për të zbatuar metodat e planifikimit familjar, megjithëse ato janë të ligjshme.

Gratë (veçanërisht ato në moshë të thyer), shpesh varen nga të tjerët ekonomikisht, sidomos nga burrat, përderisa gratë janë shpesh të papuna, shpesh nuk mbulohen nga sigurimet shoqërore gjatë punës së tyre, zakonisht jetojnë më gjatë se burrat dhe shpesh bëjnë punë të papaguar në shtëpi. Gratë mund të trashëgojnë tokën në mënyrë të ligjshme, por tradicionalisht është djali ai që trashëgon. Nga procesi i privatizimit përfituan më tepër burrat se gratë, përderisa burrat janë përfaqësuesit e familjeve zakonisht për administrimin e pronës. Nga ana tjetër, gratë janë kryefamiljare të 80% të familjeve me një prind dhe grave u jepet kujdestaria e fëmijës në 4 nga 5 raste gjyqësore.[55] Vendimet e gjykatës për pagesë ushqimore nga ana e burrave, në rastet e ndarjeve, janë të vështira për t'u zbatuar. Shpesh, një grua duhet të jetojë në shtëpinë e burrit. Në raste të tilla, gjykatësi i jep burrit të gjitha të drejtat mbi pronën, në rast divorci. Pasuria e fituar gjatë martesës konsiderohet e përbashkët, por shumë çifte të divorcuara nuk mund ta përballojnë humbjen nga shitja e pronës, kështu që ata shpesh janë të detyruar të vazhdojnë të jetojnë së bashku, gjë që rrit rrezikun e dhunës në shtëpi.

Ashtu si grave u caktohen role të ndryshme në familje, ekziston një prirje për t'u caktuar role të ndryshme edhe në vendin e punës. Komiteti Shtetëror për Gratë dhe Familjen më 1997 bëri të njohur se shumica e grave të punësuara punojnë në bujqësi (70%) dhe në sektorin publik (20%); të dy këta sektorë kanë paga dhe prestigj shumë të ulët. Vetëm 10% mban vende në sektorin privat.[56] Këto role tradicionale ndërthuren me sjelljet diskriminuese për të kufizuar mundësitë e grave për të përmirësuar nivelin e tyre të mirëqenies dhe për të marrë pjesë në vendim-marrje. Një grua me të njëjtin nivel arsimi si një burrë, priret të ketë më shumë vështirësi në hyrjen në një post më të lartë privat dhe publik dhe gratë priren të ndjekin drejtimet stereotipike të karrierës.

[55] Raporti Kombëtar i Grave në Shqipëri 1999, UNDP.
[56] Gratë e Botës: Ligjet dhe Politikat që Prekin Jetën e Tyre Riprodhuese: Evropa Qëndrore Lindore. 2000. Shoqata Shqiptare e Planifikimit Familjar. www.crlp.org/pub_bo_wowece.html

Përfshirja e paktë në vendim-marrje duket se është e lidhur me rolin tradicional dhe përfshirjen e grave në fusha të tjera. Ashtu si në shumë shoqëri, është gruaja ajo që është e prirur të kompensojë mungesën e përkrahjes publike për të sëmurët, pleqtë e fëmijët. Për më tepër gratë kryejnë punët e përditshme të shtëpisë dhe të bujqësisë, sidomos kur anëtarët meshkuj të familjes emigrojnë për të kërkuar punë. Grave u mungon koha dhe fuqia për të konkurruar me burrat në hierarki, pasi ato janë shumë të ngarkuara me punët e papaguara shtëpiake. Turpi për divorcin ka rënë gjatë tranzicionit. Disa gra braktisen kur anëtarët e familjes meshkuj emigrojnë dhe procedurat e rrepta

Siguria është një shqetësim në disa zona, veçanërisht për vajzat në moshë shkollore, që nuk mund të ndjekin mësimet nga frika e grabitjes. Grupet më të rrezikuara janë gratë që janë kryetare familje me fëmijë, gratë e braktisura nga burrat, gratë mbi të cilat abuzohet brenda familjes dhe gratë që bëhen prostituta (shpesh nëpërmjet mashtrimit apo abuzimit me traditat martesore).

të emigrimit e kanë bërë të vështirë bashkimin familjar jashtë.

Tradita e sundimit të burrave në familje është ringjallur, duke e vënë gruan përballë rrezikut të abuzimit dhe kufizon fuqinë e gruas për të kontrolluar jetën riprodhuese në këto zona, nëpërmjet përdorimit të metodave kontraceptive. Dhuna në familje nuk konsiderohet një problem publik dhe nuk specifikohet në Kodin Penal. Policia priret të mos ndërhyjë dhe proceset gjyqësore fillojnë vetëm kur vetë viktima bën padi dhe përgatit çështjen. Abuzimi seksual në vendin e punës ndalohet në Kodin e Punës, por jo në Kodin Penal.

OJQ të ndryshme, që mbështesin masat parandaluese të dhunës kundër grave dhe kurimin e viktimave, nuk kanë trajnimin dhe bashkëpunimin e mjaftueshëm. Policia, prokurorët dhe personeli i shërbimit shëndetësor, duke përfshirë mjekët, infermierët dhe mamitë, nuk mbajnë statistika mbi abuzimet në familje. Varësia ekonomike është arsyeja kryesore se pse gratë shtëpiake janë në pozita abuzimi shumë më tepër sesa gratë e punësuara jashtë shtëpisë.

4.1.3 REKOMANDIME

- Barazia gjinore nuk duhet të konsiderohet si një çështje e izoluar, por si një temë e kryqëzuar për t'u ndërfutur në shumë lloje iniciativash të Kombeve të Bashkuara, Qeverisë dhe të tjera në të gjitha fazat, duke përfshirë vlerësimin, zonimin, planifikimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin.[57]
- Integrimi i gjinive mund të ndodhë vetëm kur zbatohet sipas një strategjie për të siguruar një mjedis mundësish të barabarta për burrat dhe për gratë.
- Një analizë e gjinive e Strategjisë së Zhvillimit dhe të Uljes së Varfërisë mund të japë ndihmesë në dialogun politik mbi barazinë mes gjinive.
- Duhen patur në qendër të vëmendjes mungesa e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave, mungesa e sigurimit të informacionit për gratë, mungesa e zbatimit të ligjit dhe e sigurisë, mungesa e alternativave për gratë që t'u lehtësohet puna për shtëpinë, mungesa e infrastrukturës për kohën e lirë dhe mungesa e qëndrimit, që nxisin dhe u lejojnë grave mundësi të barabarta për të hyrë në proçeset e vendim-marrjes.
- Duhen parë si përparësi në programin e Qeverisë: promovimi dhe integrimi i grave në jetën publike dhe private, me të njëjtat mundësi si burrat, për të përmirësuar mirëqenien dhe për t'i integruar në vendim-marrje, pa diskriminim mes gjinive
- Promovimi i koncepteve të barazisë nëpërmjet medias dhe mjeteve të tjera të komunikimit.
- Duhet njohur dhe promovuar kontributi dhe roli këshillimor i grave të OJQ-ve në Shqipëri, ashtu si dhe i shoqatave të tjera të grave dhe atyre që mund të përfshijnë shumë gra, si psh. Shoqata e Prindërve dhe e Mësuesve (ShPM).
- Shërbimi shëndetësor, zbatuesit e ligjit dhe punonjësit socialë duhet të bëhen të ndjeshëm ndaj dhunës kundër grave, të kualifikohen për të identifikuar shenjat e abuzimit, të përgatiten për t'u siguruar grave shërbimet e nevojshme dhe të organizuar për të punuar së bashku. Gratë duhet të njohin se çfarë shërbimesh dhe alternativash ligjore mund të përdorin.[58]
- Mund të ndryshohen sjelljet ndaj dhunës në familje dhe abuzimit ndaj grave në periudhën afatgjatë nëpërmjet debatit publik dhe fushatave të komunitetit me objektiv prindërit dhe mësuesit.
- Ministria e Arsimit duhet të luajë një rol në kualifikimin e mësuesve dhe në përgatitjen e materialeve shkollore mbi këto çështje, ndërsa Universiteti i Tiranës duhet të kualifikojë mësuesit e ardhshëm që të bëjnë të ndërgjegjshëm fëmijët ndaj problemeve të dhunës dhe të sigurojë që mësuesit të jenë

[57] Shih Strategjinë e Integrimit të Gjinive, UNDP Shqipëri, për shembuj të objektivave dhe treguesve specifikë.
[58] Për më shumë rekomandime shih: Harta e Informacionit Ekzistues mbi Dhunën në Familje në Shqipëri, 2000. http://www.unicef.org/albania/publications/domviol.pdf

të aftë të përcaktojnë fëmijët që kanë pësuar abuzime dhe të sigurojnë referimet e nevojshme.
- Është e rëndësishme ngritja e ndërgjegjësimit dhe të aftësive të gazetarëve të cilët shpesh viktimizojnë femrat e abuzuara dhe forcojnë stereotipe.
- Duhet t'u jepet fund vonesave në financimin dhe plotësimin me personel të mekanizmave ekzistues për promovimin dhe mbrojtjen e grave dhe e të drejtave të tyre.
- Edukimi publik dhe politik ne shkolla për djemtë dhe vajzat mund të forcojë parimin e barazisë. Kjo përfshin integrimin e koncepteve të barazisë së gjinive në programet në shkollë.
- Të rishikohet legjislacioni për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç është Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas.[59]

4.2 Diskriminimi i Pakicave

4.2.1 PËRKUFIZIM

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial e përcakton diskriminimin racial si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo favorizim i bazuar në racën, ngjyrën, prejardhjen kombëtare ose etnike, që ka qëllim ose pasojë të zhdukë apo dëmtojë njohjen, të gëzuarit apo zbatimin, në kushte barazie të të drejtave të njeriut dhe liritë themelore në fushën politike, sociale, ekonomike ose çfarëdo fushe tjetër të jetës publike.

4.2.2 VLERËSIM

Informacioni në këtë pjesë është më tepër cilësor, sepse mungojnë të dhënat empirike mbi situatën e pakicave në Shqipëri. Ndryshe nga Regjistrimi i popullsisë i vitit 1989, pyetjet për origjinën etnike dhe besimin mungonin në Regjistrimin e popullsisë të prillit të vitit 2001. Një vëzhgim i rëndësishëm është se në Shqipëri shumë grupe minoritare nuk përballen me kushte të njëjta. Shumë Romë[60] bëjnë një jetë të vështirë nën diskriminim sistematik, ndërsa Malazeztë dhe Serbët (të përqendruar në Veri) dhe Vllehtë (të njohur edhe si Aromunë, të përqendruar në

Në total ka të paktën 8 deri 10 milion romë nëpër botë. Rreth 0.5 milionë romë u vranë gjatë holokaustit. Shumica e romëve jetojnë në kontinentin Evropian, duke formuar një minoritet të gjerë, por shumica e tyre jetojnë në vende që nuk bëjnë akoma pjesë në Bashkimin Evropian. Romët nuk janë pjesë e asnjë shteti dhe as territori. Ndërsa lidhjet familjare janë të forta midis romëve, shumë romë nuk kanë ndjenjën e bërjes pjesë në një komb më të madh përmes kufijve apo një komuniteti kulturor. Organizatat ndërkombëtare që mëtojnë se përfaqësojnë romët po lindin dhe ka tashmë shumë grupe romësh në nivel komuniteti.

Jug) priren të kenë një nivel të ngjashëm mirëqenieje me Shqiptarët. Maqedonasit (të përqendruar në Prespë, në Shqipërinë juglindore) priren të jenë më keq. Grekët, të cilët formojnë minoritetin më të gjerë dhe janë të organizuar mirë, priren të jenë më mirë se Shqiptarët.

Ndërsa grekët kanë ankesa të shumta, marrëdhëniet midis pakicave dhe popullsisë së përgjithshme në Shqipëri, duken relativisht të mira, me përjashtim të rastit të romëve.[61] Katër grupet kryesore të romëve Shqiptarë janë Kallbuxhile, Mokcarët, Kartofët, dhe Cergarët.[62] Romët jetojnë në shumë qytete të Shqipërisë dhe në rrethinat e Tiranës dhe vlerësohen të ishin 30,000 në vitin 2000.[63] Ky minoritet përballet me kushtet e vështira në kundërshtim me garancitë legjislative të barazisë. Kundrejt Shqipërisë në tërësi, të ardhurat, analfabetizmi, nivelet e arsimit, standardet e jetesës, veshja, ushqimi dhe shërbimi shëndetësor priren të jenë më të ulëta midis romëve. Përmasat e papunësisë, të mungesës së banesës, braktisjes së shkollës dhe ndjekjeve të policisë, siç raportohet nga grupet e të drejtave të njeriut, janë më të larta për romët.

Një vrojtim mes 400 të rinjve nga mosha 9-17 vjeç zbuloi perceptimet e mëposhtme të diskriminimit: 57% ndjejnë se fëmijët e paaftë, 43% se fëmijët e grupeve të tjera etnike dhe 41% se fëmijët nga familjet e varfra trajtohen padrejtësisht-veçanërisht fëmijët nga Qyteti i Tiranës. 85% thonë se ka një trajtim të drejtë për fëmijët e besimeve të tjera.[64]

Në Shqipëri është e ndaluar të krijohet një parti politike mbi një bazë etnike, fetare apo

[59] http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/
[60] Romët njihen gjithashtu dhe si ciganë. Disa e quajnë veten evgjitë të dalluar nga romët. Evgjitët mëtojnë se kanë prejardhje nga Egjipti dhe janë të lokalizuar në periferi të zonave urbane dhe të integruar me Shqiptarët e tjerë.
[61] Raporti i vendeve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut - 2001: Shqipëri, Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, Mars 2002. http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2001/eur/8219pf.htm
[62] Raport mbi Zbatimin e Projektit "Mbi Statusin e Minoriteteve në Republikën e Shqipërisë". KSHH . http://www.ihf-hr.org/reports/0009albania.htm
[63] Të Drejtat e Njeriut në Rajonin e OSCE: Shqipëri, IHF, 2001. http://www.ihf-hr.org/reports/ar01/Country%20issues/Countries/Albania.pdf
[64] Zërat e Rinj, UNICEF, 2001.

rajonale, sipas ligjeve të vitit 1991 mbi partitë politike. Asnjë vend në Parlament nuk rezervohet për minoritetet, por Parlamenti përmban 5-10 përfaqësues të minoriteteve, kryesisht të atij Grek[65] dhe një numër më i madh ka pririe të zgjidhet në organet e pushtetit lokal. Qeveria Shqiptare deklaron se ka për qëllim që të ofrojë shërbime sociale, duke përfshirë shërbimin shëndetësor dhe arsimor për pakicat ashtu si për shqiptarët e tjerë. Ligji i vitit 1995 mbi Sistemin Arsimor pranon të drejtën e pakicave për të studiuar dhe mësuar në gjuhën amëtare.

Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998 së bashku me politikat e tjera dhe ligjet siguron barazinë e të gjithë shtetasve dhe ndalon diskriminimin në mbajtjen e pronësisë dhe mbrojtjen sociale mbi bazën e origjinës etnike. Në përputhje me nenet 60-63, në vitin 1999 u krijua Avokati i Popullit "për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo e të parregullta të organeve të administratës publike" dhe për të bërë rekomandime. Departamenti i Prefekturave, në Ministrinë e Pushtetit Lokal, përmban një Sektor të Pakicave Kombëtare, që mbikëqyr përfshirjen e pakicave në vendim-marrjen lokale dhe kombëtare. Në vitin 2000, u krijua në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Zyra e Pakicave Kombëtare për të mbikëqyrur përputhjen e Shqipërisë me Marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me Pakicat, siç janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

4.2.3 ANALIZË

Situata e maqedonasve, grekëve dhe vllehve në Shqipëri është përmirësuar nga mundësia që kanë shumë anëtarë të familjës për të emigruar përkohësisht, e lehtësuar nga lidhjet kulturore me vendin e tyre të origjinës.[66] Strukturat politike lokale e përfaqësojnë mirë pakicën greke. Shqipëria kurrë nuk ka patur shkolla në gjuhën Malaziase dhe aftësia e malazezve dhe serbëve për të patur përfitime nga emigrimi është kufizuar nga mungesa e stabilitetit në Mal të Zi, megjithëse shumë janë kthyer për të jetuar atje. Podgoranët (malazeztë e besimit Mysliman) janë integruar me shqiptarët kohë më parë. Në asnjë vend nuk janë të mirëpritur migrantët romë, siç tregohet nga diskriminimi në shumë vende kundër romëve që kërkojnë strehim dhe nga debati brenda Bashkimit Evropian mbi lëvizjen e lirë të krahut të punës

ROMËT: Shumica e romëve ishin endacakë deri në vitet 1960, kur ata të grumbulluar në qendra të caktuara u detyruan të punojnë në fermat shtetërore apo pastrimin e plehrave. Udhëheqësit e komuniteteve Rome priren sot të japin një pamje optimiste të mos-diskriminimit dhe marrëdhënieve të mira me Shqiptarët, por treguesit socialë japin një pamje të ndryshme nga kjo. Si në rastin e grave, shumë minoritete ishin punësuar sipas barazisë së detyruar të regjimit komunist, një gjendje që nuk ruhej dot gjatë tranzicionit, pasi stereotipa dhe diskriminimi rifituan ndikimin e tyre. Gjatë procesit kaotik të privatizimit të tokës dhe pronësisë, romëve u mungoi pushteti politik për të ndikuar në shpërndarjen dhe ata kanë qenë veçanërisht të rrezikuar nga dëbimet.

Megjithëse sasia monetare e ndihmës ekonomike e dhënë nga Qeveria është krejt e vogël, ajo përbën një pjesë të madhe të të ardhurave të romëve që arrijnë ta marrin. Familjet rome priren të jenë të mëdha me një mesatare 5-6 lindje për familje.[67] Shumë përpiqen të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike nëpërmjet migrimit brenda Shqipërisë apo emigrimit. Të tjerët i fitojnë të ardhurat nëpërmjet kërkimit të lëmoshës, një zgjidhje e përkohshme që rrit diskriminimin, ose jetojnë me paga të ulta që marrin nga një punë e përkohshme që mund të gjejnë. Punonjësit e rastit nuk marrin ndihmë ekonomike, kur dalin të papunësuar. Gjithashtu, disa romë e ndjejnë se ata kanë më pak mundësi të punësohen sesa shqiptarët që kanë të njëjtat aftësi dhe se rrezikojnë të akuzohen, nëse mbështesin një parti politike gjatë fushatave elektorale.

Romët, shpesh kanë ndjenja të dyzuara ndaj integrimit, sepse duan përmirësimin e statusit, edukimit dhe bashkëpunimit, por janë të shqetësuar se integrimi total mund të sjellë asimilimin dhe humbje të aspekteve më të mira të kulturës së tyre. Kjo përdoret shpesh si motiv për të justifikuar izolimin e tyre, duke e bërë të vështirë të përcaktohet masa në të cilën shtrihet izolimi i tyre në disa komunitete, nëse është rezultat i diskriminimit nga jashtë apo i dëshirës së brendshme për të ruajtur kulturën e tyre. Ky izolim është i zakonshëm, psh. në rastin e romëve në Korçë dhe në Shkodër. Cilësia e shërbimeve, infrastruktura dhe vendbanimi duket se janë më të varfra në zona të banuara kryesisht nga romët.

Arsyeja për izolimin e tyre është shumë më

[65] Situata ligjore e romëve në Evropë, Këshilli i Evropës, Mars 2002. http://stars.coe.fr/doc/doc02/EDOC9397.htm

[66] Vlerësimi Cilësor i Varfërisë në 10 rrethe të Shqipërisë, WB dhe QSES, 2001. http://www.minfin.gov.al/initiatives/gprs/documents/qualitative/qa.html. Në veçanti grekët përfitojnë nga vizat, lejet e qëndrimit dhe të punës, nga arsimi dhe shërbimi shëndetësor

[67] Raport mbi Zbatimin e Projektit mbi "Statusin e Minoriteteve në Republikën e Shqipërisë". KSHH http://www.ihf-hr.org/reports/0009albania.htm

Korrupsioni i përhapur gjerësisht, i pranishëm në institucionet publike gjithashtu mund të diskriminojë indirekt, ata që nuk kanë lidhjet e duhura apo mjetet për të patur shërbimet publike, shërbimet bazë ose punësim.[68]

pak e dyshimtë në klasa, ku për fëmijët e romëve ka prirje të ketë një vëmendje më të vogël nga mësuesit dhe i mbajnë veçmas nga fëmijët e tjerë, në fund të bankave.[69] Përqindja e ulët e ndjekjes së shkollës është, gjithashtu, një simptomë e nevojës së rinisë për të mbështetur familjen ekonomikisht, e mënjanimit të tyre në klasë, e frikës së tyre për abuzime nga studentë të tjerë dhe e ringjalljes së një jete endacake pasi tranzicioni i dha fund qëndrimit të detyruar të vendbanimit. Nganjëherë është e nevojshme për rininë që të emigrojë për të gjetur punë. Shqipëria nuk ka patur kurrë një shkollë në gjuhën Rome.

4.2.4 REKOMANDIME

- Përpjesëtimi i pakicave në popullsi është i vogël, por përderisa disa grupe përballen me probleme serioze sociale, politike dhe diskriminimin ekonomik, nevojitet vëmendja e Kombeve të Bashkuara për të mbështetur të drejtat e tyre të njeriut.
- Raporti i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) i vitit 2000 për Shqipërinë vërente se, as minoritetet dhe as qeveria nuk konsiderojnë si përparësi diskriminimin e pakicave, kështu që duhet bërë shumë punë për të kështilluar dhe për të ndërgjegjësuar publikun mbi këtë problem.[70]
- Një studim për analizimin e formave të diskriminimit të tërthortë, me të cilin përballen minoritetet, do të thellojë të kuptuarit e tyre dhe do të mundësojë ndërhyrjet e duhura.
- Pakicat e mënjanuara e të shpërfillura duhen ndihmuar me një veprim pozitiv.
- Një vëmendje më e madhe dhe financimet e projekteve, duhet të përfshinë romët direkt, sa më shumë që të jetë e mundur, si planifikues, zbatues dhe përfitues, dhe të mos bëhen një biznes i shfrytëzuar nga të tjerët. Një shembull i trajtimit të këtij problemi është arritja e ndërgjegjësimit përmes folësve të anglishtes dhe përdoruesve të Internetit, si dhe sjellja e lajmeve për financime në vëmendje të shoqatave lokale të komunitetit Rom.
- Qeveria, Kombet e Bashkuara dhe Shoqëria Civile duhet të nxisin tolerancën dhe vlerësimin e dallimeve etnike në fushën e medias, kulturës, rinisë dhe edukimit, shoqërisë civile dhe shtetit, parlamentit dhe administratës.[71]
- Duke pranuar modelet Evropiane, ku diskriminimi priret të jetë më i fortë me pushtetin lokal, Qeveria duhet të japë siguri se minoritetet nuk do të dalin të pafavorizuar nga procesi në që po bëhet i decentralizimit.
- Ulja e analfabetizmit midis të rinjve duhet të jetë një nga përparësitë më të mëdha ku duhet ndërhyrë.
- Kuadri ligjor për barazinë lidhur me pakicat, duke përfshirë instrumente ligjore ndërkombëtare, ka nevojë të zbatohet më mirë.
- Duhet vendosur një sistem mbikëqyrje, vëzhgimi dhe raportimi në fushat e diskriminimit të mundshëm të minoriteteve.

4.3 Fëmijët në kushte të pafavorshme

4.3.1 VLERËSIM

Fëmijët në Shqipëri përballen me rreziqe në shumë drejtime. Për shembull, qindra fëmijë janë të mbyllur në shtëpitë e tyre, ku nuk mund të kenë arsimimin dhe të zhvillohen si fëmijët e tjere, pasi ata mund të vriten nga familjet gjakmarrëse, nëse dalin nga shtëpia. Këto gjakmarrje janë pjesë e kodit të nderit, të quajtur Kanun, që është ringjallur veçanërisht në Veri, ku janë zonat më të varfra të Shqipërisë dhe ku kontrolli i shtetit është i dobët. Gjakmarrjet, izolimi dhe ngujimi i familjeve prek burrat dhe djemtë, por edhe gratë e vajzat. Një shembull tjetër i rrezikut për fëmijët është shfrytëzimi i tyre nga trafikantët: shih pjesën 7.2 Trafikimi dhe Kontrabanda e Njerëzve. Kjo pjesë përqendrohet në katër probleme të tjera: fëmijët e paaftë, fëmijët në institucione, fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët e rrugëve dhe ata që punojnë.

FËMIJËT E PAAFTË: Sistemi i sotëm i ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale në Shqipëri nuk është i aftë të japë shërbimet e duhura për fëmijët dhe adoleshentët me paaftësi fizike dhe mendore. Ka gjithsej 10 shkolla speciale për fëmijët me paaftësi në të gjithë

[68] Raporti i dytë i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) mbi Shqipërinë, 16 Qershor 2000, (http://www.ecri.coe.int/en/08/01/01/CBC2%20Albania.pdf)
[69] Vlerësimi Cilësor i Varfërisë në 10 rrethe të Shqipërisë, WB dhe QSES, 2001. "http://www.minfin.gov.al/initiatives/gprs/documents/qualitative/qa.html" http://www.minfin.gov.al/initiatives/gprs/documents/qualitative/qa.html
[70] Po aty
[71] Të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet Kombëtare, Pakti i Stabilitetit - Tryeza I, Tetor 2001.

Shqipërinë, me një kapacitet të përgjithshëm prej 650 nxënësish, ndërsa Ministria e Arsimit ka regjistruar 12.000 fëmijë me paaftësi që kanë nevojë për shkollim. Ka 2 Qendra Ditore dhe 5 Qendra me fjetore për vlerësimin dhe rehabilitimin e fëmijëve me paaftësi fizike dhe të të mësuarit, që kanë një kapacitet total prej 250 fëmijësh, të pamjaftueshëm në krahasim me nevojën e përgjithshme. Shërbimet në shtëpi dhe në komunitet pothuajse nuk ekzistojnë.[72] Përveç problemeve të integrimit në sistemin e arsimit, shërbimet mjekësore dhe shërbime të tjera të specializuara janë shumë të kufizuar, prandaj edhe aktiviteti dhe ndërveprimi i fëmijëve të paaftë është i kufizuar brenda shtëpive të tyre. Për fëmijët me paaftësi fizike, mjedisi jashtë shtëpive të tyre është i vështirë për t'u gjetur. Megjithëse ka shumë inisiativa-veçanërisht midis Shoqërisë Civile-të drejtuara për rehabilitimin dhe integrimin e njerëzve të paaftë dhe fëmijëve të paaftë, ka akoma një numër të madh të fëmijëve të paaftë që nuk marrin asnjë lloj trajtimi apo mbështetjeje.

FËMIJËT E VENDOSUR NË INSTITUCIONE: Sot në Shqipëri, numri i institucioneve (për fëmijët e braktisur) mbetet i njëjtë me atë para tranzicionit. Në total, ka 10 institucione të tilla shtetërore në Shqipëri. Në vitet e para të tranzicionit, kushtet e tmerrshme në të cilat kanë jetuar fëmijët në këto institucione u bënë të njohura për publikun dhe qeveria e re filloi t'i përmirësonte ato me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë, kriza e thellë ekonomike dhe trazirat politike, kanë penguar zhvillimin e një kuadri të ri strukturor dhe institucional për qendrat e banimit për fëmijët dhe zhvillimin e alternativave për kujdesin e kushteve të banimit.

Këto qendra janë të vendosura në qytete të mëdha përreth Shqipërisë dhe ato janë strukturuar në përputhje me moshën e fëmijëve. Fillimisht, një fëmijë i braktisur dërgohet në një nga pesë shtëpitë për fëmijë nga 0-3 vjeç. Vendosja bëhet sipas vendeve bosh aty, pa marrë parasysh largësinë nga familja, që kufizon aftësinë e prindërve apo të të afërmve të vizitojnë fëmijën. Kur fëmija arrin moshën 3 vjeç, ai dërgohet në një nga dy shtëpitë parashkollore për fëmijë nga 3-6 vjeç. Në moshën shkollore, fëmija kalon përsëri në një nga tri shtëpitë e fëmijës për moshat 7-14 (ose në disa raste 16 vjeç).

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN: Shqipëria ka vështirësi të njohura në respektimin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe mbajtjen e standarteve për minorenët në burgje dhe qendra paraburgimi. Nuk ka një sistem të përgjithshëm të drejtësisë për të rinjtë në Shqipëri dhe as të dhëna të përgjithshme mbi kriminalitetin e të rinjve në Shqipëri. Nuk janë mjetet e duhura të trajtimit të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare në konflikt me ligjin dhe përqindja e dhunës dhe vrasjeve nga të rinjtë është e lartë.

FËMIJËT E RRUGËS DHE ATA QË PUNOJNË: Puna e fëmijëve po bëhet duke shkelur konventat dhe ligjet kombëtare e ndërkombëtare dhe e dëmshme për fëmijën. Është e zakonshme në shumë shoqëri, për fëmijët, që të kryejnë punë të formave të ndryshme. Puna konsiderohet Punë e Fëmijëve kur i heq fëmijës mundësinë e arsimit, kur fëmija skllavërohet nëpërmjet forcës, borxheve apo trafikut, kur fëmija ndahet nga familja dhe kur puna është e rrezikshme, nga ana sociale, morale, mendore apo fizike. Kjo mund të paguhet ose jo.

Këtu nuk përfshihen veprimtaritë e konsideruara përfituese për fëmijët nga pikëpamja e mësimit të praktikave dhe aftësive të mbijetesës, ndihma në punët e shtëpisë, të fituarit e parave të xhepit dhe kontributi në familje si dhe ndërtimi i besimit, vetëm nëse këto janë afat-shkurtër.[73]

% e Fëmijëve Shqiptarë nga mosha 5-14 vjeçare që punonin në vitin 2000[74]

	Puna e paguar	Puna e papaguar	Punë shtepie		Punë në familje (fermë ose biznes)	Që punojnë aktualisht
			<4 orë /ditë	4 ose më shumë orë /ditë		
Totali	0.9	2.6	55.1	1.0	29.5	31.7
Sipas Gjinisë						
Meshkuj	1.0	2.9	48.0	0.4	33.5	35.6
Femra	0.8	2.2	62.4	1.5	25.4	27.7
Sipas Moshës						
5-9 Vjeç	0.6	1.6	33.5	0.1	15.2	16.3
10-14 vjeç	1.2	3.4	73.4	1.7	41.6	44.7
Sipas Vendit						
Urbane	0.5	2.9	49.1	0.6	3.3	6.7
Rurale	1.1	2.4	58.2	1.2	43.2	44.8

Numri i fëmijëve që punojnë në Shqipëri ka qenë vazhdimisht në rritje, gjatë viteve të fundit. Sipas MICS të vitit 2000 të kryer nga INSTAT, 32% e fëmijëve nga grup-mosha 6 – 18 punojnë në disa forma, por nuk ka akoma të dhëna të vlefshme lidhur me këtë, deri në mesin e vitit 2002.[75] Shumë fëmijë punojnë në sektorin informal. Tregtia e vogël është puna më e zakonshme, ku punojnë fëmijët e rrugës. Numri i fëmijëve që jetojnë apo punojnë në rrugë në

[72] Komunikim Direkt me UNICEF, 2002.
[73] "Veprime Kundër Punës së Femijëve", Nelien Haspels dhe Michele Jankanish, ILO, Gjenevë.
[74] MICS, Instat, 2000. Një vrojtim i Qershor/Korrik 2000 i 1.452 fëmijëve pjestarë të familjeve.
[75] ILO po drejton një vrojtim kombëtar të fëmijëve që punojnë në vitin 2002.

qytetet kryesore është në rritje. Më tepër shesin gjëra, lajnë makinat, apo pastrojnë këpucët. Përafërsisht një e treta e këtyre fëmijëve është vlerësuar se janë të punësuar në rrugë ose në aktivitetet e tregut.[76] Puna e fëmijëve gjithashtu përdoret në sektorin e ndërtimit dhe atë bujqësor.

Përveç kësaj, fëmijët janë të përfshirë në një sërë veprimtarish të paligjshme, të cilat përmenden në Konventën e re të ILO-s 182 mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve. Në Shqipëri gjenden këto forma më të rënda të punës së fëmijëve: puna në gjendje të detyruar (shfrytëzim i detyruar i fëmijëve nga grupe të organizuara kriminale për lëmoshë, prostitucion dhe vjedhje); prostitucion dhe shitje droge. Përgjithësisht, vëzhguesit raportojnë se këto forma të punës së fëmijëve, veçanërisht prostitucioni i fëmijëve, jo vetëm që janë të zakonshme, por edhe po rriten.

4.3.2 ANALIZË

FËMIJËT E PAAFTË: Njerëzit e paaftë mbahen kryesisht të fshehur nga publiku, shpesh për shkak të mungesës së informacionit dhe njohurive mbi paaftësinë. Akoma ekziston një besim dhe turp se njerëzit e paaftë janë barrë për familjet dhe shoqërinë, të padobishëm dhe jo të aftë për të marrë pjesë dhe kontribuar në shoqëri. Në përgjithësi, njerëzit nuk janë të përgatitur akoma të pranojnë të paaftët si pjestarë të njëjtë të shoqërisë dhe shumë njerëz me aftësi të kufizuara nuk kanë besim në aftësitë e tyre. Infrastruktura shumë e varfër fizike e Shqipërisë e bën integrimin e këtyre njerëzve në komunitet edhe më të vështirë. Ekziston një grup ligjesh mbi disa probleme të paaftësisë-siç është e drejta e arsimit, e pranimit dhe punësimit, por nuk është zbatuar kurrë ashtu siç duhet.

FËMIJËT E VENDOSUR NË INSTITUCIONE: Arsyet kryesore për dërgimin e fëmijëve në institucione është varfëria. Shumë familje të varfra apo prindër nuk shohin alternativa të tjera përveç dërgimit të fëmijëve në institucione të tilla. Divorci, sëmundjet, apo vdekja e njërit apo të dy prindërve janë gjithashtu arsye të shpeshta. Disa gra të reja të pamartuara, të cilat bëhen nëna, nuk kanë guximin t'u tregojnë prindërve të tyre ose prindërit e tyre nuk e pranojnë fëmijën. Ka nxitës të fuqishëm për të vënë fëmijët e paaftë në këto institucione ose për t'i braktisur ata në maternitete, për shkak të turpit për një familje që të ketë një pjesëtar të paaftë dhe për shkak të mungesës së shërbimeve të komunitetit për të ndihmuar familjet me fëmijë të paaftë.

Ende nuk është hartuar një politikë kombëtare dhe një kuadër i ri institucional për të siguruar qëndrueshmërinë e iniciativave të bëra deri tani. Është e rëndësishme të konsolidohen dhe mbështeten përpjekjet e bëra tashmë dhe të vazhdohet krijimi i kushteve më të mira në shtëpitë e fëmijës dhe në periudhën e vështirë të integrimit në komunitetin lokal.

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN: Dobësitë në trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin ndodhin për shkak të faktorëve që përfshijnë përdorimin e një sistemi të njëjtë gjyqësor për të rriturit dhe për fëmijët, një mungesë të zyrtarëve të trajnuar për të trajtuar dhe mbështetur minorenët, përdorimi i burgjeve si metodë e vetme e ndëshkimit dhe një mungese të përgjithshme të iniciativave parandaluese dhe të ndërgjegjësimit, duke përfshirë shfrytëzimin e shërbimeve bazë sociale dhe qendrave të komunitetit.[77]

Në Shqipëri, një problem serioz është mbështetja e tepërt në heqjen e lirisë si përgjigje ndaj kriminelëve të rinj. Mungesa e lirisë është në vetvete një shkelje e Konventës mbi Të Drejtat e Njeriut, kur përdoret vetëm si alternativë e fundit dhe kur nuk është me kohëzgjatje sa më të shkurtër. Ajo priret të çojë drejt shkeljes së një morie të drejtash të tjera, duke përfshirë të drejtën e mbrojtjes nga torturat dhe keqtrajtimet, ndarjen nga të rriturit, kontaktet me familjen dhe mundësinë për arsimim dhe shërbim shëndetësor. Heqja e lirisë është mbyllja në çdo lloj institucioni - penal, edukativ apo mbrojtës - nga i cili fëmija nuk mund të largohet me dëshirë. Duhen zhvilluar alternativa ndaj heqjes së lirisë.

FËMIJËT E RRUGËS DHE FËMIJËT QË PUNOJNË: Puna e fëmijëve është rishfaqur me fillimin e periudhës së tranzicionit në Shqipëri dhe ka fituar përmasa të reja dhe të papritura, si një problem i një shkalle të gjerë social-ekonomike. Transformimi i strukturave ekonomike solli një segment të gjerë të ekonomisë së zezë, ku puna e fëmijëve shfrytëzohet gjerësisht. Numri i fëmijëve që punojnë në kushtet e lindjes së "tregut të lirë" filloi të rritet me shpejtësi. Çrregullimet e

[76] Megjithëse, Konventa e ILO-s 182 mbi format më të rënda të punës së fëmijëve, nuk e përcakton punën në rrugë si një nga format më të këqija të punës së fëmijëve, ka një mendim të mbështetur për ta ruajtur punën në rrugë si një nga format më të këqija, sepse fëmijët që punojnë në rrugë priren për t'u përfshirë në aktivitete abuzive dhe sepse prostitucioni, droga dhe trafiku i fëmijëve janë aktivitetet kryesore të rrugës.

[77] Drejt një Sistemi të Përgjithshëm të Drejtësisë Për Adoleshentët për Shqipërinë, UNICEF, Mars 2000. http://www.unicef.org/albania/publications/juv_justice_albania.pdf

përgjithshme sociale i bënë fëmijët të pambrojtur, veçanërisht lidhur me punëdhënësin. Fëmijët u bënë një objekt i manipulimit dhe shfrytëzimit në kushtet e mungesës praktike të kontrollit administrativ e ligjor si dhe të ligjeve.

Puna e fëmijëve është një problem për fëmijët që janë të përfshirë në të, pasi i ekspozon ata ndaj lëndimeve fizike dhe psikologjike, kriminalitetit dhe dhunës; u heq shkollimin e vëmendjen dhe i vë ata para rrezikut të varësisë nga droga, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe shtatëzanive të padëshiruara. Puna e fëmijëve është një problem për shoqërinë, sepse çon në zhvlerësimin e kapitalit njerëzor, i cili nga ana e vet e bën varfërinë të përhershme. Këto probleme shfaqen në një rreth vicioz, kur fëmijët e familjeve të varfra nuk ndjekin shkollën dhe kështu kanë mundësi të kufizuara për të ecur përpara në shoqëri dhe për t'u larguar nga varfëria. Kuptimi i këtij modeli është baza e pranimit në shkallë ndërkombëtare se, reduktimi i punës së femijëve, veçanërisht i formave më të rënda, është një strategji e zbutjes së varfërisë dhe jo vetëm një çështje e të drejtave të fëmijëve.

Fëmijët e përfshirë në format më të rënda të punës së fëmijëve priren të jenë fëmijët nga grupet social-ekonomike më të prekshme, sidomos të varfrit. Ekziston një lidhje e ngushtë mes punës së fëmijëve dhe varfërisë. Eshtë e zakonshme për fëmijët në varfëri ekstreme të ndihmojnë familjet e tyre për të mbijetuar duke fituar disa të ardhura dhe të mos ndjekin shkollën, pasi arsimi nuk mund t'i zgjidhë nevojat imediate. Nganjëherë, puna është zgjedhur para arsimit për shkak të problemeve në sistemin e arsimit, siç është cilësia e dobët, mungesat në zona të thella, klasat e mbingarkuara dhe kostot. Faktorët e tjerë përfshijnë legjislacionin e pamjaftueshëm mbrojtës apo detyrimin, qëndrimin pozitiv ndaj punës së fëmijëve, strukturën e familjes dhe migrimin e brendshëm.

Karakteri i paligjshëm dhe kriminal i punës së fëmijëve e bën atë një problem të vështirë për t'u trajtuar. Përveç miratimit të Konventave Ndërkombëtare, Qeveria nënshkroi një Memorandum të Mirëkuptimit në vitin 1999 me ILO-IPEC për luftimin e zënies në punë të fëmijëve. GPRS Qeveritare e vitit 2001 përfshin përpjekjet për përmirësimin e shpërndarjes së të ardhurave dhe rritjen e regjistrimit në shkolla të nivelit fillestar e të mesme dhe përqindjes së vazhdimit të shkollës. Gjithashtu, Qeveria ka një Strategji Kombëtare me një plan-veprim për të luftuar zënien në punë të fëmijëve, duke treguar se ai ka hyrë në programet e Qeverisë.

Megjithëse problemet e punës së fëmijëve dihen përgjithësisht, nga autoritetet në nivel kombëtar dhe rajonal, mungon një politikë mbi punën e fëmijëve dhe një qëndrim i përbashkët për zgjidhjen e këtyre problemeve. Njëkohësisht, bie në sy aftësia e ulët e qeverisë për të luftuar kundër punës së fëmijëve. Inspektorët e zyrave të punës nuk zotërojnë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme mbi çështjet e punës së fëmijëve. Është e qartë se ka një mungesë të koordinimit ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe ka aftësi të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur natyrës komplekse të problemit të punës së fëmijëve, si dhe ekziston një mungesë ndërgjegjësimi në nivel lokal dhe kombëtar. Së fundi, ka një nevojë të veçantë për ta integruar problemin e punës së fëmijeve në programet dhe politikat ndërkombëtare.

Eliminimi i menjëhershëm i punës së fëmijëve është i pamundur, por është i mundur përparimi i ndjeshëm afat-gjatë, kur ka një zotim politik dhe social të gjerë pas një plani të qartë veprimi, kur ka reforma kyçe politike dhe kur ka një ndryshim në qëndrimet e shoqërisë.

4.3.3 REKOMANDIME

KANUNI / GJAKMARRJA

- Trajnimi i mëtejshëm për tolerancën dhe zgjidhjen jo me dhunë të konflikteve duhet të organizohet me mësues, fëmijë dhe drejtues të komunitetit, në bashkësitë ku ekziston gjakmarrja.
- Fëmijëve, që janë ngujuar në shtëpi, duhet t'i ofrohen kushte speciale për mësim dhe për këshillim.

FËMIJËT E PAAFTË

- Duhet të njihen mekanizma bashkërendimi ndërmjet institucioneve shtetërore, në mënyrë që të trajtohen problemet e njerëzve të paaftë.
- Duhen hartuar politikat dhe duhen shpërndarë burimet për t'i ofruar shërbime komunitetit për zhvillimin dhe integrimin në shoqëri të fëmijëve të paaftë.

FËMIJËT E VENDOSUR NË INSTITUCIONE

- Duhet hartuar një reformë për politikën mbi problemin e fëmijëve në rrezik ose të privuar nga kujdesi i prindërve. Kjo reformë duhet të përfshijë skemat parandaluese për mbylljen në institucione dhe alternativa për kujdesin në shtëpitë e fëmijës.
- Nevojitet një reformë në shtëpitë e fëmijës. Kjo do të përfshijë trajnimin e punonjësve të shërbimit dhe sigurimin e shtëpive familjare për fëmijët.
- Duhen planifikuar shërbime speciale për fëmijët që largohen nga institucionet.

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

- Shqipëria ka nevojë të krijojë forma alternative të ndëshkimit për minorenët, dhe jo të vazhdojë të mbështetet ekskluzivisht tek burgosja e tyre.

- Duhen përmirësuar procedurat për trajtimin e minorenëve në konflikt me ligjin.
- Duhen rishikuar Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal dhe rregullat e ligjet lidhur me burgjet dhe qendrat e arrestit, për të pasqyruar standardet e njohura në nivel ndërkombëtar.
- Duhen krijuar gjykata të veçanta për minorenët.
- Minorenët duhet të kenë mundësinë të arsimohen edhe kur dënohen.
- Duhet krijuar dhe trajnuar një rrjet profesionistësh (gjykatës, prokurorë, juristë, policë burgjesh, policë gjyqësorë, policë në Komisariate) të specializuar në drejtësinë për të rinjtë.
- Duhet vendosur një sistem i përgjithshëm regjistrimi dhe i mbledhjes së të dhënave për adoleshentët në konflikt me ligjin. Ky sistem informacioni duhet të përdoret nga profesionistë të sistemit dhe publiku i përgjithshëm dhe duhet të përmbajë informacionin bazë për të vlerësuar dhe ripërcaktuar politikat shtetërore lidhur me këto probleme.
- Masa parandaluese: Duhen ndërmarrë përpjekje për të zvogëluar dhunën mes adoleshentëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemet e drejtësisë së adoleshentëve.

FËMIJËT E RRUGËS

- Shkollat dhe mësuesit kanë një rol kyç për të luajtur në parandalimin e këtij fenomeni dhe në ri-integrimin e fëmijëve të rrugës në sistemin shkollor.
- Iniciativat e Shoqërisë Civile, që theksojnë rolin e familjes dhe mbështetjes familjare, tregojnë gjithashtu se janë premtuese në trajtimin e problemit të femijëve të rrugës. Me përfitim do të ishte edhe bashkëpunimi më i madh ndërmjet OJQ-ve dhe palëve ministrore.

FËMIJËT QË PUNOJNË

Nevojitet një strategji shumë-sektoriale, që përfshin hapat e mëposhtëm:

- Baza e njohurive: Mbledhja e të dhënave dhe analiza
- Përpunimi i Politikave
- Krijimi i aftësive – Fuqizimi i aftësive lokale dhe kombëtare
- Rritja e përkrahjes, ndërgjegjësimit dhe mobilizimi
- Reformat Legjislative – Ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare
- Sistemet e zbatimit – Mbikqyrëse dhe fuqizimi i inspektimit të punës
- Parandalimi i punës së fëmijëve
- Largimi i fëmijëve nga puna
- Rehabilitimi i ish-fëmijëve në punë
- Sigurimi i alternativave për fëmijët dhe prindërit e tyre
- Integrimi i problemeve të punës së fëmijëve në politikat social-ekonomike, programet dhe buxhetet.

5 Siguria Sociale

Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin

- **Ulja e vdekshmërisë foshnjore**
  - Ulja me 2/3 e vdekshmërisë nën moshën 5 vjeç në periudhën 1990-2015
- **Përmirësimi i shëndetit të nënës**
  - Ulja me 3/4 e vdekshmërisë amtare në periudhën 1990-2015
- **Luftimi HIV/AIDS, malaries dhe i sëmundjeve të tjera**
  - Të ndalet deri në vitin 2015 dhe të nisë rënien përhapja e HIV/AIDS
  - Të ndalet deri në vitin 2015 dhe të nisë rënien përhapja e sëmundjeve të tjera infektive si tuberkulozi
- **Arsimi fillor për të gjithë**
  - Të sigurohet që deri në vitin 2015, të gjithë fëmijët kudo, djemtë dhe vajzat, të mbarojnë shkollën fillore

5.1 Sistemi i Shërbimit Shëndetësor

5.1.1 VLERËSIM

Raporti Botëror mbi Shëndetin i vitit 2000 e radhiti "Efektivitetin e Përgjithshëm të Sistemit Shëndetësor" të Shqipërisë në vendin e 55-të ndërmjet 141 vendeve, në bazë të një sërë treguesish administrativë që nga viti 1997 dhe në vendin e 64-t sipas treguesve të shëndetit[78]. Shpenzimet totale të Qeverisë për Shërbimin shëndetësor si një përqindje e PBB u rritën në vitin 2002. Problemet kryesore lidhur me shërbimin shëndetësor në Shqipëri mund të kategorizohen në: (a) cilësi e dobët e shërbimit shëndetësor dhe mundësi e pabarabartë për shërbim shëndetësor, dhe (b) prirjet shqetësuese në shëndetin publik.

CILËSIA DHE MUNDËSIA: Cilësia e shërbimit shëndetësor parësor ka rënë në dhjetëvjeçarin e fundit në zonat urbane, fshatrat apo zonat e thella. 51 spitalet e Shqipërisë kanë 10,237 shtretër[79] dhe një sasi domethënëse, por jo saktësisht e njohur, (ndoshta gjysma) e klinikave shëndetësore dhe spitaleve janë jashtë funksionit ose të papërshtatshme për nevojat e popullsisë lokale, nga pikëpamja e pajisjeve moderne, personelit të mjaftueshëm të trajnuar dhe medikamenteve të duhura. Përveç këtyre, ndërtesave shpesh u mungojnë ngrohja, energjia elektrike dhe uji.

Kujdesi parësor shëndetësor dhe shërbimet spitalore janë dy nivelet e kujdesit shëndetësor për Shqipërinë, në të cilat përfshihen 520 qendra shëndetësore, 41 spitale në rrethe, 12 spitale rajonale dhe Qendra Spitalore Universitare në Tiranë.[80] Nganjëherë mungesa e higjienës dhe e mirëmbajtjes është një problem real. Për ta ilustruar, nga kolera e vitit 1996 ndodhën shumë vdekje në pacientët e institucionit të sëmundjeve mendore në Elbasan, për shkak të mungesës së higjienës. Njerëzit me të meta mendore, një fatkeqësi e madhe në shoqërinë shqiptare, shpesh janë të mbyllur përjetësisht në këto institucione, në kushte të këqija.

Shqipëria ka një total prej rreth 16.000 mamish e infermieresh dhe norma e Shqipërisë, 1,3 mjekë për 1000 banorë, është më e ulët se gjysma e normës së Bashkimit Evropian e 3 mjekëve për 1000 banorë.[81]

Shkalla e vrojtuar e imunizimit në vitin 2000 te moshat më të vogla se 12 muaj kundrejt moshave 18-30 muaj është si më poshtë, sipas deklaratave të nënave: 88.8% për fruthin; 83.3% për BCG (Bacille Calmette-Guerin –vaksinë kundër turbekulozit); 97.6% dhe 53.4% për DPT (Difteria, kolla e mirë dhe vaksinë tetanozi) dozat respektivisht 1 me 3; 99.2% dhe 53.6% për OPV (Vaksinë gojore poliovirusi`) dozat respektivisht

[78] WHO, http://www.who.int/whr/2001/archives/2000/en/pdf/Annex 1-en.pdf
[79] Vjetari i Treguesve Sociale, Instat, 2001.
[80] Programi i Investimeve Publike (PIP) 2000-2003, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë
[81] Gratë e Botës: Ligje dhe Politika që Ndikojnë në Jetën e tyre Riprodhuese: Evropa Qendrore-Lindore, Shoqata e Shqipërisë për Planifikimin Familjar, 2000. www.crlp.org/pub-bo-wowece.html

1 dhe 3; dhe 90.1% për dozën e parë të HBV (Vaksina e Hepatitit B)[82] Përqindje më të larta janë sipas regjistrit kombëtar mbi imunizimin. Shih Pasqyrën 24 Sëmundjet, Imunizimi, Personeli Mjekësor, Kujdesi për Shëndetin dhe Infrastruktura.

SHËNDETI PUBLIK: Statistikat mbi shëndetin duhet të trajtohen me kujdes, përderisa mund të ketë prirje për t'i shtrembëruar të dhënat, që ta bëjnë situatën të duket më e mirë ose më e keqe nga ajo ekzistuese, në mënyrë që të tërheqin sa më shumë fonde. Mund të ketë edhe anësi të njoftimeve, përderisa të dhënat nuk janë të mbledhura komplet nga burime private dhe publike, kështu që numri i rasteve të raportuara mund të jetë më i ulët se numri real dhe një përmirësim në raportim mund të dalë si epidemi.

Vdekshmëria foshnjore dhe amtare mbetet mjaft e lartë sipas standardeve Evropiane, por të dyja tregojnë një rënie në vitet 1985-1998; vdekshmëria foshnjore ishte 28 vdekje për 1000 lindje më 2000, më keq se në vende të tjera të rajonit dhe përqindja e vdekshmërisë amtare në vitin 1998 ishte 21.6 për 1000 lindje të gjalla. Vdekshmëria foshnjore në disa krahina të veriut është pothuajse dy herë më e madhe sesa përqindja kombëtare. Shqipëria nuk e ka të ndarë vdekshmërinë e fëmijëve sipas gjinive dhe madje, edhe pse Shqipëria miratoi standartet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) për statistikat e vdekshmërisë foshnjore, shifrat zyrtare ndoshta i ulin të dhënat reale, përderisa disa vdekje në 6 ditët e para pas lindjes janë dokumentuar si lindje të vdekura dhe shumë vdekje që kanë ndodhur nëpër banesat e zonave rurale, nuk janë raportuar fare. Në vitin 2000, nën moshën 5 vjeç kishte 33 vdekje për 1000 lindje të gjalla[83], duke e vendosur kështu Shqipërinë në vendin e 92-të në vendet me përqindje më të lartë në botë.[84] Shih Pasqyrën 23 Jetëgjatësia dhe Përqindja e Vdekshmërisë. Vdekshmëria amtare është e lartë sidomos në zonat e Tropojës, Hasit dhe Kukësit. Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, jetëgjatësia e pritshme në vitin 1999 ishte 76.4 për femra dhe 71.7 për meshkuj.[85] WHO raportoi jetëgjatësinë e pritshme 64.3 për meshkuj dhe 72.9 për femra në vitin 2000 dhe "Jetëgjatësia e pritshme me shëndet të plotë" mesatare e parashikuar 59.4[86] vjet. Përqindjet e vdekshmërisë ranë gjatë viteve 1989 dhe 1996, për të dyja gjinitë, për grupmoshat 5-14 dhe 15-24 vjeç, përveç se për meshkujt e moshave 15-24, ku ajo u ngrit nga 98.9 në 135.1 vdekje për 100,000[87] banorë, por aktualisht është në rënie. Për meshkujt e moshave nga 5-14 vjeç përqindja e vdekshmërisë është 59.3 dhe për femrat e moshave nga 5-14 vjeç dhe 15-24 vjeç është respektivisht 33.7 dhe 43.0.[88]

Konferenca Botërore për Fëmijët deklaroi që fëmijët duhet të ushqehen ekskluzivisht me gji gjatë 4-6 muajve të parë, sepse gjiri përmirëson ushqimin dhe sistemin imunitar, por afërsisht vetëm 9% e fëmijëve të moshës 0-3 muajsh në Shqipëri ushqehen vetëm me gji, duke iu referuar një vrojtimi të bërë me 80 fëmijë të kësaj grup moshe.[89] Meqenëse nuk ka statistika të besueshme kombëtare mbi ushqimin e fëmijëve, mendohet që të paktën 60% e fëmijëve nga mosha 0-3 muajsh ushqehen me gji dhe se nënat e arsimuara i ushqejnë më mirë fëmijët e tyre. Nënat që ushqejnë me gji fëmijët e tyre shpesh përdorin edhe metoda të tjera për t'i ushqyer. Shumë nëna vazhdojnë të kenë mendime të gabuara mbi metodat ideale për ushqimin e fëmijëve gjatë foshnjërisë. Në vitin 2000, 14.3% e fëmijëve nën 5 vjeç ishin nën peshë (shumë të dobët) për moshën e tyre dhe 4,3% ishin seriozisht nën peshë. 31.7% nën moshën 5 vjeç ishin nën gjatësinë e duhur (shumë të shkurtër) për moshën e tyre, dhe 17.3% ishin seriozisht shumë të shkurtër.[90] Fëmijët e nënave me arsim të ulët ka më shumë gjasa të jenë nën peshë ose nën gjatësinë e duhur. Shumë fëmijë shfaqin shenja të pamjaftueshmërisë së jodit, një pjesë prej tyre si pasojë e konsumit të kripës së pa-jodizuar, kështu që u hartua Plan-Veprimi Kombëtar për Çrregullimin nga Mungesa e Jodit. Mungesa e proteinave dhe mikroelementeve si pasojë e ushqimit të keq janë shqetësime shumë serioze.

Abortet janë shumë të zakonshme në ditët e sotme; zyrtarisht INSTAT ka njoftuar 390 aborte për çdo 1000 lindje në vitin 1999.[91] Numri i aborteve për 100 lindje të gjalla arriti kulmin në 49.4 në vitin

[82] Vrojtim Kombëtar i Mbulimit të EPI, ISHP, 2000.
[83] Po aty; dhe Raporti i Mbikqyrjes rajonale, n.7; dhe Raporti Mbikqyrjes Rajonale n.8: Një dhjetëvjeçar tranzicioni, UNICEF, 2001. http://www.unicef-icdc.org/presscentre/presskit/monee8/eng/
[84] Gjendja e Fëmijëve të Botës 2002, UNICEF. http://www.unicef.org/sowc02/
[85] Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri, Dhjetor 2001, Instat.
[86] Raporti Botëror mbi Shëndetin 2001, WHO
. http://www.who.int/whr/
[87] Instat, Shqipëria në shifra, 1998
[88] Raporti i Mbikqyrjes Rajonale, n.8, 2001, UNICEF.
[89] MICS Instat, 2000
http://www.unicef.org/albania/publications/mics2000.pdf
[90] Po aty
[91] Vjetari i Treguesve Socialë, Instat, 2001.

1993, dhe ra në 31.5 në vitin 1998. Këto shifra e ulin shumë numrin real të abortëve, pasi jo të gjitha abortet raportohen në Ministrinë e Shëndetësisë, në veçanti, ato të kryera në klinikat private. Vetëm 17% e të intervistuarve në Vrojtimin e KAPB në vitin 2000 raportuan se përdorin kontraceptivët. Shih Pasqyrën 22 Të Dhëna mbi Popullsinë – Lindjet, Vdekjet dhe Abortet.

Pasojat e mundshme të Marrëdhënieve Seksuale të Pambrojtura

- Shtatzania e padëshiruar
  - Fëmijë të padëshiruar
    - Zhvillim i pakët
    - Vdekje
  - Abort i provokuar
    - Abort në kushte të këqija
      - Vdekje e nënës
      - Komplikacione
      - Probleme psiko-sociale
    - Abort i sigurt
      - Probleme Psiko-Sociale
- Sëmundje Seksualisht te transmetueshme
  - Sëmundshmëri e lidhur me SIDA-n
    - Vdekje
  - Kancer i qafës së mitrës
    - Vdekje
  - Sëmundje inflamatore të pelvisit
    - Pamundësi e mbetjes shtatzanë
    - Shtatëzania jashtë mitre, etj.
  - Të tjera, përfshirë Sifilis, etj.

Burimi: Rinia & Shëndeti Riprodhues në vendet në tranzicion, 1997, UNFPA.

Frekuencat e sëmundjeve ngjitëse si hepatiti viral dhe diarrea janë me të vërtetë të larta dhe ka një rritje të sëmundjeve kronike dhe jo ngjitëse. Sëmundjet diarreike kryesisht përhapen në verë,[92] kurse infeksionet e frymarrjes në dimër. Disa sëmundje, si HIV/AIDS (shih më poshtë) dhe epidemia e kolerës 1996, kryesisht futen në vend nga njerëzit që vijnë nga jashtë. Nuk ka patur vdekje nga malaria në Shqipëri rreth 25 vitet e fundit, por malaria mund të kthehet në Shqipëri, qëkur kanë filluar të përhapen mushkonjat, që mund të kenë prekur një njeri të infektuar në një shtet tjetër. Përqindja zyrtare e 21.5 infeksioneve të reja me tuberkuloz për 100.000 persona në vit tregojnë se nuk janë njoftuar, e po ashtu ndodh me shifrat zyrtare të 1999 për 30 raste të reja me Sifilis dhe 11 raste për Gonorenë.[93]

Frekuenca e HIV/AIDS nuk është akoma e lartë, por ekspertët e shëndetësisë janë të shqetësuar

Sjellja e të rinjve nga mosha 10-24 vjeç të rrezikuar nga HIV/AIDS dhe përdorimi i drogës

Grupet në rrezik në qytete të ndryshme u vrojtuan nga Tetori 2001 - Janar 2002

100 njerëz që lëvizin shumë në Korçë

- 90% janë seksualisht aktivë
- 40% kryejnë marrëdhënie seksuale me prostituta
- 82% nuk i përdorin kurrë prezervativët
- 18% kryejnë marrëdhënie seksuale për para ose drogë
- 27% kryejnë marrëdhenie seksuale nën ndikimin e drogës
- 56% kanë përdorur drogën (duke përfshirë alkoolin) muajin e kaluar
- 7% janë përdorues të drogave intravenoze (IDU)

170 Përdorues të drogës në Tiranë dhe Shkodër

- 50% në Shkodër kishin 6-10 partnerë seksualë në vitet e kaluara
- 86% nuk i përdorin gjithnjë prezervativët
- 69% bëjnë seks nën ndikimin e drogës
- 32% kanë përdorur heroinë muajin e kaluar
- 27% në Shkodër dhe 65% në Tiranë janë përdorues të drogave intravenoze
- 74% të IDU-ve përdorin shiringa të përdorura
- 25% në Shkodër nuk kanë informacion mbi HIV/AIDS/STI

50 Prostituta në Vlorë

- 80% pësojnë abuzime nga klientët ose tutorët
- 50% kanë patur 100+ partnerë në muaj
- 90% nuk përdorin gjithnjë prezervativët
- 80% kanë patur STI vitin e kaluar

Për më shume hollësi shih: RAR, UNICEF, 2002. http://www.unicef.org/albania/rar.htm

rreth mundësisë së një rritjeje shumë të shpejtë të numrit të rasteve, të deklaruar 72 raste të HIV/AIDS, në Nëntor 2001[94]. Programi Kombëtar i SIDA-s (NAP) i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka vlerësuar se numri aktual i rasteve mund të jetë 50 herë më i lartë se numri zyrtar.[95] Megjithëse NAP nuk është shumë aktiv, Qeveria ka bërë të mundur furnizimin me gjak të kontrolluar; të gjitha dhurimet e gjakut janë analizuar për HIV që në vitin 1993 dhe gjithashtu edhe për Hepatitin B e C dhe Sifilizin. Zotimet për të mbajtur sistemin e mbikqyrjes[96] të ngritur në vitin 1998 për të gjurmuar përhapjen e AIDS dhe

[92] Epidemia e kolerës në 1996 u soll nga Turqia. Kolera nuk është endemike në Shqipëri
[93] Strategjitë Kombëtare mbi Sistemin e Shëndetit Raport: 2000-2010, MSH dhe WHO, Maj 2000.
[94] Komunikim direkt me Institutin e Shëndetit Publik, 2002.
[95] Rekomandimi i Programit për Vendin: Shqipëri, UNICEF, 2000.
[96] Mbikqyr përdoruesit e drogës, punonjësit e seksit dhe dhuruesit e gjakut.

sëmundjeve të tjera infektive duke mbikqyrur grupe specifike, janë të pasigurta, por ISHP ka marrë asistencë në këtë fushë nga Kombet e Bashkuara.

DROGA: Përdorimi i drogës po përhapet shpejt, jashtë përmasave dhe mundësive të aftësisë së tanishme të Shqipërisë për të trajtuar problemin. Zyrtarisht MRP e vlerëson numrin e përdoruesve të drogës 30,000, ndërsa vlerësimet e disa OJQ-ve janë sa gjysma e shifrës së mësipërme, ndoshta për shkak të ndryshimit të përcaktimit të termit "përdorues i drogës[97]". Duket se një e treta e përdoruesve të drogës gjenden në Tiranë. Asnjë sondazh kombëtar mbi përdorimin e drogës nuk është ndërmarrë; pak sondazhe lokale janë përqendruar në dy zona urbane dhe nuk është bërë asnjë anketim në zonat rurale dhe të thella, megjithëse përdorimi i drogës nuk është vetëm një fenomen i zonave urbane. Shih Pasqyrën 19 Të Dhëna mbi Përdoruesit e Drogave dhe Trajtimet.

Në Shqipëri ka vetëm një Klinikë Toksikologjike , e vendosur në Tiranë në Qendrën Spitalore Universitare. Kjo është e pamjaftueshme për përmasat e problemit të drogës në Shqipëri dhe Klinika Psikiatrike, në këtë Qendër spitalore nuk funksionon për këtë problem. 400 persona kërkuan ndihmën e Klinikës Toksikologjike në gjysmën e parë të vitit 2001 dhe 95% e tyre ishin meshkuj[98]. Këta janë njerëz që e ndiejnë se gjendja e rënduar i ka detyruar t'i drejtohen klinikës; shumë të tjerë zgjedhin të fshihen nga frika e pasojave negative sociale dhe turpit. Kjo klinikë nuk është e specializuar posaçërisht për problemet e drogës; sektori i drogës ka dy shtretër dhe megjithëse doktori ka fituar përvojë të konsiderueshme, ai nuk ka patur kualifikim zyrtar për drogën. Klinika praktikon trajtimet me metadon, i cili është një zëvëndësues i drogës, që ndihmon në heqjen e zakonit të përdorimit të heroinës. Nuk ekziston asnjë qendër rehabilitimi apo klinikë trajtuese.

5.1.2 ANALIZË

CILËSIA DHE MUNDËSIA: Një sfidë e madhe do të ishte përmirësimi i strukturës së shkatërruar të kujdesit shëndetësor të goditur nga migrimi ekonomik, i cili ka privuar shumë njerëz nga mundësia e kujdesit shëndetësor. Një problem i përbashkët është centralizimi i Ministrisë së Shëndetësisë, që merret me problemet operacionale dhe nuk i njeh dhe nuk u përgjigjet nevojave të komunitetit lokal. Krijimi i një Drejtorie për Politikat e Shëndetit dhe Planifikimin brenda Ministrisë është një hap i madh drejt përfshirjes në përcaktimin e politikave për shëndetësinë, megjithëse akoma nuk është parë ndonjë decentralizim i dukshëm. Është përgatitur një projekt strategji, për dhjetë vitet e ardhshme me ndihmën e WHO, megjithëse është shtyrë shumë miratimi i tij nga parlamenti.

Sistemi i shërbimit shëndetësor ka nevojë të mënjanojë mbivendosjen e përgjegjësive dhe mund të përfitojë nga sisteme më të mira informacioni për menaxhimin e shërbimit shëndetësor. Në veçanti, sistemit të shërbimit shëndetësor i mungon aftësia e duhur për administrimin financiar, për t'u marrë me financimin apo zbatimin e kontratave me individët. Shumë spitale apo institucione të tjera i marrin fondet në bazë të kritereve tejet të vjetruara. Nuk ka asnjë përcaktim standard se çfarë shërbimesh dhe ilaçesh duhet të ketë në çdo spital dhe vetë spitalet nuk janë të shpërndarë gjeografikisht në përputhje me nevojat e popullsisë në secilën zonë. Nuk ka burime të mjaftueshme për të mbajtur spitalet ekzistuese, as infrastrukturë të mjaftueshme për të siguruar energjinë elektrike, ujin e pijshëm dhe asnjë sistem për trajtimin e mbeturinave mjekësore. Nuk ekziston asnjë qendër shërbimi shëndetësor që të merret me nevojat e shëndetit riprodhues të adoleshentëve. Ndërsa vazhdon të ketë mungesë të aftësisë për të zbatuar legjislacionin ekzistues, ka gjithashtu nevojë për një legjislacion të ri më të fortë për problemet e shëndetit. Në një konferencë ndërkombëtare u analizua legjislacioni për shëndetin në Shqipëri dhe doli se të gjashta Drejtoritë e Ministrisë së Shëndetësisë kanë nevojë për rishikim të legjislacionit të tyre sektorial. Në veçanti, Drejtoria Farmaceutike dhe Spitalore ka nevojë për shqyrtimin urgjent të legjislacionit të sektorëve të tyre për rregullimin dhe krijimin e një kuadri ligjor për privatizimin dhjetëvjeçar të farmacive dhe për klinikat e spitalet private që do të ngrihen shumë shpejt. Duke u mbështetur në asistencën teknike të Kombeve të Bashkuara, si dhe në praktikat e rajonit është hartuar ligj për shërbimin spitalor dhe privatizimin. Gjithashtu, ka pasur përparime edhe në analizimin e legjislacionit farmaceutik.

Personelit i mungojnë nxitësit e duhur dhe motivimi për të ngritur nivelin e tij të përkushtimit dhe të produktivitetit. Niveli i ulët i pagave (megjithëse pritet të rriten shpejt) e bën të vështirë konkurrimin e sistemit te shërbimit shëndetësor me organizatat e huaja apo private, nga pikëpamja e kompensimeve financiare, kushteve të punës dhe mbajtjes së personelit. "Migrimi i trurit" nga zonat rurale në ato urbane dhe nga Shqipëria jashtë shtetit është një shqetësim i madh. Pjesa e personelit, që është e aftë në fusha të ndryshme, nuk është e

[97] Komunikim Direkt me UNDCP, 2001.
[98] po aty

balancuar drejt për të kënaqur nevojat aktuale të shqiptarëve, për shkak të mungesës së programeve moderne të trajnimit dhe mungesës së mundësive të personelit ekzistues që të fitojë aftësi të reja.[99]

Për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe problemeve të tjera, vaksinat nuk mbahen gjithmonë në temperaturat e duhura. Objektivi i një marrëveshjeje midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe UNICEF është që Qeveria të financojë 100% të vaksinës së parë dhe vaksinimin për fëmijët nën moshën 2 vjeç, para vitit 2005. Qeveria ka një Plan Kombëtar për Imunizimin për periudhën 2001-2005.

Mbizotërimi i pagesave si ryshfet ndikon në mundësinë për të siguruar shërbimin shëndetësor dhe cilësinë e tij. Shërbimi shëndetësor preket gjithashtu edhe nga perceptimet e më shumë se 80% të njerëzve, se marrja dhe dhënia e gjakut janë të rrezikshme.[100]

SHËNDETI PUBLIK: Infrastruktura rrezikon zbatimin dhe veprimtarinë e shëndetit publik nëpërmjet rrugëve të rrezikshme, furnizimit me ujë të pasigurt, mungesës së energjisë elektrike për ngrohje e diagnostikime dhe mungesës së metodave të sigurta për trajtimin e mbeturinave

Çështjet kyçe të Shëndetit Riprodhues dhe Seksual

- Nevoja për programe dhe politika të qarta
- Sistem i papërshtatshëm i mbështetjes sociale
- Burime njerëzore që nevojiten për të rritur njohuritë dhe aftësitë, duke përfshirë ato financiare
- Përmirësimi i mundësive për informacion dhe shërbime më të mira dhe të përshtatshme.
- Marrëdhënie të pambrojtura seksuale dhe pasojat e tyre
- Abuzimi seksual, shfrytëzimi, stereotipat dhe dhuna kundër grave të reja.

Burimi: Rinia dhe Riprodhimi, UNFPA

dhe ujërave të zeza. Tendencat shqetësuese në mënyrën e jetesës përfshijnë norma më liberale seksuale, trafikimin e grave dhe fëmijëve për prostitucion, drejtimin e makinës nën efektin e alkoolit, përmasa të larta të konsumit të cigareve dhe rritja e përdorimit të paligjshëm të drogës. Këto kërcënime duhet të trajtohen përmes përmirësimit të shërbimeve bazë të infrastrukturës, zbatimit të kontrollit të cilësisë dhe mbrojtjes së grupeve të prekshme, si dhe edukimit, për të nxitur zgjedhjet e mënyrave të jetesës së shëndetshme.

Dita e SIDA-s dhe Dita Kundër Duhanit janë mundësi të mira për të bërë fushata këshillimore.

Edukimi shëndetësor aktual është i pamjaftueshëm. Së pari, prindërit nuk flasin për problemet e seksit dhe drogës me fëmijët e tyre dhe ata e vuajnë mungesën e informacionit. Së dyti, edukimi zyrtar për shëndetin në 8-vjeçare vuan nga mungesa pedagogjike e materiale dhe nganjëherë mësuesit ndihen në siklet për t'u mësuar fëmijëve përbërësit e edukimit e shëndetësor. Përbërësi i parë janë 17 orë në lëndën e biologjisë dhe i dyti janë 3 orë në lëndën e sociologjisë, rreth problemeve të duhanit, drogave dhe HIV/AIDS.

Shkaqet më të shpeshta të vdekshmërisë foshnjore janë sëmundjet e frymëmarrjes, anomalitë e lindura, diarreja dhe sëmundjet ngjitëse. Disa familje në zonat rurale mbajnë qëndrime patriarkale ndaj lindjes së fëmijës dhe duan që fëmija e parë të jetë djalë. Shkaqet më të shpeshta të vdekjes së të rriturve janë kanceri dhe sëmundjet kardiake. Shkaqet më të shpeshta të vdekjes amtare janë hemoragjia dhe eklampsia, sëmundjet ngjitëse, hipertensioni i shkaktuar nga shtatzania, por frekuenca e shkaqeve të tyre është e panjohur, përderisa vdekjet e nënave klasifikohen vetëm si vdekje gjatë lindjes e gjatë abortit.

Për vdekshmërinë e lartë amtare, shpesh, mund t'i vihet faji statusit të ulët të grave, cilësisë së dobët të shërbimeve bazë, kushteve jo higjienike gjatë shtatzanisë, mungesës së informacionit, dhe përqendrimit të shërbimeve në qytete. 90% e lindjeve u pritën nga personeli mjekësor në vitin 2000[101], por në qendrat shëndetësore në fshat kushtet janë shumë të këqija. Shumë nga shkaqet direkte të vdekshmërisë së nënave mund të parandalohen nga një kujdes i përshtatshëm dhe me kosto më të ulët në shërbimin para lindjes, në lindje dhe pas lindjes. Ashtu si në shumë fusha të tjera të sistemit shëndetësor, shërbimet mendohet se janë pa pagesë, por janë përmirësuar vetëm atëherë kur është paguar. Doktorët zakonisht gjenden në qytete por, shumica e lindjeve në fshat priten nga infermiere ose nga mami. Përqindja e lindjeve në shtëpi është rritur dukshëm gjatë periudhës së tranzicionit.

Aborti dhe planifikimi familjar ishin të paligjshëm në regjimin komunist, për shkak të politikës për rritjen e shpejtë të popullsisë. Kjo shpjegon pjesërisht përqindjet shumë të larta

[99] Evropa Jug Lindore Pamje Strategjike mbi Kohezionin Social, Strukturën e Shëndetit, Raport mbi Vendin, Shqipëri, Tiranë, 2001.
[100] Vrojtimi mbi Njohuritë, Sjelljet, Praktikat dhe Besimet (KAPB), 2001.
[101] MICS, Instat, 2000.

Vetëm

- 42% e grave shqiptare kanë bërë një ekzaminim gjinekologjik
- 20% dinë se çfarë është ekzaminimi i gjirit
- 18% e nënave thonë që ato vizitohen nga një mjek gjatë tremujorit të parë të shtatzanisë

Burimi: Njohuri, Zakone, Praktika dhe Besime Vrojtim i (KAPB), 2001.

të vdekshmërisë amtare para vitit 1990, pasi gratë shtatzëna kryenin në mënyrë të paligjshme aborte të pasigurta. Vdekjet amtare ishin pasojë e aborteve të paligjshme në 55% të rasteve gjatë periudhës 1980-1990[102]. Frekuenca e aborteve mund të shpjegohet, pjesërisht, me mospërdorimin e kontraceptivëve dhe edhe rritjen e aktivitetit seksual. Kur ekzistojnë shërbimet e planifikimit familjar, qeveria shpesh nuk siguron informacion për to, ose këto shërbime janë shumë të shtrenjta për arsye të transportit, ryshfetit ose çmimeve të ilaçeve. Shfrytëzimi i tyre është edhe më i vështirë për emigrantët, pasi ekziston shpesh pengesa e gjuhës dhe ata shpesh detyrohen të migrojnë, në mënyrë të paligjshme.

Këshilli i Ministrave e konsideron planifikimin familjar një të drejtë themelore të

Burrat, duke përfshirë të gjithë grupmoshat, refuzojnë të përdorin prezervativë, kurse gratë nuk janë të informuara aq sa duhet për rëndësinë e përdorimit të perzevativëve për t'u mbrojtur nga Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme. Statusi i dobët i grave në Shqipëri dhe sidomos në zonat e thella fshatare shpesh lidhet me nivelin e ulët të arsimit dhe të vetërespektimit. Psikologjikisht, shumë gra shqiptare e kanë të vështirë të bisedojnë për seksin e sigurt.

Burimi: HIV/AIDS në Evropën Juglindore, UNICEF, Korrik 2001.

njeriut dhe Ligji mbi Ndërprerjen e Shtatzanisë i vitit 1995 lejon abortin me kritere të gjera dhe këshillim të detyrueshëm. Ka një projektligj më të gjerë mbi Shëndetin Riprodhues, që pret miratimin nga Parlamenti. Në Shqipëri, mjetet moderne kontraceptive shpesh importohen dhe janë të shtrenjta, megjithatë disa shpërndahen falas nga Fondi i Popullatës i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) dhe agjencitë e tjera. Një vrojtim i Bankës Botërore nxori përfundimin se: (a) Shumë shqiptarë kanë akoma informacion të pjesshëm apo të gabuar mbi kontracepsionin; (b) Brezi i ri është shumë më tepër liberal sesa brezi i vjetër konservator dhe është i interesuar për të patur një edukim më të mirë seksual; (c) Informacioni mbi planifikimin familjar ka ndikim mbi ata që e marrin.[103]

Shumica e përdoruesve të drogës janë të rinj (adoleshentë dhe 20 vjeçarë) dhe të papunë. Përdorimi i drogës është në rritje në masën e adoleshentëve; disa vrojtime periodike tregojnë se numri i të rinjve që përdorin drogat dyfishohet çdo dy vjet. Marihuana është droga më e përdorshme, kurse droga më e zakonshme e injektuar është heroina. Faktorët që rrisin rrezikun e përdorimit të drogës janë: Mundësia për ta gjetur (relativisht pjesa më e mirë e rinisë në zonat urbane); Ndjekja e shkollës në zonat urbane (drogat nganjëherë jepen dhe shpërndahen falas); Të rinjtë që shesin drogë dhe anëtarët e bandave që trafikojnë drogën; Prostitucioni (veçanërisht prostitutat-femra të zonave bregdetare); dhe Mungesa e aktivitetit/ mundësive argëtuese. Kurioziteti dhe dëshira për të imituar janë motivet kryesore për të provuar drogën, të ndjekura nga ndjenjat e depresionit. Njerëzit, zakonisht, e kanë kontaktin e parë me drogat nga një përdorues i drogës ose nga një grup në një klub nate. Është e rëndësishme të nxitet stili i jetës së shëndetshme mes fëmijëve dhe të rinjve për të ulur dhe parandaluar përdorimin e drogës në të ardhmen. Një mjet kyç për promovimin e parandalimit dhe pakësimin e efekteve të dëmshme të drogës është trajnimi i punonjësve socialë për edukimin dhe këshillimin mbi drogat.

Shumica e rasteve me HIV/AIDS janë meshkuj, të moshave 20-35 vjeç, të infektuar, jashtë vendit, përmes rrugës seksuale. Testimi i gjakut për HIV duhet të jetë falas dhe të bëhet në anonimitet për secilin, siç nënvizohet në strategjinë kombëtare. Vetëm në Institutin e Shëndetit Publik në Tiranë ekziston këshillimi para dhe pas testit. Ka mundësi të kufizuara për trajtimin e njerëzve që vuajnë nga infeksionet e lidhura me HIV/AIDS. Grupi i Kombeve Të Bashkuara mbi HIV/AIDS në Shqipëri u ngrit më 1997 dhe organizoi një konferencë në vitin 1998 mbi "Politikat e Parandalimit dhe Kontrollit të

[102] Gratë e Botës: Ligjet dhe Politikat që prekin Jetën e Tyre riprodhuese: Evropa Qendrore Lindore, 2000. Shoqata e Planifikimit Familjar e Shqipërisë. www.crlp.org/pub_bo_wowece.html

[103] Perceptimet e Publikut Shqiptar për Sistemin e Shërbimit Shëndetësor, i cituar në HIV/AIDS në Evropën Jug-lindore, UNICEF, Korrik 2001.

Epidemisë HIV/AIDS/STI në Shqipëri", që miratoi një dokument strategjie që u jepte përparësi përgjegjësive politike, parandalimit, kontrollit, mbikëqyrjes dhe kërkimit, trajtimit, kujdesit dhe mbështetjes; çështjeve sociale, ligjore dhe etike, dhe bashkëpunimit ndërsektorial dhe shumë disiplinor.[104] Është krijuar një Komision Ndër-Ministerial mbi HIV/AIDS për të mbështetur projektet/iniciativat/programet mbi identifikimin dhe parandalimin e rasteve të HIV/AIDS.

Grupet e rrezikuara nga HIV/SIDA

Grupet e mëposhtme kanë arsye të ndryshme për të qenë në rrezik, por të gjithë kanë një nivel të ulët ndërgjegjësimi mbi HIV dhe edukimin seksual që kontribuon në sjelljen e rrezikshme:

- Përdoruesit e Drogës me Injeksion (PDI): Dihet shumë pak rreth kulturës së këmbimit të gjilpërave në Shqipëri ose numrit të PDI-ve, por numri i tyre po rritet.
- Homoseksualët: Dihet shumë pak mbi zakonet e tyre. Përbuzja e bën të vështirë për komunitetin homoseksual të organizojë ose marrë shërbime nga Qeveria. Numri i rasteve të raportuar me HIV, që përfshin homoseksualët është më e lartë se pjesa e tyre në totalin e popullsisë.
- Popullsia në lëvizje: Migrimi mund të çojë në një rrezik më të madh të ekspozimit dhe importimit të HIV/AIDS. Migrantët e paligjshëm në ose nga Shqipëria janë të zakonshëm dhe zakonisht shmangin institucionet e shërbimit shëndetësor nga frika e pasojave nëse zbulohet statusi i tyre i paligjshëm.
- Të rinjtë:sidomos meshkujt, janë më të mundshëm të jenë PDI (Përdorues të drogës me injeksion) ose të migrojnë shumë herë në vendet fqinje në kërkim të një pune të paregjistruar.
- Prostitutat/Viktimat e Trafikimit: janë në rrezik të madh të ekspozimit pa mbrojtje; përveç këtyre shumë shkojnë jashtë dhe kthehen duke sjellë rrezikun.

5.1.3 REKOMANDIME

TË PËRGJITHSHME

- Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit shëndetësor parësor, si rruga më e frytshme për arritjen e përmirësimeve në statusin e shëndetësisë, duke përfshirë trajnimin e personelit të shëndetësisë pranë bashkësisë.
- Informimi më i mirë i publikut mbi Reformat shëndetësore dhe punonjësit e shëndetësisë.
- Agjencitë e shëndetit të mjedisit, siç janë ato përgjegjëse për ushqimin e kontrolluar duhet të punojnë së bashku.
- Duhet të ketë më tepër koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet organizatave të huaja donatore dhe të interesuarve brenda vendit[105].
- Duhet nxitur besimi në sistemin e raportimit, në mënyrë që njerëzit të hezitojnë më pak në përdorimin e shërbimeve shëndetësore të publikut.
- Komunitetet (dhe vendet e tjera), që presin emigrantët shqiptarë, duhet të synojnë sigurimin e shërbimeve të specializuara për emigrantët, veçanërisht në fushën e shëndetit riprodhues.
- Njësitë e lëvizshme shëndetësore duhet të sigurojnë informacion, depistim dhe trajtim.
- Duhen mbështetur iniciativat e vaksinimit.
- Është urgjent analizimi i rolit të mundshëm të farmacistëve dhe farmacive në promovimin e shëndetit të komunitetit.
- Duhet përmirësuar ndërgjegjësimi prindëror dhe trajnimi për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme (ECD) si dhe duhet përfshirë shoqëria civile në mbështetjen vullnetare të shërbimeve ECD pranë bashkësive.

SHËNDETI RIPRODHUES

- Eshtë e rëndësishme të hidhen poshtë këto tabu sociale, që vendosin pengesa në parandalimin e një epidemie të mundshme HIV në Shqipëri.
- Planifikim familjar duhet të njihet si një strategji e reduktimit të varfërisë dhe një pjesë integrale e shërbimit parandalues shëndetësor, përderisa Shqipëria ka një popullsi kaq të re.
- Qeveria dhe komuniteti ndërkombëtar është e nevojshme të nxisin dhe të japin burime për Amësinë e sigurt për të ulur përqindjen e lartë të vdekshmërisë amtare në Shqipëri.
- Shëndeti i grave duhet të trajtohet që në fëmijëri, duke përfshirë të ushqyerit, edukimin shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor.
- Duhet të vendosen politikat e Qeverisë mbi logjistikën e kontraceptivave dhe sistemet e menaxhimit, në mënyrë që të mbikqyret shpërndarja dhe përdorimi i kontraceptivëve dhe për të identifikuar nevojën për furnizim, që ndonjëherë është i çrregullt dhe i shtrenjtë.
- Të identifikohen grupet e synuara për të cilat

[104] HIV/AIDS në Evropën Jug-Lindore, Korrik 2001.
[105] Organizata Botërore e Shëndetit dhe Banka Botërore kohët e fundit kanë organizuar një iniciativë të tillë nëpërmjet krijimit të një "Grupi Pune mbi Shëndetin".

Rekomandime mbi Shëndetin Riprodhues të Adoleshentëve

- Pjesëmarrja e të rinjve në planifikim, zbatim, mbikëqyrje dhe vlerësim të projekteve, programeve dhe politikave të lidhura me rininë.
- Sigurimi jo vetëm i njohurive për të rinjtë por gjithashtu edhe i aftësive për nxitjen e kapaciteteve të tyre për të komunikuar, marrë vendime dhe planifikuar jetën e tyre duke përdorur kanale të njohura dhe inovative për komunikim dhe duke përfshirë edukimin midis bashkëmoshatarëve.
- Përmirësimi i mundësisë së shfrytëzimit të shërbimeve dhe përpunimi i qëndrimeve miqësore për të rinjtë në kujdesin ndaj shëndetit riprodhues.
- Rritje e ndërgjegjësimit dhe trajnimi i siguruesve të shërbimeve, mësuesve, prindërve, medias dhe hartuesve të politikave mbi problemet e rinisë.
- Hartimi i programeve që trajtojnë edukimin seksual për rininë brenda dhe jashtë shkollës.
- Ndërmarrja e kërkimeve cilësore për të siguruar ndërhyrjet e duhura efektive.

kontraceptivët duhet të jenë në dispozicion dhe të shpërndahen falas.

- Zbatimi i një politike plotësuese nga qeveria për t'i përfshirë kontraceptivët nën Skemën e Sigurimit Shëndetësor.
- Instituti i Shëndetit Publik duhet t'u japë përparësi dhe të synojë grupet e prekshme me iniciativa parandaluese.
- Duhet të mundësohen testimi vullnetar dhe sekret i HIV/AIDS si dhe këshillimi në shkallë kombëtare.
- Nxitja e të rinjve për të marrë vendime lidhur me stilin e tyre të një jete të shëndetshme është shumë e rëndësishme, përderisa investimi në parandalimin e sëmundjeve do të parandalojë në të ardhmen kostot shumë të larta sociale.
- Duhet të ketë një politikë konkrete për bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe shërbimit shëndetësor për ta edukuar rininë mbi çështjet e riprodhimit.

ULJA E KËKESËS PËR DROGË

Problemi i drogës duhet të trajtohet nga perspektivat e reduktimit të kërkesë-ofertë. MRP ka monopolin mbi reduktimin e ofertës së drogës dhe ajo duhet të bashkëpunojë, gjë që nuk ndodh për momentin, me Ministrinë e Shëndetësisë, që duhet përfshirë seriozisht në uljen e kërkesës. Shih seksionin 7.1 mbi Krimin e Organizuar për trajtimin e ofertës.

- Publiku mund të përfitojë nga iniciativat për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemet e drogës. Grupi më i rëndësishëm është rinia, që mund t'i drejtohen direkt programet dhe aktivitetet shkollore dhe universitare, me pjesëmarrjen e mësuesve dhe prindërve.
- Mund të krijohet një Qendër Kombëtare për Drogën si një pikë e rëndësishme për Qeverinë, median dhe OJQ-të. Një qendër e tillë mund të koordinojë një strategji kombëtare anti-drogë, kërkime mbi përdorimin e drogës dhe shpërndarje informacioni.
- Një gjë e dukshme është mungesa e klinikave të specializuara, veçanërisht e një qendre ku të sëmurët nga droga mund të ndjekin një terapi dhe ku mund të bëhet rehabilitimi i mundshëm i të droguarve.

5.2 Sistemi i Arsimimit

5.2.1 VLERËSIM

Gati ¼ e popullsisë së Shqipërisë janë mësues ose studentë. Sistemi i arsimimit është në gjendje

Sistemi i Arsimit në Shqipëri

Grupmosha	Vitet mësimore	Niveli
Mbi5		Para shkollor
6-14	1-8	Tetëvjeçare
15-18	9-12	Shkolla e mesme
15-18	9-12 ose 13	Teknike
18-23	1-4 or 5	Universitetet

të rëndë, cilësia e arsimimit ka rënë, veçanërisht në zonat rurale dhe jo të gjithë të rinjtë kanë kushte të barabarta për të ndjekur arsimim. Për më tepër, shumë nxënës largohen nga detyrimi shkollor (3% në vitin 1999[106]), veçanërisht vajzat. Kjo po krijon një shtresë shoqërore në kushte të pafavorshme dhe deri në ndërmarrjen e masave të shpejta dhe efektive, kjo shtresë do të rritet së tepërmi dhe do të përbëjë një pengesë për zhvillimin e tregut shqiptar dhe sistemit demokratik. Largimet e "fshehta" përbëjnë gjithashtu një problem; kjo lidhet me pabarazinë e mundësive brenda klasave, në të cilat mësuesit diskriminojnë shpesh fëmijët në vështirësi.

Përqindja e përgjithshme e studentëve ndaj mësuesve është normale, por numri i mësuesve

[106] Fenomeni i Braktisjes së Shkollës në Arsimin Fillor, Ministria e Arsimit dhe e Shkencave, Prill 2000.

është relativisht i lartë në zonat rurale dhe shumë i ulët në zonat urbane, ku klasat e shkollave të mesme janë të mbingarkuara dhe 40 ose 50 nxënës në një klasë quhet normale. Shumë shkolla e përballojnë mungesën e kapacitetit të klasave të tyre, duke patur 2 ose 3 turne nxënësish në ditë, me kohë të shkurtra mësimi. Shumë mësues janë femra, por shumë poste drejtuese mbahen nga meshkujt.

Në vitin 2000 kishte 229 nxënës e studentë për 1000 banorë dhe 58% e tyre të moshës 3-22 vjeç ishin nxënës, një përqindje e vogël sipas standardeve rajonale dhe evropiane, shpjeguar kjo nga fakti se, vetëm 38% e grup-moshës parashkollore ndjekin shkollën. [107] Shkalla e alfabetizmit në Shqipëri është e njëjtë me mesataren e Europës Juglindore. Alfabetizmi është i ulët lidhur me kategoritë e mëposhtme: mbi moshën 50 vjeç, për personat që jetojnë në Veri dhe personat që jetojnë në zonat rurale. Diferencat ndërmjet burrave dhe grave nuk janë thelbësore, përveçse mbi moshën 50 vjeç. 8% e burrave dhe 22% e grave mbi moshën 15 vjeç janë analfabetë.[108]

Mësimdhënia e ka humbur emrin e saj me prestigj lidhur me shkencat, mjekësinë dhe ekonominë. Studentët e mirë nuk konkurrojnë për të hyrë në fakultetet për mësuesi. Qeveria ka marrë disa iniciativa, por puna më e madhe në arsimim, në vitet e fundit , është bërë nga OJQ-të, të tilla si SOROS, CRS, Save the Children, së bashku me UNICEF-in. Ministria e Arsimit dhe e Shkencave aktualisht është në procesin e përpunimit të strategjisë së arsimimit dhe hartimit e ngritjes së një sistemi të ri kualifikimi për mësuesit në punë.

Shkollat e mesme janë të ndara në profesionale ose të përgjithshme. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka filluar eksperimentimin e profilizimit në 15 shkolla të mesme, sipas të cilit shkollat e mesme specializohen në shkencat ekzakte ose shoqërore. Duke synuar pakësimin e punës së mbingarkuar të nxënësve dhe përshtatjen më të mirë të interesave me programet e tyre, tekstet e reja dhe programet etj. u përgatitën shumë shpejt dhe nxënësit, tani, pas 3 vjetësh, duken se ndihen dhe më shumë të mbingarkuar.

Shumica e mësuesve vazhdojnë të bëjnë kurse private sepse rrogat e tyre janë shumë të ulta, por disa nxënës nuk mund të marrin mësime private ngaqë prindërit e tyre nuk mund të paguajnë për to. Ky fenomen vihet re më shumë në shkollat e mesme sesa në ato tetëvjeçare. Një problem tjetër që duhet të merret në konsideratë është ngacmimi që u bëhet disa nxënësve nga mësuesit, duke abuzuar me pushtetin e tyre në sistemin e edukimit. Dhe një studim mbi këtë problem do te ishte i vlefshëm. Faktet subjektive tregojnë që shkelësit më të njohur rrallëherë janë ndëshkuar[109].

Numri i shkollave private po rritet me shpejtësi dhe cilësia e tyre po ndryshon shumë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës[110] ka bërë shumë për të çuar përpara rehabilitimin e shkollave, por urbanizimi i shpejtë i ka lënë disa fëmijë pa arsim, sikurse është rasti i qytetit të Kamzës, të rrethit të Tiranës, ku e vetmja ndërtesë është një shkollë për 700 nxënës[111]. Buxheti Total i Qeverisë për Arsimin si përqindje e PBB u rrit në vitin 2002.

Sistemi i Shqipërisë për Institucionet para shkollore nuk u përgjigjet nevojave aktuale të fëmijëve dhe janë të kushtueshme për një pjesë të madhe të fëmijëve. Ka pak kopshte, vetëm një e treta e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç shkojnë në kopsht. Numri i çerdheve në Shqipëri u zvogëlua gjatë tranzicionit dhe çerdhet tani kanë mungesë në infrastrukturë, kurse edukatorët kanë mangësi në njohuritë e tyre pedagogjike. Verilindja e Shqipërisë, në veçanti, po përjeton rënien e aktiviteteve të OJQ-ve dhe buxhetet e ulta të bashkisë, të cilat nuk u japin përparësi çerdheve të fëmijëve. Ka nevojë urgjente për të zhvilluar modele të reja për zhvillimin e fëmijëve, gjatë periudhës së fëmijërisë (ECD)), që merr parasysh nevojat e edukimit të fëmijëve, nga pikëpamja e rritjes normale psikologjike dhe zhvillimit.

5.2.2 ANALIZË

Lëvizjet demografike të pakontrolluara të familjeve në zonat rurale drejt zonave urbane, kanë çuar në rritjen e madhësisë së klasave në qytete, sepse shpërndarja e numrit të mësuesve nuk përputhet më me demografinë. Shkollat janë gati të ngrira nga mungesa e burimeve financiare dhe duhet të jenë më të ndërgjegjshme për mundësitë dhe të drejtat e tyre, sikurse është ligji për shërbimet ndaj të tretëve. Metodat e mësimdhënies janë të vjetra dhe ekziston një hendek i madh midis mësuesve të vjetër dhe nxënësve. Infrastruktura e shkollës është e pamjaftueshme në shumë zona. Një pengesë për të ndryshuar është mendimi se, shkollat kanë mangësi dhe nuk munden të kenë përparime pa pajisje moderne dhe pa Internet. Rezultatet, që mund të fitohen nga këto materiale, janë të zmadhuara. Sistemi duhet të përdorë, së pari, burimet ekzistuese dhe zhvillimin e rrjeteve lokale dhe të burimeve, para se të ketë burimet e

[107] Projekti i Edukimit Global, 2000, UNICEF.
[108] Gjendja e Popullsisë në Botë, 2001, UNFPA
http://www.unfpa.org/swp/2001/english/indicators/indicators 1.html
[109] Komunikim direkt me 3 studentë dhe 2 prej stafit të universitetit, 2002.
[110] Burime të SOROS dhe Bankës Botërore
[111] Themeluar nga SOROS. Kjo zonë përmban popullsi nga Veriu, që është gjithashtu synim i stereotipave nga disa banorë të Tiranës.

huaja elektronike.

Sistemi i arsimit kërkon një qëndrim dhe strategji sistemore dhe ka mosmarrëveshje për procedurat e bashkëpunimit dhe raportimit. Për shembull, shkollat i marrin rrogat nga bashkia, por raportojnë në drejtoritë e arsimit. Nuk ekziston një lidhje e ngushtë midis universiteteve dhe shkollave, si marrëdhënja në kualifikimin e përbashkët. Në vend të kësaj, universitetet janë të mënjanuar, nuk marrin pjesë në bashkëveprim me jetën e përditshme të shkollave. Kur bëhen përpjekje që të lidhen, ato nuk harmonizohen kurrë nga ministria apo të institucionalizohen nëpërmjet monitorimit, veprimit apo marrëveshjeve zyrtare. Projektet e përbashkëta dhe forma të tjera të bashkëpunimit janë një fushë e paeksploruar për ndërhyrje të dobishme.

Hartuesit e politikave duhet të ndjekin seriozisht sistemin e stimujve dhe pagave në vend. Në korrik të vitit 2001 mësuesit parauniversitarë merrnin mesatarisht një rrogë mujore bruto prej 18.000 lekësh (neto 16.500 lek), ndërkohë që pedagogët e universiteteve marrin një rrogë mujore bruto prej 27.000 lek deri në 58.800.[112]

Një ndihmë e vogël për të mbuluar shpenzimet bazë të shkollës u është paguar atyre familjeve që vërtetojnë se të ardhurat e tyre janë shumë të pakta. Ka familje që arrijnë të marrin dokumente fallso të cilat tregojnë se të ardhurat e tyre janë 0. Praktika e financimit të bursave shkollore për studentët që kanë nota shumë të mira, nganjëherë çon në rritjen e presioneve ndaj mësuesve për të ndikuar të rritur notat.

Nuk ka patur asnjë nen në buxhet për trajnimet e mësuesve që prej vitit 1998, kur kompetencat kaluan nga Instituti i Studimeve Pedagogjike tek drejtoritë e arsimit të rretheve, të cilat ishin të papërgatitura dhe kufizuan fondet. Funksioni iu dorëzua pa decentralizim financiar përkatës, duke e lënë trajnimin në iniciativën e mësuesve, të cilët duhej kërkonin fonde të ndryshme dhe nuk kanë motivimin të përparojnë me të tilla rroga të ulta dhe kushte të dëshpëruara. OJQ-të mundohen të lehtësojnë situatën, por ka një nevojë urgjente për një sistem kombëtar kualifikimi në Shqipëri. Disa mësues me kualifikim profesional kanë humbur punën e tyre ose kanë kaluar në sektorin privat, ku pagat janë më të larta, duke theksuar nevojën për stabilitet më të madh të personelit.

Ka patur shumë rishikime të programeve, por shumë pak përmirësime. Shkollat fillore (8 vjeçare) janë konsoliduar, por ka probleme me programet e shkollave të mesme, përfshirë:

a) Metodologjinë – duhet të hyjnë metodat bashkëvepruese;

b) Përmbajtjen – nuk ka vazhdimësi ndryshimi midis njohurive të marra në shkollë fillore dhe të mesme.[113]

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nuk ka strategji ose specialistë që përqendrohen në problemet e largimit. Të rinjtë që largohen nga shkolla ose që e mbarojnë atë, rrezikojnë (a) mënjanimin social, dhe (b) futjen në ekonominë kriminale, sidomos kur kanë të ardhura të pakta dhe janë të papunë.[114]

Arsyet për mosndjekjen ose lënien e shkollës, të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për vitet 1991-1997 përfshijnë zbatimin e dobët të ligjit për Arsimin e Detyrueshëm nga autoritetet lokale, të ardhurat e ulta, veçanërisht në zonat rurale, nevoja për punën e fëmijëve për të mbajtur familjet e tyre, rastet që dëshmojnë një siguri të pamjaftueshme publike, mungesa e interesave për arsimim, nivel i ulët i mësuesve, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë në qytete dhe jashtë, infrastrukturë e dobët dhe gjakmarrjet midis familjeve, ku fëmijët janë në rrezik jete[115]. Arsye të tjera mund të jenë dhe qëndrimet e prindërve ndaj shkollës dhe kuptimit se si shkollimi ndikon në përmbushjen e nevojave në të ardhmen, mendësitë patriarkale, prirja e disa besimeve për të penguar shkollimin e femrave, mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për të siguruar banimin në një rreth, pjesëmarrja në tregun e zi dhe atë informal të punës, mësuesit e pamotivuar, migrimi i shpejtë dhe i pakontrolluar dhe mungesa e sigurimit të transportit nga shteti për distanca të mëdha ku ekziston rreziku i grabitjes. Grupi i të Drejtave të Njeriut i Shqipërisë (AHRG) raportoi se 900 fëmijë nuk kanë ndjekur shkollën në vitin 2001 për shkak të frikës së hakmarrjes.[116]

Largimet e 'fshehta' – diskriminimi në klasa – janë dukuri negative dhe që nuk kuptohen në Shqipëri, të cilat janë shpërfillur në sistemin e arsimit dhe kanë kontribuar në fenomenin e largimit nga shkolla. Mësuesit luajnë rolin kyç në ndalimin

[112] Komunikim Direkt me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, 2002.

[113] Banka Botërore tashmë ka themeluar qendrën për rivlerësim për të shqyrtuar dhe përpunuar modelet dhe pyetësorët mbi efektivitetin e studentëve dhe mësuesve.

[114] Shqipëria: Duke Mbushur Hendekun e Dobësive, shkresa teknike e Bankës Botërore Nr 460, shkurt 2000. 2000. http://www.worldbank.org/html/extdr/regions.htm click Albania, bank reports.

[115] Fenomeni i Braktisjes në Shkollat Fillore, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Prill 2000.

[116] Raportet e Vendeve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut-2001: Shqipëri, Departamenti i Shteteve të Bashkuara, Mars 2002. http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2001/eur/9219pf.htm

ose në vazhdimin e largimeve "të fshehta", por pjesa më e madhe e tyre nuk janë të përgatitur mirë profesionalisht që të përballen me këtë problem, sepse mësuesit vuajnë nga mungesa e njohurive të mjaftueshme psikologjike mbi nxënësit e vështirë dhe nuk e njohin metodën e mësimit me bashkëpjesëmarrje.

Edukatorët e çerdheve në sistemin e çerdheve si rregull punësohen nga bashkitë pa asnjë lloj kriteri dhe nuk synojnë të kualifikohen mbasi janë punësuar, kështu që nuk është e papritur që kujdestarët e fëmijëve të mos jenë të përgatitur për t'u kujdesur për të gjitha aspektet e zhvillimit të fëmijëve. Edukatorët e fëmijëve kanë nevojë për informacione dhe këshilla se si të kujdesen për zhvillimet emocionale, sociale, gjuhësore dhe fizike të fëmijëve; se si të njohin dhe t'i përgjigjen temperamentit dhe interesit të çdo fëmije; - se si të krijojnë një mjedis që të jetë i sigurtë,i shëndetshëm dhe stimulues; dhe – se si të punojnë me familje dhe profesionistë të tjerë për të siguruar një program cilësor. Kushtet fizike të çerdheve kanë nevojë që të përmirësohen, pasi pajisjet, materialet, qofshin ato edhe të edukimit janë të pakta, të prishura dhe pjesa më e madhe e tyre mungojnë. Shqipëria duhet të përmirësojë shërbimet ekzistuese të shëndetit të fëmijëve dhe praktikat, duke u mbështetur në suksesin e modeleve të komuniteteve me çmim të ulët, duke rritur përgjegjësinë dhe profesionalizmin e punonjësve të shëndetit dhe të punës sociale.

Tani që faza emergjente mbaroi, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës duhet të merret me shqetësimet për sistemin arsimor shqiptar, duke përdorur një metodë sistemore nëpërmjet analizimit të përpjekjeve, proceseve dhe prodhueshmërisë së sistemit, për të siguruar vendime të arsyeshme dhe të bazuara mirë.

5.2.3 REKOMANDIME

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës duhet të përdorë burimet e saj të brendshme intelektuale për të hartuar një strategji të zhvillimit arsimor në një proces të hapur dhe të përgjithshëm, duke përfshirë shumë palë të interesuara për të ndërtuar një mirëkuptim afatgjatë dhe zotim kundrejt zbatimit të saj.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të koordinojë përpjekjet e institucioneve të saj shtetërore dhe OJQ-ve, që punojnë në fushën e arsimit, në harmoni të plotë me planin e saj strategjik të zhvillimit të arsimit.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të përgatisë më shumë procedura dhe instrumente mbështetës dhe informues.
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës duhet të hartojë një strategji për të pakësuar shkallën e braktisjes së shkollës në bazë të analizës së thelluar dhe duke u përqendruar në zonat me përqindje më të larta të braktisjes.
- Institucionalizimi i sistemit të kualifikimit të mësuesve në shërbim është shumë urgjent.
- Kualifikimi para shërbimit apo fakultetet e përgatitjes së mësuesve duhet të përditësojnë aktivitetet e tyre të përditshme, në përputhje me zhvillimet më të fundit shkollore ,duke vendosur lidhje të ngushta me to.
- Nxitja e iniciativave të bashkëpunimit midis universiteteve dhe shkollave. Krahas funksionit kërkimor akademik dhe shkencor, universitetet duhet të përdorin të gjitha mundësitë e siguruara për ta nga ligji për arsimin e lartë, që të kryejnë më mirë funksionin e tretë, atë të shërbimit palëve të treta, dmth. shkollat. Përfitimi do të jetë i përbashkët.
- Rrogat e mësuesve duhet të rriten dhe duhet të gjenden stimuj të tjerë për mësuesit për të ndihmuar në rritjen e kredibilitetit të profesionit të mësimdhënies, në veçanti dhe, sektorit të arsimit në përgjithësi.
- Infrastruktura në shkollat publike duhet të trajtohet me kujdes.
- Alfabetizmi duhet të drejtohet ndër grupet e caktuara.
- Fenomeni "largimi i fshehtë" duhet të konsiderohet si një përparësi dhe mësuesit duhet që të përdorin metoda dhe strategji të reja, të cilat merren me studentët që janë më problematikë.
- Fëmijët e ngujuar për arsye të gjakmarrjes, kanë nevojë për burime alternative në edukim, mënyrat për zgjidhjen paqësore të konflikteve mund të integrohen në programin/aktivitetin e shkollës dhe disa komunitete mund të përfitojnë nga trajnimi i shumë mësuesve, për të dhënë një shembull të mospërdorimit të dhunës dhe të tolerancës në komunikim.

ZHVILLIMI I HERSHËM I FËMIJËRISË (ECD)

- Përparësi të veçanta duhet t'i jepen zbatimit të metodave alternative të ECD-së, të tilla si modelet pranë familjes dhe komunitetit, që përfshijnë harmonizimin fëmijë-nënë-kujdestare.
- Qeveria duhet të jetë e pranishme në të gjitha fazat e programeve të shoqërisë civile dhe të donatorëve të ECD-së, kështu që këto ministri të kenë më shumë autoritet kundrejt programeve në të ardhmen dhe duhet t'i shpërndajnë këto programe bashkë me

përvojën e tyre në të gjithë Shqipërinë. Projekte pilot mund të bëhen baza kualifikimi për kujdestarë të tjerë.

- Futja e kurseve të para-shërbimit për edukatorët e fëmijëve në Fakultetin e Infermierëve dhe për mësuesit në Universitetet Pedagogjike.
- Shumë nga kujdestarët e fëmijëve duhen të kualifikohen më shumë kujdestare të fëmijëve për të zbatuar metodat që vënë fëmijën në qender, ndërsa do të kujdesen për foshnjat dhe fëmijët që nisin të ecin.
- Të përgatiten standardet e edukimit para shkollor
- Të përmirësohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri në fushën e ECD dhe të harmonizohen ndërhyrjet në sektorin e arsimit në përgjithësi, bashkë me ndërhyrjet e ECD-së.

6 Siguria e Mjedisit

Synimi i Zhvillimit të Mjëvjeçarit

- **Sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore**
  - Integrimi i parimeve të zhvillimit të vazhdueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthimi i humbjeve të burimeve mjedisore
  - Përgjysmimi deri më vitin 2015, i përpjesës së njerëzve që nuk kanë vazhdimisht ujë të pijshëm.

Kushtetuta e vitit 1998 bën thirrje për një "mjedis të shëndetshëm dhe ekologjik të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm", "shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm" dhe të drejtën e shtetasit "për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij".

6.1 Mjedisi Natyror

6.1.1 VLERËSIM

Gjeografia e Shqipërisë[117]	
Sipërfaqja e përgjithshme e Shqipërisë	28,748 km^2
Sipërfaqja ujore e brendshme	1,350 km^2
-Rrjeti i lumenjve	721 km^2
-Liqenet natyrale	325 km^2
-Liqenet articifiale	174 km^2
-Lagunat	130 km^2
Sipërfaqja tokësore	27,392 km^2
-Kodrat	47%
-Malet	28%
-Fushat	25%
Vija Bregdetare[118]	362 km
Fuqia diellore mesatare vjetore në tokë	2,107 kwh/m^2
Reshjet mesatare vjetore	1,430 mm

"Zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe të paligjshme, trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të

Lumenjtë dhe liqenet kryesore

Lumi Drin lidh Shqipërinë me Kosovën dhe Maqedoninë
Lumi Vjosa rrjedh nga Greqia në Shqipëri
Lumi Shkumbini ndan veriun dhe jugun e Shqipërisë
Liqeni i Ohrit ndodhet përgjatë kufirit me Maqedoninë
Liqeni i Prespës ndodhet përgjatë kufirit me Maqedoninë
Liqeni i Shkodrës ndodhet përgjatë kufirit me Malin e Zi

ndotura dhe erozioni i lartë i tokës po dëmtojnë cilësinë e ujit bregdetar dhe po ulin potencialin e turizmit".[119] Ndikimi në turizëm është vetëm një nga pasojat e ndotjes, që shumë shpesh nuk kuptohen ose janë nënvleftësuar. Të tjera pasoja janë ndikimi në shëndetin publik dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Zyra Kombëtare e Mjedisit u krijua në vitin 1998 me amendamentin e Ligjit të vitit 1993 per Mbrojtjen e Mjedisit dhe u kthye në Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit në vitin 2001 me 70 punonjës. Ngritja në status duket se ka pasur një efekt pozitiv. Qeveria publikoi raporte për Gjendjen e Mjedisit (SOE) në vitin 1995, 1999 dhe 2001. Plani i Veprimit Kombëtar Mjedisor (NEAP) u miratua në vitin 1994 dhe u përditësua në vitin 2001 dhe Plani i Veprimit Kombëtar të Shëndetit të Mjedisit (NEHAP) u miratua në vitin 1999. Ka një Agjenci Rajonale të Mjedisit (ARM) në secilën prej 12 prefekturave të Shqipërisë, përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit të mjedisit. Qeveria ka caktuar shumë Zona të Mbrojtura[120]dhe po bashkëpunon me Agjencinë Evropiane Të Mjedisit (EEA).[121] Shqipëria është anëtare e Programit Rajonal të Rindërtimit të Mjedisit (RERP) në kuadrin e Paktit të Stabilitetit.[122]

[117] Shqipëria: Një Trashëgimi e Vlerave Evropiane, Shtator 2000, UNDP
[118] Libri Faktik Botëror 2001: Shqipëri, CIA, 2001. http://www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/al.html
[119] Rruga drejt Stabilitetit dhe Prosperitetit në Evropën Jug-Lindore, Banka Botërore, Mars 2000. http://www.seerecon.org/RegionalInitiatives
[120] Të renditura në http://www.unep-wcmc.org/protected_areas/data/nat2.htm
[121] http://www.eea.eu.int/
[122] http://www.rec.org/REC/Programs/REREP/

EROZIONI: Cilësia dhe erozioni i tokës mbikëqyren nga Instituti i Tokave. Padyshim, erozioni i tokës është problemi më i madh ambiental në disa bashkësi shqiptare, por është e vështirë të radhitësh sipas rëndësisë problemet ambientale në tërësi. Faktorët që prekin produktivitetin e tokës janë thelbësore kur dihet se bujqësia dhe pyjet përbëjnë mbi 50% të PPB-së. Erozioni përbën problem për shkak të uljes së produktivitetit të tokës bujqësore, bllokimit të kanaleve ujitëse dhe digave të hidrocentraleve me llum dhe rrit nivelin e ndotjes në atmosferë. Rreth 50.000 hektarë toke janë ndotur nga industria e naftës. Niveli i kripëzimit, kimikateve dhe metaleve në tokë janë gjithashtu probleme në zona të tjera. Një tjetër problem ambiental që prek tokën është shpyllëzimi. Vetë organizmat qeveritarë konsumojnë lëndë të djegshme më shumë sesa Qeveria lejon me ligj dhe shet në mënyrë të ligjshme në treg dhe ka një sasi të konsiderueshme prerjesh ilegale të kryera për të plotësuar nevojat e industrisë private dhe familjeve.

CILËSIA E AJRIT: Cilësia e Ajrit mbikqyret nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti Hidro-Meteorologjik. Nivelet e Dioksidit të Squfurit (SO_2) ranë në fillim të viteve 1990, por ata po rriten sërish dhe po bëhen një shqetësim së bashku me Dioksidin e Karbonit (CO_2), Oksidin e Azotit (NO) dhe ndotjen. Ozoni (O_3) nuk është matur.

CILËSIA E UJIT: Shqipëria ka shumë burime uji të freskët, por ato janë të përqendruara në disa liqene dhe lumenj kryesorë, kryesisht përgjatë kufijve ndërkombëtarë, duke e bërë menaxhimin e ujit një problem ndërkufitar. Është e rëndësishme të kontrollohet niveli dhe cilësia e ujit në mënyrë që të zvogëlohen përmbytjet, të sigurohen rezerva të mjaftueshme për hidro energji dhe ujitje dhe të sigurohet ujë i pastër për të pirë dhe peshkim. Shqipëria ka një Ligj të vitit 1996 mbi Burimet Ujore dhe ka përgatitur një Plan të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Kimikatet bujqësore dhe ujërat e ndotura dhe të shtëpive po hyjnë në ujin nëntokësor, duke kërcënuar furnizimet me ujë.

Zonat e Mbrojtura[123]	
Zonat e mbrojtura plotësisht	14,500 ha
Parqet Kombëtare	56,440 ha
Monumentet e Natyrës	4,700 ha
Zonat e Menaxhuara	42,898 ha
Peizazhet e mbrojtura	29,873 ha
Zonat e Mbrojtjes Burimore	18,200 ha

TRAJTIMI I MBETURINAVE: Mbeturinat përbëjnë një problem të madh në Shqipëri, përderisa mungesa e trajtimit të organizuar të plehrave çon në mospërpunim të ujërave të zeza dhe përdorim të vendeve të mbeturinave, që janë jozyrtare dhe të padëshiruara ambientalisht, duke ndotur ajrin, ujin nëntokësor dhe tokën përreth tyre. Strategjia Kombëtare për Mbeturinat u miratua në vitin 1996. Sipas Ligjit të vitit 1996 mbi Largimin e Mbeturinave Publike, përgjegjëse për mbeturinat është Ministria e Punëve Publike. Shqipëria sanksionoi Konventën e Baselit në vitin 1999, por i duhet ende të plotësojë kuadrin ligjor për mbeturinat e rrezikshme.

DIVERSITETI BIOLOGJIK: Instituti Biologjik i Universitetit të Tiranës vlerëson se 10% e florës dhe 62% e zvarranikëve në Shqipëri janë të rralla dhe në rrezik. Qeveria mbron 5.8% të tokës (163,561 ha) dhe zotëron 95% të pyjeve (rreth 40% u ka kaluar këshillave të komunave).[124] Shpyllëzimi përbën një problem, por nuk ka patur asnjë inventarizim të fondit pyjor që prej 1985 për të matur shtrirjen e tij. Strategjia Kombëtare e Diversitetit Biologjik dhe Plani i Veprimit u miratuan në vitin 2000.

6.1.2 ANALIZË

Rënia e menjëhershme e prodhimit në fillim të tranzicionit të Shqipërisë, zvogëloi produktet e ndotjes, por rritja ekonomike po përmirësohet dhe disa zona të braktisura industriale vazhdojnë të përbëjnë rrezik për shëndetin dhe mjedisin.[125] Pavarësisht nga disa kontradikta në ligj lidhur me juridiksionin, zbatimi i legjislacionit ekzistues ambiental do të jetë hapi i parë i duhur drejt mbrojtjes së mjedisit. Kjo nënkupton që krijimi i aftësive për zbatimin dhe monitorimin duhet të jetë një përparësi më e madhe se nxitja e ndërgjegjësimit publik dhe zhvillimi i politikave të reja. Problemeve të mjedisit shpesh nuk u kushtohet më shumë se një vëmendje simbolike, kështu që ishte me vlerë Fjalimi i Kryeministrit në vitin 2001 që e ngriti profilin e mbrojtjes së mjedisit si përparësi. Decentralizimi efektiv i kontrollit mbi trajtimin e mbeturinave, ujërave të ndotura, ujit të pijshëm, mbrojtjes së natyrës dhe ndotjes së ajrit mund të forcojë zbatimin. Zbatimi i PVKM-së pritet të kushtojë rreth 250 milion USD, ndërkohë që buxheti i Ministrisë së Mjedisit në vitin 2002 është 0.5 milion USD, duke treguar nevojën për përfshirjen e donatorëve të rëndësishëm.

[123] Gjendja e Mjedisit (SOE), Qeveria e Shqipërisë, 2001.
[124] Kapacitetet Institucionale për Mbrojtjen Mjedisore në Shqipëri, UNEP, 2000. http://balkans.unep.ch/albania/reports.html
[125] Dokumente të shumta ambientale mbi Shqipërinë: http://www.grida.no/enrin/htmls/albania/reports/eng.htm

EROZIONI: Erozioni ndodh për shkak të arsyeve natyrore (3/4 e tokës në Shqipëri është kodrinore ose malore dhe reshjet përqendrohen në pranverë dhe në vjeshtë) dhe arsye njerëzore

UNEP ka Identifikuar disa "Pika të Nxehta" Industriale për veprim parësor

- Fabrika e Kimikateve - Durrës
- Fabrika e PVC- së - Vlorë
- Përpunimi i Naftës - Patos
- Rafineria e Vajit - Ballsh
- Vendi i Shkarkimit të Mbeturinave - Sharra

Të tjera zona industriale, me prioritet të vogël

- Fabrika e Plehërimit të Nitratit- Fier
- Kompleksi Metalurgjik - Elbasan
- Fabrika e Bakrit - Rubik

Burimi: Vlerësimi Mjedisor Post - Konfliktual - Shqipëri. 2000. UNEP.

(shpyllëzimi, braktisja e tokës, keqpërdorimi i tokës, dëmtimi në rrjetet e ujitjes dhe kanalizimit dhe marrja e zhavorrit nga shtratet e lumenjve). FAO po zbaton një projekt pilot për të parë se çfarë mund të bëhet për të ndaluar erozionin dhe për të ndrequr dëmin.

CILËSIA E AJRIT: Cilësia e ajrit u përmirësua me rënien e industrive, në fillim të viteve 1990 dhe kur familjet kaluan nga ngrohja me qymyr në energji elekrike, por industria po rimëkëmbet. Ngrohja e shtëpive, nxjerrja dhe përpunimi i naftës, djegia e plehrave dhe prodhimi i çimentos shkaktojnë ndotjen e ajrit. Përdorimi i makinave është rritur ndjeshëm. Pjesa më e madhe e makinave janë të paktën të vjetra 10 vjet dhe punojnë me naftë. Qeveria nuk kontrollon cilësinë e naftës dhe nuk ka plane për të ndaluar përdorimin e naftës me plumb.

CILËSIA E UJIT: Mbeturinat afër vendbanimeve dhe ndotjet nga industritë e naftës, kimike dhe nxjerrëse janë kërcënimet kryesore për cilësinë e ujit. Qeveria nuk u kërkon industrive që të kontrollojnë ndotjet e tyre të ujit. Uji i ndotur shkarkohet ende në det i papërpunuar në Shqipëri dhe ndotja nuk kontrollohet. Memorandumi i Mirëkuptimit i vitit 1996 për Projektin e Ruajtjes së Liqenit të Ohrit me Maqedoninë, Bordi i Menaxhimit të Liqenit të Ohrit dhe Komiteti i Menaxhimit të Vijës Ndarëse në Liqenin e Ohrit janë shembuj pozitive të bashkëpunimit rajonal për ruajtje dhe rregullim.

MENAXHIMI I MBETURINAVE: Gati gjysma e popullsisë nuk ka të siguruar shërbimet e mbledhjes të mbeturinave. Shpesh mbeturinat e

Mësimet Ambientale të UNEP të nxjerra nga Kriza e Refugjatëve e vitit 1999

- Koordinim më i fortë që prej fillimit
- Të planifikohen vendosjet e refugjatëve duke përdorur Vlerësimin e Ciklit Jetësor për të zvogëluar kostot e rehabilitimit dhe zhvillimeve të mëtejshme lokale
- Të shpërndahen udhëzime dhe procedura ambientale për të gjithë partnerët që prej fillimit
- Më shumë angazhim ndaj rehabilitimit të kampeve të refugjatëve
- Përpara një krize të përgatitet një listë e vendeve të mundshme me një ndjeshmëri relativisht të ulët ambientale
- Të blihen ushqime dhe materiale me ndikim minimal ambiental ose që mund të ripërdoren nga komuniteti pas krizës
- Të sigurohet që ujërat e ndotura të grumbulluara të mos depërtojnë në ujin nëntokësor
- Të përdoret Monitorimi Fotopoint për të dokumentuar ndikimin ambiental në çdo vend

Burimi: Vëzhgimi i mjedisit pas një konflikti, 2000. UNEP.

ngurta shkarkohen në vende që janë të pamenaxhuara, të paligjshme, ku edhe digjen, të vizituara nga kafshë dhe njerëz, ku mund të hyjë kushdo dhe pranë ujit. Nuk ka një sistem për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme industriale, megjithëse shumë ton mbeturinash të rrezikshme kimike dhe pesticidesh janë vendosur kudo nëpër vend në zona të pasigurta dhe të pakontrolluara. Nuk ka gati fare sistem për trajtimin e mbeturinave nga sistemi i kujdesit të shëndetit. Bateritë e shkarkuara dhe vajrat e përdorur nuk trajtohen dhe riciklimi është i pazhvilluar në Shqipëri.

DIVERSITETI BIOLOGJIK: Diversiteti biologjik është kërcënuar nga shpyllëzimi dhe prerjet ilegale, djegiet më të shpeshta të pyjeve, rritja e erozionit të tokës, ndotja e ujit dhe e tokës nga mbeturinat dhe ujërat e zeza, gjuetia e paligjshme dhe përdorimi i dinamitit dhe i rrjetave me zvarritje për peshkim. Për gatim dhe ngrohje, familjet rurale mbështeten në lëndën drusore për 68% të nevojave të tyre energjitike në dimër dhe 53% në verë. Për nevojat rurale ngrohëse në veçanti, lënda drusore përbën 79% të totalit. Një sasi prej 4.3 m^3 lëndë drusore është konsumuar nga çdo familje rurale gjatë vitit 2000, nga një total prej 1.6 milion m^3. Sasia e drurit të konsumuar çdo vit nga familjet, industria dhe vetë

organet Qeveritare, tejkalon shumë sasinë e drurit të shitur zyrtarisht me leje çdo vit nga Qeveria. Përpjekjet për të forcuar sistemin e kontrollimit dhe zbatimit të rregulloreve për prerjet ilegale janë duke u bërë. Ky është një fenomen i vështirë dhe i ndjeshëm që duhet zvogëluar, duke marrë parasysh se ndodh si pë shkaqe tregtare dhe nga nevojat e mbijetesës në komunitetet rurale.[126]

7.3.2 REKOMANDIME

- Qeveria duhet të vazhdojë të forcojë rolin dhe statusin e inspektorëve të mjedisit.
- Përgjegjësia ligjore për dëmtimet e mjedisit ka nevojë të specifikohet dhe kuptohet më mirë.
- Shqetësimet e mjedisit duhet të përfshihen në vendimet menaxhuese, përmes mekanizmave zyrtarë dhe jozyrtarë midis ministrive.
- Të dhënat e mjedisit duhet të konsolidohen, publikohen dhe të përditësohen rregullisht.
- Zbatimi i Konventës së Aarhusit (Konventa e UNECE mbi marrjen e Informacionit, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-Marrje dhe Pjesëmarrjen në problemet e Drejtësisë dhe të Mjedisit[127]), të ratifikuara nga Shqipëria në Qershor të vitit 2001, do të thjeshtojë kuadrin ligjor dhe rregullator dhe do të forcojë ndërveprimin me publikun.
- Planifikimi urban për qytete të qëndrueshme dhe të shëndetshme mban çelësin ndaj sfidave që krijohen nga lëvizja e brendshme e popullsisë dhe ndërtimet e pakontrolluara. Qeveria, Kombet e Bashkuara dhe donatorë të tjerë duhet të vazhdojnë me fushata të tilla si Karta e Aulborgut (Marrëveshja e Qendrave & Qyteteve Evropiane Drejt Qëndrueshmërisë[128]).

6.2. Infrastruktura dhe shërbimet bazë

7.3.1 VLERËSIM

Infrastruktura është një çështje kritike në zhvillimin e Shqipërisë. Pamjaftueshmëria e shërbimeve bazë, rrjeteve të transportit dhe furnizimeve me energji që kufizon standardet e jetesës, pengon biznesin dhe shkurajon investimet private. Turizmi është një shëmbull kryesor i sektorit me një potencial të madh rritjeje që është penguar nga një infrastrukturë e pamjaftueshme. Pozicioni strategjik i Shqipërisë përgjatë Mesdheut në Evropën Juglindore, është një mundësi për

- Energjia ujore në Shqipëri është e lirë
- 8 hidrocentrale kryesore
- Energjia ujore jep 95% të të gjithë prodhimit të energjisë
- Kapaciteti total i instaluar (hidrocentrale dhe termocentrale): 1,656 MW
- Prodhimi total rreth 3.6 miliardë KWh
- Potenciali i vlerësuar: 16 miliardë KWh/vit
- Qeveria importon nga Greqia dhe Sllovenia rreth 1/3 e energjisë së konsumuar
- Një pjesë e rëndësishme (rreth gjysma) e energjisë së prodhuar nuk paguhet
- Mbledhja e tarifës është vetëm rreth 1/3 dhe shumë energji humbet gjatë transmetimit
- Familjet konsumojnë 1/3 e energjisë së konsumuar

Burimi: Profili Investues 2001

Shqipërinë për të përfituar nga interesimi i vendeve të tjera për krijimin e rrjetit të transportit gjithëevropian. Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore vë theksin kryesor te zhvillimi i infrastrukturës në Shqipëri. Shumë nga informacionet në këtë pjesë janë marrë nga "Profili i Investimit 2001: Shqipëri" nga Banka Evropiane Për Rindërtim dhe Zhvillim.[129]

ENERGJIA: Shqipëria është një importuese e mirëfilltë e energjisë, pavarësisht se ka potenciale të mëdha hidroenergjetike, po ashtu sikurse rezerva nafte, gazi dhe qymyri. Aktualisht Shqipëria mbështetet kryesisht në hidroenergjinë për energji dhe shfrytëzon vetëm rreth 1/3 e potencialit të saj hidroenergjitik. Importet janë të kushtueshme për Qeverinë dhe Shqipëria ka pësuar ndërprerje kronike të rënda të energjisë në dimër që prej vitit 2000. KESH, Korporata Energjitike Shqiptare, ka vështirësi për të financuar veprime dhe investime.

Ndërprerjet: Publiku ndjeu për herë të parë ndërprerje serioze të energjisë në dimrin e vitit 2000. Pavarësisht nga krijimi i nje Task Force në vitin 1999, KESH mbetet në vështirësi serioze financiare. Në dimër, konsumatorët në disa qytete furnizohen me energji vetëm për disa orë në ditë, kohëzgjatja shpesh ndryshohet pa lajmëruar dhe disa qyteteve u jepet një sasi e caktuar dhe u ndërpritet energjia kur kjo masë kalohet. Shumica e energjisë prodhohet në Veri, por shumë pak energji shpërndahet atje, gjatë krizave energjitike. Në Dhjetor të vitit 2001, çmimet e energjisë u rritën

[126] Studim i Pavarur i Prerjeve Ilegale, QShKE, Tetor 2001.
[127] http://www.unece.org/env/pp/
[128] http://www.sustainable-cities.org/about.html përfshin një përkthim shqiptar.
[129] 2001. http://www.mac.doc.gov/EEBIC/Investmentprofile/Albania.pdf or http://www.ebrd.com/english/pubs/profiles/alba.pdf

Masa të marra deri më sot

- Kompanisë Italiane ENEL, iu dha nga Qeveria, një kontratë 18 mujore për menaxhimin e KESH-it,
- EBRD dhe Banka Botërore, po ndihmojnë në ristrukturimin e sektorit, duke i ofruar hua të reja KESH-it në mënyrë që të ndërpriten lidhjet ilegale të energjisë, t'u pritet energjia mospaguesve. Të nxitet publiku që të përdorë me kursim energjinë dhe të ulë humbjet teknike.
- EBRD po financon një projekt për rindërtimin urgjent të sistemit të hidroenergjisë dhe të kapaciteteve hidroenergjitike
- KESH-i po bën përpjekje për instalimin e matësve energjitikë për të gjithë konsumatorët dhe të kompjuterizojë sistemin e faturave
- Banka Botërore ka premtuar të financojë një projekt për ndërtimin e një Termocentrali në Vlorë, prej 100 megavat, me një vlerë 80 milion USD.
- Bashkive u është kërkuar të zbatojnë legjislacionin duke kërkuar që ndërtimet e reja të kenë ngrohje qendrore.
- Një Task Force speciale u caktua nga qeveria, me përfaqësues të shumë institucioneve kryesore të energjisë, duke përfshirë KESH-in; ekziston një Plan Veprimi dhe një Strategji Kombëtare për zhvillimin e Sektorit Energjitik
- Reforma e çmimit të energjisë ka nisur

Burimi: Ministria e Industrisë dhe Energjitikës

me qëllim për t'i afruar çmimet me kostot reale të prodhimit të energjisë dhe për ta përgatitur KESH-in për privatizim.

Rreth 1/3 e energjisë së konsumuar në Shqipëri gjatë këtyre viteve të fundit është importuar. Në vitin 2001, Shqipëria prodhoi 3650 GWh dhe importoi 1750 GWh.[130] Nëse Agjensia Kombëtare e Energjisë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore janë të sakta në parashikimin e tyre se konsumi do të rritet me 8.7 % në vit, atëherë Shqipëria do të kërkojë 11.7 TWh për vit nga viti 2010.[131] Disa familje përdorin ende vajgurin, por lënda drusore vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm energjie për gatim dhe ngrohje në zonat rurale. Pse Shqipëria ka mungesa kronike të energjisë? Çfarë strategjie afatgjatë kërkohet për të zgjidhur problemin?

TRANSPORTI[132]: Programi i Investimit Publik i Qeverisë së Shqipërisë përmban plane afatgjata dhe afatmesme për transportin rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor. 90% e investimeve në transport shkojnë në sistemin rrugor. Infrastruktura e transportit në Shqipëri përbëhet prej:

a) Rrjetit rrugor prej 2.400 km rrugësh kryesore, 5,000 km rrugësh dytësore dhe 10.900 km rrugësh terciare. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e 3,100 km, Këshillat e Rretheve 14.900 km dhe Bashkitë 1.000 km;

b) Portet kryesore në Durrës dhe Vlorë dhe portet e vegjël në Sarandë dhe Shëngjin;

(c) Aeroporti ndërkombëtar i Rinasit pranë Tiranës.

d) Rrjeti hekurudhor me 447 km linjash kryesore dhe 230 km linjash degësore.

Duke përjashtuar një rënie të gjerë gjatë krizës së vitit 1997, të gjitha llojet e trafikut janë rritur që prej vitit 1990, përveç trafikut hekurudhor. I matur në ton, transporti u rrit me 8.9% në vitin 2000, me një rritje të shpejtë në transportin detar. Transporti hekurudhor është i lirë, por rrjeti ndodhet në kushte të këqija dhe disa lidhje u mbyllën në fillimet e tranzicionit. Lidhja me Malin e Zi rifilloi në vitin 2002. Rëndësi e madhe i është dhënë Portit të Durrësit nga Pakti i Stabilitetit me investime që përfshijnë një terminal kontenierësh prej 120 milion USD. Në vitin 2000 trafiku ajror i pasagjerëve u rrit me 14.4%. Shih Pasqyrën 33 Të Dhënat mbi Transportin dhe Telekomunikacionin.

TELEKOMUNIKACIONI: Telekomunikacioni ishte sektori i parë i infrastrukturës që u privatizua, me mbështetjen e institucioneve kryesore financiare ndërkombëtare për të nxitur transparencën dhe zhvillimin në këtë sektor. Legjislacioni i duhur dhe organet rregullatore janë vendosur. Ligji për Telekomin i vitit 2000 përmblodhi standardet minimale, rregullat që licensimin dhe shpërndarjen e frekuencave të radios. Dispozita e shërbimit të Internetit dhe telefonisë është liberalizuar plotësisht.

Në vitin 2001 ekzistonin 15 qendra të Ofrimit të Shërbimit të Internetit (ISP) dhe zonave rurale u ofrohej shërbimi telefonik nga 10 operatorë privatë. Albtelekomi me pronësi shtetërore u krijua në vitin 1992. Para këtij viti, shumë familje mbështeteshin për komunikimet në zyrat e postës. Numri i familjeve me një telefon është ende i ulët po në rritje; me më pak se dy telefona

[130] Fjalim i përfaqësuesit të Qeverisë në Takimin Shqiptar të Donatorëve të Sektorit të Energjisë mbajtur në Bruksel më 4 Prill, 2002.
[131] Profili i Investimeve 2001: Shqipëria, EBRD, 2001. http://www.ebrd.com/english/pubs/profiles/alba.pdf
[132] Të dhëna të transportit nga: PIP 2002-2003, dhe komunikim direkt me Ministrinë e Transportit, 2001.

për 100 banorë, Shqipëria ka shërbimin telefonik më të varfër në Evropë.[133] Shumë fshatra nuk kanë qoftë edhe një telefon të vetëm. Lidhjet me fibra optike lidhin Shqipërinë me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Ekzistojnë dy kompani të licensuara të shërbimit të telefonisë celulare: Albanian Mobile Communications (AMC) që u privatizua në korrik të vitit 2000 dhe Vodafon, që hyri në treg në vitin 2001. Shërbimi i Internetit nuk është ende i besueshëm dhe kostoja e zotërimit dhe përdorimit të një telefoni celular është shumë e lartë sipas standardeve Evropiane. Disa thirrje ndërkombëtare transmetohen përmes radiove me mikrovalë nga Tirana me Italinë dhe Greqinë.

SHËRBIMET BAZË: Infrastruktura ekzistuese është e mbingarkuar. Investimet në shërbimet bazë dhe infrastrukturën urbane kanë qenë shumë të ulta gjatë periudhës së tranzicionit dhe mirëmbajtja dhe menaxhimi kanë qenë, po ashtu, të dobëta. Kjo ka çuar në një dobësim të infrastrukturës ekzistuese dhe nuk u është përgjigjur nevojave të popullsisë të vendosura në zonat pa shërbime.

pamjaftueshëm dhe në zonat rurale shpesh nuk ekziston. Pjesa më e madhe e 50 ndërmarrjeve shqiptare të ujit subvencionohen nga shteti dhe ofrojnë shërbim të pamjaftueshëm, qeveria vendosi së fundi të ndryshojë kufizimin në tarifat, që vendosin ndërmarrjet e ujit. Ka tre fabrika të ujit të pijshëm. Më shumë se gjysma e rasteve me diarre transmetohen nëpërmjet ujit, që tregon se tubat e ujërave të zeza rrjedhin dhe përzihen me tubat e ujit. Ujërat e zeza të papërpunuara derdhen direkt në mjedis dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme e sistemeve të ujërave të zeza sjell bllokime të shpeshta dhe daljen sipër. Strategjia Kombëtare e Ujit e hartuar në vitin 1996 nuk është miratuar akoma.

63% e Shqiptarëve i kanë në pronësi shtëpitë e tyre dhe shumë prej tyre jetojnë në të njëtën shtëpi si përpara vitit 1992. 95% e shtëpive janë me pronësi private dhe 25% e familjeve jetojnë në apartamente që u privatizuan në vitin 1992. 8% e Shqiptarëve që jetojnë në shtëpitë e tyre jetojnë në zona me më pak se 10.000 banorë. Mesatarisht, banesat shqiptare kanë 2 dhoma me një hapësirë banimi prej 62m² ose 14.6 m²

Infrastruktura bazë sipas cilësisë: e dobët dhe e mirë[134]

	Urbane		Rurale		Total	
	E dobët	E mirë	E dobët	E mirë	E dobët	E mirë
Pa ujë të rrjedhshëm	24.5	23.4	31.4	34.7	29.9	29.6
Pa tualet	22.5	16.4	87.2	76.2	72.3	49.4
Dhoma për person	0.4	0.6	0.6	0.8	0.6	0.7
Distanca e shërbimeve						
-- Shkolla	10.1	10.2	13.1	13.9	13.0	11.7
-- Puna	19.6	18.6	21.4	20.9	20.4	20.6
-- Kujdesi Shëndetësor	18.6	19.1	22.5	23.3	22.3	20.7

Gati gjysma e Tiranës nuk ka fare lidhje, ose ka lidhje plotësisht të papërshtatshme në shërbimet bazë.

96.7% e popullsisë kishte ujin e pijshëm në vitin 2000,[135] por një vrojtim tjetër zbuloi se shumë burime uji janë të prekur nga nivele të larta bakteresh. Rreth 1/3 e familjeve nuk kanë ujë të rrjedhshëm dhe më shumë familje të tjera kanë ujë të rrjedhshëm vetëm për disa orë në ditë. Veçanërisht në zonat urbane, shumë familje blejnë depozita uji/rezervuare, në mënyrë që të kenë ujë kur ndërpritet furnizimi, por edhe ato varen nga pompat elektrike. Dezinfektimi i furnizimit me ujë është i për person.[136] Banesat e qyteteve janë ndërtuar me standarde të dobëta ndërtimi dhe mbipopullimi është i zakonshëm. Ka një mungesë serioze banesash (sipas një vlerësimi të bërë Shqipëria ka 11.000 familje të pastreha). Investimi publik ka lejuar ndërtimin e rreth 20.000 hyrjeve të reja, që prej vitit 1993.

6.2.2 ANALIZË

ENERGJIA: Rrjedhat e ujit janë burimi kryesor i energjisë në Shqipëri, duke e bërë Shqipërinë shumë të varur nga kushtet e motit (nivele të duhura të reshjeve të shiut dhe të rezervuarëve). Në një ditë të zakonshme, hidrocentralet e brendshme

[133] Libri i Informacionit Botëror 2001: Shqipëria. CIA. 2001. http://www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/al.html
[134] Rezultate të Anketës të Nivelit të Jetesës (LCS) Tetor 1998, Instat, Korrik 2001.
[135] Përfshin ujërat e kanalizuar, rubinetat, puset e hapur ose me tuba, puset e mbyllura, burimet dhe ujërat e shirave të mbrojtura. MICS, Instat, 2000.
[136] Po aty

prodhojnë 5-8 milion kWh/ditë. I kombinuar me 1.4 milion të prodhuar nga termocentralet, prodhimi total qëndron shumë larg nevojës për energji në periudhën e dimrit (rreth 16-27 Milion kWh/ditë). Por kosto e lartë e importimit të energjisë nuk është arsyeja kryesore e mungesës së energjisë në dimër; infrastruktura e Shqipërisë e lidhur me vende të tjera mund të transmetojë një maksimum prej 5 Milion kWh/ditë. Kufizimi në kapacitetin teknik nënkupton se oferta e brendshme dhe ajo e huaj në periudhën e dimrit arrin një maksimum prej 10-14 Milion kWh/ditë, vetëm 40-50% të kërkesës totale në këtë periudhë.[137]

Të gjitha vendet e Ballkanit po hasin vështirësi në sektorin energjitik. Krizat dhe destabiliteti politik e kanë mbajtur investimin publik në infrastrukturën e re energjetike shumë poshtë niveleve të duhura për të arritur shpejt kërkesën në rritje. Në Shqipëri një pjesë e madhe e konsumatorëve të energjisë nuk i paguajnë faturat e tyre, kështu që rritja e çmimeve të energjisë prek kryesisht konsumatorët që paguajnë dhe që janë të përqendruar në Tiranë. Qeveria ka deklaruar se norma e pagimit ishte rreth 58% në vitin 2001, 20% më pak se në objektivin e strategjisë së energjisë dhe politikanët nuk kanë dashur të vendosin masa të ashpra ndaj konsumatorëve mos-pagues. Nuk mund të pritet që sektori privat në Shqipëri të investojë derisa ai të jetë në gjendje për të mbuluar kostot dhe të realizojë fitim.

Monopoli shtetëror i KESH-it mbi furnizimin me energji, i integruar vertikalisht, nuk lidhet me tregun e lirë privat për gaz dhe të tjera burime energjie. Subvencionimi afat-gjatë i çmimeve të energjisë përgjatë viteve ka rritur artificialisht kërkesën përmes mbajtjes së çmimeve të energjisë nën koston e energjisë së prodhuar nga burime të tjera. Kjo gjë ka bërë që konsumatorët dhe investorët të mos u drejtohen burimeve të tjera. Keqinterpretimi i çmimit duhet të ndryshohet pa e kaluar barrën në zonat rurale dhe tek të varfërit, si pjesë e një politike qeveritare, për të nxitur dhe zhvilluar seriozisht burimet alternative.

TRANSPORTI: Ndonëse janë bërë investimeve të reja në transport, pjesa më e madhe e rrjetit rrugor të Shqipërisë prej 16.000 km ka nevojë të madhe për rehabilitim dhe përmirësim, në mënyrë që të lehtësojë trafikun në rritje. Përparësi u është dhënë rrugëve kryesore lindje-perëndim dhe veri-jug, por korridori lindor kërkon më shumë vëmendje. Donatorët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos tolerojnë korrupsionin në zbatimin e projekteve të rrugëve, të cilat shpeshherë vuajnë vonesat dhe rritjen e çmimeve dhe duhet të luftojnë për të fituar angazhim dhe

Projektet aktuale të rrugëve kanë marrë statusin "Quick Start" si përparësi të Paktit të Stabilitetit, të tilla si:

- **Segmenti 32 km i rrugës veri-jug nga Lushnja në Fier**
- **Segmenti 35 km nga Fieri në Vlorë**
- **Segmenti 24 km i rrugës lindje-perëndim nga Tepelena në Gjirokastër**
- **Segmenti 13 km nga Elbasani në Librazhd**
- **Riparimet urgjente dhe përmirësimi i asfaltimit në një gjatësi prej 221 km të rrugës nga Durrësi në Kukës, që lidhet me Kosovën**

7 synime në rrugën drejt një shoqërie informacioni

1. Të vendosen rrjete telekomunikacioni dhe kompjuteri;
2. Të përqendrohet vëmendja në aksesin e grupit dhe jo pronësinë individuale;
3. Krijimi i aftësive njerëzore;
4. Të hidhen pikëpamjet lokale, lajmet dhe kultura në rrjetin e internetit;
5. Të përshtatet teknologjia ndaj nevojave dhe kufizimeve lokale;
6. Të përcaktohet shfrytëzimi i internetit për nevoja të ndryshme; dhe
7. Të gjehen rrugë të reja për të financuar projekte komunikimi.

Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2001, UNDP.

përfshirje nga komunitetet lokale. Komunitetet janë pjesëmarrës të rëndësishëm, përderisa rrugët e këqija ose jo ekzistuese dytësore dhe terciale shpesh pengojnë banorët ruralë të transportojnë produktet e tyre dhe t'i shesin ato në tregun më të mirë. Aftësia konkurruese e sektorit bujqësor, që është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, është në rrezik.

TELEKOMUNIKACIONI: Shërbimet e telekomunikimit, në fillim të vitit 1990, nuk ishin në gjendje të plotësonin kërkesën në rritje. Sistemet e kabllove ishin të vjetra dhe në fillimet e periudhës së tranzicionit disa banorë i shkulën telat nga rreth 1,000 fshatra për të ndërtuar gardhet e tyre, kështu që jo të gjithë fshatrat kanë një lidhje telefonike. Telefonat celularë po bëhen shumë popullorë, por çmimi i tyre mbetet i lartë, mbase për shkak të konkurrencës së pamjaftueshme në sektor. Mund të jetë e vlefshme dhënia e licensave konkurruesve të rinj dhe nxitja e investimeve të mëtejshme në sistemet e telekomunikimit shqiptar.

[137] Profili i Investimeve 2001: Shqipëria, EBRD, 2001. http://www.ebrd.com/english/pubs/profiles/alba.pdf

SHËRBIMET BAZË: Migrimi i shpejtë drejt qendrave urbane po rrit numrin e njerëzve që nuk përdorin shërbimet bazë. Decentralizimi ka fuqinë për ta përmirësuar këtë sektor. Nivelet e tarifave dhe shkalla e mbledhjes është e ulët dhe shumë ndërtesa kanë lidhje të paligjshme me furnizimin me ujë, kështu që ndërmarrjet e ujit kanë të ardhura të ulta që të mbulojnë shpenzimet operative, por që nuk lejojnë investime në rritjen e kapaciteteve. Më tepër kujdes duhet t'i kushtohet rregullimit të sektorit dhe rritjes së të ardhurave të ndërmarrjes së ujrave për të lejuar investimet. Për shkak të mungesës së matjeve, shumë konsumatorë paguajnë një normë fikse për konsumin e ujit, kështu ata nuk kanë stimuj për të kursyer dhe kufizuar përdorimin e ujit. Kjo sjell një kërkesë më të lartë të ujit se ç'është e nevojshme. Dezinfektimi i ujit me nitrat hipoklorati dhe kalcium ka nevojë për më shumë vëmendje. Shumë sisteme të klorifikimit që përdoren kryhen me dorë dhe nuk garantojnë përdorimin e dozave të duhura. Investimet në zonat rurale do ishin më të mëdha, nëse do të përfundonin strategjitë për furnizimin e tyre me ujë dhe higjienën.

6.2.3 REKOMANDIME

Qëndrueshmëria e mjedisit dhe garantimi i shërbimeve për të varfërit duhet të jenë parimet udhëheqëse për politikat dhe investimet e infrastrukturës.

ENERGJIA

Plani Strategjik i Veprimit për sektorin e energjisë rekomandon 51 veprime specifike. Tre më të rëndësishmit janë:

- Të përmirësohen veprimet tregtare të sektorit energjitik duke ulur vjedhjet dhe përmirësuar lidhjet
- Liberalizimi i çmimeve të energjisë
- Të krijohet një organ energjitik i fortë dhe i pavarur për të zbatuar një politikë energjitike, që të balancojë interesat e kompanive pjesëmarrëse, në tregun energjitik dhe konsumatorëve.

Rekomandime të tjera kyçe përfshijnë:

- Ristrukturimin e KESH-it, duke ndarë prodhimin nga transmetimi dhe shpërndarja
- Përgatitjen e situatës për privatizimin e KESH-it.
- Përpunimin e një politike energjitike gjithëpërfshirëse
- Përmirësimin e sigurisë dhe besueshmërisë së elektricitetit
- Hartimin e tarifave që nxisin ruajtjen
- Modelimin e një tregu modern dhe konkurrencial energjitik
- Rritjen e kapaciteteve energjitike, duke tërhequr investime private strategjike
- Lidhjen e sistemit energjitik shqiptar në sistemin Ballkanik dhe Evropian

TRANSPORTI[138]

- Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese të transportit
- Sigurimi i një niveli më të përshtatshëm mirëmbajtjeje për rrjetin kryesor, dytësor dhe terciar të rrugëve
- Zhvillimi i linjave rajonale të transportit
- Vendosja e një rregulloreje legjislative dhe kuadri institucional
- Përmirësimi i sistemit të informimit të transportit dhe përmirësim i planifikimit dhe menaxhimit të sektorit
- Nxitja e përfshirjes së sektorit privat në zhvillimin e infrastrukturës së transportit;
- Rritja e mbulimit të kostos në sektorin e rrugëve dhe çmimeve përkatëse dhe politikave tatimore

TELEKOMUNIKACIONI

- Të liberalizohen më tej telekomunikimet, me qëllimin e uljes së çmimeve dhe rritjes së përdorimit, mundësisht duke licensuar një tjetër operator telekomunikimi dhe duke privatizuar linjat fikse telefonike.
- Në përgjithësi, privatizimi duhet të bëhet vetëm kur ekzistojnë struktura të mjaftueshme tregu dhe mbrojtëse për të ndaluar çmimet monopol. Privatizimi nuk është i frytshëm nëse pasoja është kalimi nga një monopol publik në një monopol të lirë privat.
- Të kërkohet zgjerimi i teknologjisë së informimit nëpër vend dhe në institucionet e biznesit dhe arsimimit.

SHËRBIMET BAZË

- Të shtrihen shërbimet bazë në zonat rurale
- Të përmirësohen rrjetet e shërbimeve bazë në zonat urbane dhe periferike për t'iu përshtatur nevojave të një popullsie të urbanizuar – të merret ligjërisht toka me shërbime dhe infrastrukturë të vendosura në një mjedis të pastër
- Të trajtohen nevojat e strehimit të të varfërve dhe grupeve të privuara
- Të merren masa për të siguruar furnizimin m me ujë të rregullt dhe të sigurtë, duke mbrojtur ujësjellësit nga infektime të tjera të ndotjeve të mjedisit
- Të ngrihen sisteme për të përpunuar dhe larguar ujërat e zeza me një dëmtim sa më të vogël të mjedisit
- Të përmirësohet qëndrueshmëria financiare e furnizuesve me ujë dhe përpunuese të ujërave të zeza
- Të rehabilitohen sistemet ekzistuese të ujërave të zeza
- Të decentralizohen investimet dhe menaxhimi i furnizimit me ujë
- Të nxiten investimet private për sigurimin e shërbimeve bazë, në mënyrë që të zgjerohet shfrytëzimi pa i ngarkuar të varfrit me çmime që nuk mund t'i përballojnë.

[138] PIP 2000-2003; GPRS, Nëntor 2001.

7 Siguria Personale

Konventa dhe Konferenca të Rëndësishme të Kombeve të Bashkuara

- Konventa Ndërkombëtare kundër Torturës
- Konventa për Ndalimin e Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike
- Konventa Kundër Krimit të Organizuar
- Konferenca mbi Armët e Vogla dhe Armatimet e Lehta, 2001

Vrojtimi i bërë prej Zërave të Rinj me fëmijë të moshës 9-13 vjeç tregoi se: Ndërkohë që pjesa më e madhe e fëmijëve thonë se ndihen të sigurtë (65%) në lagjen e tyre, 31% ndjehen gati të pasigurtë ose të pasigurtë fare. 11% e fëmijëve thonë se kanë qenë viktima të dhunës (kryesisht dhunës fizike). 35% e familjeve raportojnë se ndaj 1 apo më shumë anëtarëve të familjes është kryer krim, gjatë vitit të kaluar. 9% e familjeve kanë përjetuar një krim të dhunshëm, 11% janë vjedhur dhe 5% kanë vuajtur nga vandalizmi.[139] Prania e armëve në familjet shqiptare është një faktor destabilizues, që ndihmon kërcënimet ndaj Sigurisë Personale.

BURIMET E RREZIKUT KUNDER SIGURISE PERSONALE

- Shteti: Amnesty International[140] dhe Human Rights Watch[141] kanë raportuar fakte abuzimesh nga policia. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë pezulloi dënimin me vdekje në vitin 1999 për të ruajtur anëtarësinë e saj në Këshillin e Evropës.
- Shtetet e tjera: Shqipëria nuk ka qenë në luftë që nga Lufta e Dytë Botërore dhe shtetet e tjera nuk mendohet se përbëjnë kërcënim.
- Grupe etnike të tjera: Shqiptarët etnikë në vendet fqinje kanë qenë në luftë disa herë në vitet e fundit, por në kufi ka patur vetëm refugjatë dhe jo konflikte.
- Individë apo grupe të tjera: Kjo përfshin krimin e rregullt, dhunën në rrugë, krimin e organizuar dhe krimet e lidhura me drogën.
- Familje të tjera/klane: Ky është një shqetësim serioz në disa komunitete si Shkodra, ku zbatohen gjakmarrjet dhe një kod i ringjallur, i njohur si Kanuni, në vend të institucioneve qeveritare që zgjidhin konfliktet. 2.750 familje në vitin 2001 ishin vetë-ngujuar dhe 900 fëmijë nuk ndiqnin shkollën si pasojë e frikës së hakmarrjes.[142]
- Fatkeqësitë aksidentale ose vdekja: Kjo përfshin rreziqe si fatkeqësitë në vendin e punës, territori i minuar përgjatë kufirit me Kosovën (22 njerëz në vitin 2001 u vranë dhe 222 u plagosën nga minat tokësore[143]) dhe aksidentet e trafikut.
- Abuzimi i grave dhe fëmijëve: Këto grupe të dobëta, shpeshherë, shfrytëzohen për qëllime trafikimi dhe prostitucioni.
- Vetja: Kjo përfshin vetëvrasjet dhe abuzimet e drogës.

Pasiguria, privimi dhe përjashtimi social mund të çojnë në frikë, ankth dhe dëshpërim, që mund të nxisin dëshirën për t'u armatosur apo për të ushtruar dhunë me armë. Kërcënimi dhe ushtrimi i dhunës me armë mund të dobësojnë zhvillimin social, ekonomik dhe politik. Programet që nxisin sigurinë dhe zhvillimin njerëzor, të tilla si programi i UNDP në dorëzimin e armëve në Gramsh,[144] mund të ndihmojnë për daljen prej rrethi vicioz.

7.1 Krimi i Organizuar

9.1.1 VLERËSIM

Ndërkohë që Ministria e Rendit Publik pranon ekzistencën e krimit të organizuar në Shqipëri, ajo nuk pranon konsolidimin e tij të plotë dhe

[139] Vlerësim Cilësor i Varfërisë në 10 Rrethe të Shqipërisë, Banka Botërore dhe QSES, 2001. http://www.minfin.gov.al/initiatives/gprs/documents/qualitative/qa.html
[140] http://web.amnesty.org/ai.nsf/countries/albania
[141] http://hrw.org/reports/world/albania-pubs.php
[142] Raporte Vendore mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut - 2001:Shqiperia, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara Mars 2002. http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2001/eur/8219pf.htm
[143] Po aty
[144] Komunikim direkt me UNDP Shqipëri, 2002.

influencën mbi politikë dhe media. Krimi i organizuar njihet si një forcë destabilizuese dhe pakësimi i tij konsiderohet përparësi. Qeveria premtoi në vitin 2001 se do bënte më shumë për të luftuar krimin e organizuar dhe kontrabandën përmes trajnimit më të mirë të hetuesve dhe policisë, dënimeve penale më të rrepta dhe përmirësimit të bashkërendimit kombëtar duke krijuar një Zyrë të Luftës kundër Krimit të Organizuar. Ligji i vitit 2000 për Ndalimin e Pastrimit të Parasë, i kërkuar nga Ministria e Financave, po zbatohet shumë ngadalë.

Policia u ka sekuestruar me qindra armë shqiptarëve, kosovarëve, maqedonasve dhe kroatëve të përfshirë në trafikun e paligjshëm të armëve, në gjysmën e parë të vitit 2001. Kjo tregti është ringjallur si pasojë e konflikteve në Kosovë dhe Maqedoni. Gjatë së njëjtës periudhë, policia raportoi 25 krime të konsideruar terroriste, shumica sulme kundër policisë kriminale.

Shqipëria është një vend origjine për disa droga, për shembull, shqiptarët janë të përfshirë në kultivimin dhe prodhimin e Kanabis Sativa. Shqipëria është një vend destinacion i drogave, përfshirë heroinën dhe kokainën dhe, gjithashtu, është një vend tranzit i drogave në rrugën e tyre për Itali apo Greqi, kokaina nga Shtetet e Bashkuara dhe heroina nga Turqia. Sasia e drogës së konfiskuar (e ulët), luhatet përderisa mobilizimi është sporadik dhe ka shtytje të përkohshme me nxitjen e anëtarëve me influencë të komunitetit ndërkombëtar. Statistikat e konfiskimit ulin në mënyrë drastike sasinë e drogës së përdorur dhe të transportuar përmes Shqipërisë. Krimet e lidhura me drogën mbulohen nga dispozitat e Kodit Penal. Në vitin 2001 Shqipëria ishte vendi i fundit në Evropë, që merrte pjesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1961 dhe 1988 "Për Parandalimin e Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotropike". Shqipëria pritet, gjithashtu, të bëhet pjesë e Konventës së vitit 1971.

Në vitin 1998, u krijua Shërbimi Qendror për Luftën kundër Drogës, me zyrë qendrore pranë Ministrisë së Rendit Publik dhe 12 zyra rajonale. Rreth 90 nga 100 vendet për policë dhe agjentë sekretë janë plotësuar, por zyrave u mungojnë pajisjet dhe punonjësve, trajnimi profesional. Në vitin 2001 Parlamenti miratoi ligjin për Parandalimin e Trafikut Ilegal të Narkotikëve në Shqipëri dhe për Krijimin e Komitetit të Brendshëm Ministror për Kontrollin e Drogës.

7.1.2 ANALIZË

Veçanërisht 2 kriza kontribuan në rritjen e aktivitetit të kriminalitetit të zakonshëm dhe të organizuar, kryesisht në Shkodër, Vlorë dhe Tropojë. Ato ishin: vjedhja e kallashnikovëve, bombave dhe armëve të rënda nga depot e armëve gjatë vitit 1997, çrregullimi që ndoqi rënien e firmave piramidale, shmangia e policisë nga detyrat e zakonshme gjatë fluksit të refugjatëve të vitit 1999. Policia ka vendosur rendin publik pas çdo krize, po disa pjesë të Shqipërisë Veriore mbeten akoma jashtë kontrollit efektiv të policisë. Bandat kriminale kanë përfituar nga paqëndrueshmëria rajonale dhe krizat politike të brendshme, për të forcuar kontrollin e tyre në Shqipëri.

Fenomeni i drogës u shfaq në Shqipëri relativisht kohët e fundit, si pasojë e hapjes së kufijve dhe privatizimit të pronësisë e biznesit dhe u nxit nga faktorë si varfëria dhe legjislacioni jo i plotë. Ligji i 2001-it për Ndalimin e Trafikimit të Paligjshëm të Narkotikëve ka masa shumë të rënda, por ka probleme zbatimi si rrjedhojë e kushteve të vështira dhe trajnimit profesional të pamjaftueshëm të forcave të policisë. Faktorë të tjerë që nxisin tregtinë e drogës përfshijnë lëvizjen e lirë të njerëzve përgjatë kufijve, pas fundit të izolimit të Shqipërisë, në fillim të viteve 1990, një klimë e përshtatshme për kultivimin e marihuanës, varfëria, veçanërisht në zonat rurale dhe një pozicion gjeografik përgjatë një rruge të rëndësishme tregtie.

Nuk ka një strategji kombëtare për luftën kundër drogës, por kuadri ligjor është gati i përfunduar - mungojnë vetëm aktet nënligjore, që lejojnë zbatimin e ligjit për trafikimin e paligjshëm të narkotikëve. Kultivimi është bërë një burim të ardhurash i rëndësishëm në zonat fshatare dhe UNDCP raporton se Kanabis rritet në çdo zonë të vendit. Ndërkohë që është një përparësi e Qeverisë për të luftuar drogën dhe krimin në përgjithësi; ka nevoja për pajisje, trajnime, shkëmbim të informacionit dhe bashkëpunim më të mirë.

Ndërkohë që policia shqiptare bashkëpunon me organet bregdetare italiane për të kontrolluar trafikun përgjatë Adriatikut, ekziston një mungesë bashkëpunimi midis agjencive kombëtare. Për shembull, policia kufitare, rrugore dhe e krimit të organizuar duhet, por nuk bashkëpunojnë për luftimin e trafikimit ilegal të qenieve njerëzore. Këto polici së bashku me prokurorinë dhe gjykatat duhet të bashkëpunojnë në luftën kundër drogës.

7.1.3 REKOMANDIME

- Të përmirësohet bashkëpunimi midis Ministrisë së Rendit Publik dhe Prokurorisë.
- Të ecet përpara drejt koherencës dhe unifikimit të procedurave policore administra-

Drejtimet dhe Konfiskimet e Drogës[145]		
	2000	2001
Kanabis Sativa e çrrënjosur	256,857 bimë	281,730 bimë 129 të ndaluar
Papavër Somniferum e çrrënjosur	120 bimë	
Laboratorë Përpunimi të shkatërruar	5	3
Heroinë e konfiskuar	51 kg	4 kg 526 gram. 69 të ndaluar
Kokainë e konfiskuar	4 kg	266 gram 3 të ndaluar
Metadon i konfiskuar	0.48 litra	1,320 litra 1 i ndaluar
Vaj Hashashi i konfiskuar	3 litra	
Marihuana e konfiskuar	7 ton	7 ton 117 të ndaluar
Papavër farë i konfiskuar		2 kg 828 gram
Kanabis farë i konfiskuar		600 gram
Para në dorë të konfiskuara		1.1 milion USD
Krime të kultivimit, shpërndarjes dhe trafikimit të drogës	519	325 gjatë 2001
Vende kryesore për kultivim	Vlora, Fieri, Lushnja, Kavaja, Elbasani	
Burimi i heroinës	Turqia përmes Bullgarisë dhe Maqedonisë, duke kaluar doganat e Qafë-Thanës, Bllatës dhe Tushemishtit.	
Destinacioni i heroinës	Italia, përmes porteve të Vlorës, Durrësit dhe Sarandës.	
Burimi i kokainës	ShBA dhe në disa raste nga Hungaria, duke kaluar doganën në Aeroportin e Rinasit dhe nga vende të tjera, nëpërmjet porteve	
Destinacioni i kokainës	Fluturimet për në Gjermani dhe vendet Nordike	

tive dhe operacionale, si dhe Parimeve të Etikës Policore duke përshtatur modelet legjislative Euro-Atlantike.

- Të vihet theksi te zbatimi i Konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve për të luftuar krimin që Shqipëria i ka nënshkruar tashmë, të ndjekura nga pjesëmarrja aktive në iniciativat e reja.
- Të bëhen përpjekje për të rritur nivelin e besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve të rendit publik.
- Të përmirësohet koordinimi i strukturave ndërministrore lidhur me krimin e organizuar.
- Të sillet në nivel lokal lufta kundër krimit të organizuar.

ULJA E OFERTES SË DROGËS[146]

- Përhapja në shkallë kombëtare e kultivimit të drogës, trafikimit dhe konsumit, tregojnë se ka nevojë për vullnet politik dhe kapacitete më të mëdha. Kjo kërkon: a) vullnetin e elementeve politikë të bëjnë një përpjekje të bashkërenduar dhe të ofrojnë burimet e nevojshme, si dhe vullnetin e forcave të policisë për të parë në brendësi dhe të distancohen nga elementët e përfshirë në bandat e lidhura me drogën dhe në korrupsion. b) Komuniteti ndërkombëtar duhet të mbështesë, në veçanti, policinë kriminale dhe Njësitë e Anti-Drogës me trajnim dhe paisje profesionale.
- Duhet shkëmbyer informacion midis agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare të përfshira në hetimin dhe kontrollin e trafikimit të paligjshëm të njerëzve, drogës dhe kontrabandave të tjera.
- Zyrtarët juridikë dhe të zbatimit të ligjit duhet të bashkëpunojnë, në mënyrë që të arrestojnë kriminelët e t'i ndjekin me gjykime dhe ndëshkime.
- Programi i Akademisë së Policisë duhet rishikuar për të përgatitur oficerë që të merren me problemin e drogës.

7.2 Trafikimi dhe Kontrabanda me Njerëzit

7.2.1 PËRKUFIZIM

Përdorimi në shqip i së njëjtës fjalë për trafikimin dhe kontrabandën vazhdon të thellojë problemet, të cilat duhen trajtuar në mënyra të ndryshme, sepse kanë shkaqe të ndryshme. Dallimi u bë për herë të parë në të drejtën Ndërkombëtare në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërmjet Shteteve dhe dy Protokolleve të saj, nënshkruar në Palermo në Shtator 2000, në të cilën bën pjesë dhe Shqipëria. Përkufizimi i trafikimit është dhënë në nenin 3/a në Protokollin për Parandalimin, Kontrollin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht Grave dhe Fëmijëve. Përkufizimi i kontrabandës

[145] Komunikim direkt me UNDP, Shqipëri, 2002.
[146] Për më shumë statistika dhe politika të drogës dhe krimit, shih http://www.undcp.org

Përkufizimet e Protokollit të Milanos 2000

Trafikimi i personave
Rekrutimi, transporti, lëvizja, mbajtja apo pritja e refugjatëve nëpërmjet frikës apo përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngesës, të marrjes peng, të mashtrimit, të shpërdorimit të pushtetit ose një pozite dobësie apo të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të patur përkrahjen që një person të ketë kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi.

Kontrabanda e emigrantëve
Sigurimi, direkt apo indirekt, i një financimi apo përfitimeve të tjera, prej hyrjes ilegale të një personi në një Shtet, në të cilin personi s'është shtetas ose banor i përhershëm.

është dhënë në nenin 3/a të Protokollit kundër Kontrabandës së emigrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Ajrit. Sipas Protokolleve të përmendura, ndryshimi midis trafikimit dhe kontrabandës është si më poshtë:

(a) Kontrabanda përfshin një marrëdhënie klienti/shërbimi midis kontrabandistëve dhe subjekteve të kontrabandës (zakonisht të quajtur si emigrantë të paligjshëm ose klandestinë), të cilët dëshirojnë të kalojnë kufirin, ndërkohë që

(b) trafikimi përfshin një marrëdhënie pronësie/ zotërimi, ku trafikanti ka fuqinë e blerjes, shitjes dhe abuzimit të qenieve njerëzore të trafikuara ilegalisht nëpërmjet forcës sikur ai apo ajo të ishin mall.

Rastet e identifikuara të trafikimit dhe kontrabandës (Nëntor 2000-2001)[147]

	Nr. i rasteve	Nr. i arresti-meve	Nr. i padive	Bandat kriminale të identifikuara/ kapura	Viktimat e ndaluara/ arrnët e sekuestruara
Fëmijë	3		4		5
Rastet e grave për 2000, IOM/ICMC	117	181	13 banda kriminale për ndjekje penale		117 (43 të huaja, 15% ishin minorene)
Kontrabanda e migrantëve të paligjshëm	73	145		13	69 pasagjerë & 9 mjete transporti
Makina	8		72		112 makina të bllokuara
Armë	18	29		3	Raketa & snajper

7.2.2 VLERËSIM

Shqipëria është një vend burimi dhe tranziti për trafikimin dhe kontrabandën e njerëzve. Viktimat e trafikimit, zakonisht fëmijë dhe gra, vijnë kryesisht nga Shqipëria, Moldavia, Rumania, Ukraina, Rusia, Bullgaria, Kosova, Kina dhe Kurdistani. Shumë prej tyre janë të destinuar për në Itali, Greqi dhe Evropën Perëndimore. Prirja ka patur një rënie të vogël në viktimat nga Shqipëria dhe disa viktima të mëparshme po kthehen në Shqipëri. Sidoqoftë, ka patur një rritje në rekrutimin e grave të huaja, kryesisht moldave dhe rumune. Individët e kontrabanduar, zakonisht, hyjnë në Shqipëri përmes Maqedonisë, Greqisë, Malit të Zi ose Aeroportit të Rinasit. Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2001 policia ndaloi 2.172 persona, kryesisht kurdë.[148] Nuk ekzistojnë vlerësime të besueshme për numrin e emigrantëve të paligjshëm në vit apo totalin e atyre që aktualisht jetojnë jashtë. Ministria e Rendit Publik vlerëson se 4.000 të rinj shqiptarë të moshës 0-18 vjeç janë trafikuar midis viteve 1992-2000. Vlerësimet nga OJQ-të shqiptare për numrin e grave dhe fëmijëve të trafikuar që punojnë në Itali dhe Greqi janë shumë më të larta.

Ministria e Rendit Publik ka në juridiksion trafikimin dhe kontrabandën. Shumë prej përpjekjeve të policisë janë të drejtuara në ndalimin e emigrantëve të paligjshëm përgjatë kufirit dhe kthimit në vendin e tyre të origjinës, si dhe patrullimin e vijës bregdetare, për sekuestrimin e skafeve të përdorura në kontrabandën dhe trafikimin e individëve.

Ministria e Rendit Publik ndihmoi në krijimin e Qendrës së Anti –Trafikimit të Vlorës, në Tetor 2001, me mbështetje ndërkombëtare për luftimin e kontrabandës së klandestinëve/migrantëve të paligjshëm dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo qendër akoma nuk është plotësisht vepruese. Punonjësit e qendrës kanë të ardhura të larta dhe e ardhmja e qendrës është e pasigurtë, përderisa objektivat e saj janë të paqarta dhe vazhdimësia e saj do të varet nga efekti që do të ketë. Shqipëria është anëtare e inisiativës së Paktit të Stabilitetit kundër Krimit të Organizuar (SPOC) dhe, mbas shumë presioneve, ka miratuar një strategji Anti Trafikimi në 2001-in. Në Dhjetor 2001, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje për luftimin e trafikimit dhe kontrabandës me 8 vendet e tjera të Ballkanit, anëtare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Kjo marrëveshje merret me vendosjen e politikës së Asociimit të Vendeve të Evropës Juglindore, riatdhesimin e klandestinëve/ migrantëve ilegalë, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin në hetimet kriminale.

7.2.3 ANALIZË

Trafikimi dhe kontrabanda janë probleme kriminale, ekonomike, sociale dhe gjinore. Kontrabanda është kryesisht një problem për vendin e mbërritjes, i cili do që të largojë klandestinët, migrantët ilegalë. Trafikimi është një problem për vetë viktimat (ato janë në rrezik të bien në grackë dhe të dhunohen), por gjithashtu për të gjitha vendet e burimit, tranzit dhe të synuar,

[147] Komunikim Direkt me Ministrinë e Rendit Publik, 2001
[148] UNDCP Raport gjysëm vjetor, 2001.

sepse trafikimi lidhet gjithashtu me armët dhe drogën dhe rrit rrezikun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (STI) si HIV/SIDA.

Në përgjithësi, Mediave dhe Qeverisë i mungojnë profesionalizmi në lidhje me trafikimin, sikurse e tregon botimi në vitin 2001 i vendit ku u ngrit një strehë për gratë, duke krijuar për gratë që u vendosen aty rrezikun e dhunimit. Media, gjithashtu, priret të kontribuojë në diskriminimin dhe klasifikimin e grave të përfshira në trafikim dhe tenton të vendosë lidhje midis klientit të trafikantëve dhe policisë në një mënyrë të përgjithshme, pa prova për raste konkrete, duke i bërë njerëzit të besojnë se fenomeni është i pandalshëm. Është shumë pozitiv fakti se, ekziston një strategji dhe strukturë e Qeverisë për problemin e trafikimit dhe që, Qeveria është bërë më e hapur ndaj OJQ-ve, veçanërisht kur ato shfaqen me oferta më shumë se me kërkesa.

Shpesh kontrabandisti nxitet nga të njëjtët faktorë sikurse migrantët e rregullt të jashtëm dhe të brendshëm, duke përfshirë një dëshirë apo nevojë për të përfituar nga të mirat ose mundësitë më të mira në një vend tjetër. Shih seksionin e Migrimit. Kontrabandistët motivohen nga fitimi që ata mund të nxjerrin duke siguruar shërbim tranzit.

Trafikimi shpesh nxitet nga fitimi prej shfrytëzimit seksual të viktimave ose nga ndonjë lloji tjetër shfrytëzimi. Zakonisht një shok ose i dashur, që është i lidhur me krimin e organizuar, merr vajzat, shpesh me premtimin e martesës me lejen e prindërve, ose duke përdorur forma të tjera mashtrimi sikurse oferta e një pune jashtë. Prostitucioni është i paligjshëm në Shqipëri, por si për shumë krime të tjera është e rëndësishme që të dallohen njerëzit që vullnetarisht zgjedhin prostitucionin për arsye ekonomike dhe ata që detyrohen me forcë. Shumë prej vajzave janë të detyruara, por disa prej tyre zgjedhin prostitucionin për arsye ekonomike me përshtypjen e gabuar, sipas së cilës ato mund të shkojnë vetë e të punojnë për 6 muaj ose 1 vit e pastaj të kthehen me para. Pavarësisht nëse vendimi fillestar është vullnetar apo jo, përfundimi në përgjithësi është i njëjtë për gratë dhe vajzat. Prostitutat ndiqen shumë më shpesh se trafikantët, tutorët e ndërmjetësit, duke treguar se ka nevojë për një ndryshim në mentalitet, ka përfshirje të mundshme të disa zyrtarëve në trafikim dhe se ka nevojë për zbatimin e ligjit nga policia dhe gjykatat.

Trafikimi i minorenëve, zakonisht, nxitet nga mundësia e fitimit nga pedofilia/shfrytëzimi seksual i fëmijëve. Veçanërisht vajzat minorene janë shumë fitmprurëse. Shumë fëmijë trafikohen dhe detyrohen të bëhen lypësa ose skllevër, ndërsa të tjerë përdoren për trafikimin e organeve, por për këtë nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme. Viktimat më të zakonshme janë fëmijët e familjeve të divorcuara, fëmijët me kujdes të paktë familiar, fëmijët që vijnë nga familje me shumë fëmijë, fëmijët nga familjet e varfëra, fëmijët e lindur jashtë martese, fëmijët që jetojnë në fshatra, fëmijët të cilët mbeten vetëm kur prindërit e tyre emigrojnë për punë, fëmijët që kanë lënë shkollën, fëmijët që kanë qenë lypësa dhe fëmijët që kanë kryer aktivitete të tjera të paligjshme në Shqipëri.

Ministria e Rendit Publik ka një Strategji Kombëtare për Trafikimin, që do të përfundojë në shtator 2004 dhe pjesërisht përfshin fëmijët, duke synuar ndalimin e trafikimit të fëmijëve dhe mundësimin e riintegrimit të tyre në shoqëri. Strategjia përmban ndjekjen e rreptë të trafikantëve, zhvillimin e mundësive të punësimit dhe biznesit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, rritjen e ndërgjegjies publike, ofrimin e ndihmës mjekësore e psikologjike dhe krijimin e qendrave të rehabilitimit. Dënimet për trafikimin e fëmijëve, luhaten nga 10 vjet burgim deri në burgim të përjetshëm nëse fëmija vdes.

Aktiviteti trafikues dhe kontrabandues, shpesh, përdor skafe të shpejta për të kaluar Adriatikun dhe për të arritur në Itali, pa u diktuar dhe e shmangin kontrollin e doganës të të dy vendeve. Dokumentimi i pamjaftueshëm, gjithashtu ndihmon trafikimin dhe kontrabandën. Trafiku punon në rrjet me njëri tjetrin, në kërkim të viktimave të reja për të trafikuar. Trafikantët dhe ata që veprojnë si pronarë të viktimave, shpesh përdorin sistemet e tyre gjë që e bën të vështirë dhe të rrezikshëm largimin e viktimave nga shfrytëzimi i tyre. Ata gjithashtu mbështeten në dëmtimin fizik e psikologjik dhe ushtrojnë presion duke krijuar kushte skllavërie.

Politika perëndimore e refuzimit të hyrjes së shqiptarëve dhe evropianëve lindorë ka sjellë shumë kritika, pasi ky kontroll i rreptë i pikave të kufirit rrit kërkesën për shërbime kontrabandë dhe për krim të organizuar. Sapo krijohen këto grupe të krimit të organizuar, ato shpesh përparojnë nga kontrabanda e njerëzve te kontrabanda e drogës, e armëve dhe trafikimit të njerëzve për plotësimin e kërkesës së madhe në industrinë e seksit në vendet e Evropës Perëndimore. Në këtë mënyrë, kufijtë e mbyllur nxisin disa njerëz të shkojnë drejt kontrabandës, që nxit në mënyrë indirekte fenomenin e trafikimit.

Shqipëria nuk u është përmbajtur premtimeve të saj dhe kërkesës së vendeve fqinje për luftimin serioz të trafikimit. Janë ndërmarrë disa hapa, por Qeveria vazhdon të mos i mbajë zotimet për reduktimin e trafikimit, të ndihmojë viktimat dhe të heqë zyrtarët e përfshirë në korrupsion.

Strategjia e Shqipërisë e vitit 2001 për trafikimin e qenieve njerëzore ka përcaktuar këto pika të dobëta: mangësitë në kontrollin kufitar, trajnim i pamjaftueshëm i prokurorëve dhe policisë, prania e disa zyrtarëve të korruptuar, mungesa e qendrave për vendosjen e viktimave të huaja dhe shqiptare, mjete të pamjaftueshme teknike për luftimin efektiv të trafikimit, domosdoshmëria e përmirësimit të kuadrit ligjor të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe procedurave penale, si dhe edukim e ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i publikut për rreziqet e trafikimit.

Trafikimi dhe kontrabanda po tërheqin më shumë vëmendje në programin politik, por nuk ekziston një aftësi korresponduese profesionale për të vepruar. Strategjia e Shqipërisë kërkon kryerjen e studimeve më 2002, zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve, nxitjen e ndërgjegjësimit publik, krijimin e fushatave edukative me synim gratë dhe fëmijët, hartimin e programeve për përmirësimin e kushteve sociale të grave dhe vajzave, shërbimet e riatdhesimit dhe rehabilitimit për viktimat, trajnimin e zyrtarëve të ligjit dhe rendit publik dhe krijimin e sigurimin e një njësie të specializuar për zbatimin e ligjit. Ekziston një interes i fortë përsa i përket trafikimit prej Shqipërisë dhe OJQ-ve ndërkombëtare së bashku, por aftësia e tyre është e vogël.

7.2.4 REKOMANDIME

- Shumë programe duhet të jenë më tepër me baza rajonale sesa për gjithë vendin.
- Kombet e Bashkuara duhet të nxisin vendet pritëse, mundësisht nën Bashkimin Evropian ose Paktin e Stabilitetit, të marrin masat për mbrojtjen e fëmijëve që trafikohen që të mos dëbohen, sipas linjave të Udhëzimeve të UNHCR[149]për Riatdhesimin e Minorenëve.
- Qeveria duhet të bëjë më shumë për mbrojtjen e viktimave të kthyera dhe t'i drejtojë ato në shërbimet ekzistuese të siguruara nga IOM[150] dhe Komisioni Ndërkombëtar Katolik i Migrimit [151] (ICMC).
- Përpjekjet qeveritare, ndërqeveritare dhe të OJQ-ve duhet të bashkërendohen për mënjanimin e dyzimeve dhe të punojnë në zonat e tyre ku kanë më shumë forcë. Për shembull, OJQ-të mund të sigurojnë një strehim më të mirë sesa një postë policie, si rrjedhojë e problemeve të gjinive, maskilizmit dhe aftësive të dobëta personale të policisë. Në të ardhmen, aftësitë e policisë mund të zhvillohen, kështu ato mund të kryejnë mirë role të tilla.
- Komuniteti ndërkombëtar mund të mbështesë përpjekjet për ndjekjen e qarqeve të trafikimit, përmes sigurimit të mundësive të dëshmitarëve, sepse mbrojtja e dëshmitarit është joreale në një vend të vogël si Shqipëria.
- Sistemi i Kombeve të Bashkuara mund të mbështesë programe për zvogëlimin e përbuzjes shoqërore me të cilën përballen prostitutat pavarësisht nga shkaku, të nxisë ndërgjegjësimin për rrugët e migrimit në mënyrë ligjore dhe zgjerimin e mundësive, të ofrojë asistencë teknike për agjencitë që bëjnë kërkime dhe luftojnë trafikimin dhe kontrabandën, të nxisë aktivisht një zbatim efektiv të legjislacionit ndërkombëtar në sigurimin e mbrojtjes në raste të tilla, të nxisë një dallim të qartë në Qeveri dhe te aktorët e tjerë midis konceptit të kontrabandës e trafikimit dhe mjeteve për luftimin e tyre, të dobësojë trafikimin përmes shpërndarjes më të mirë të informacionit për rrezikun e të qenit i trafikuar.
- Kombet e Bashkuara dhe partnerët duhet të vazhdojnë nxitjen e iniciativave për të siguruar mbrojtje dhe azil, trajtim, vendbanim e rehabilitim të viktimave dhe t'i japin çdo viktime individuale shërbimet përkatëse. Viktimat e trafikuara duhet të konsiderohen si njerëz të cilëve u janë shkelur të drejta themelore, mbrojtja e tyre duhet të konsiderohet jo si asistencë, por si mbrojtje e të drejtave të tyre.
- Në përgjithësi, grupet e prekshme të grave dhe fëmijëve të identifikuar mund të përfitojnë nga arsimimi, fuqizimi dhe mjete të tjera për përmirësimin e situatës së tyre.
- Duhen përdorur më mirë specialistët lokalë ekzistues dhe OJQ-të lokale të kërkojnë më shumë mbështetje dhe formim aftësish.
- Kombet e Bashkuara duhet të nxisin OJQ-të lokale të synojnë për të qenë aktive në terren nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të tyre, ndërkohë të garantojnë që standardet minimale për strehimin dhe shërbimet të kuptohen mirë dhe të respektohen nga këto OJQ.

7.3 Shtimi i Armëve të Vogla

7.3.1 VLERËSIM

Mundësia e gjerë për gjetjen dhe përdorimin e armëve të vogla e armatimeve të lehta në Shqipëri i ka rrënjët në trazirat e Mars - Prillit të vitit 1977, që nisën nga rënia e skemave piramidale, ku shumë shqiptarë kishin investuar të gjitha kursimet e tyre.

[149] http://www.unhcr.ch/
[150] http://www.iom.int/
[151] http://www.icmc.net

Trazirat civile, që drejtoheshin kundër qeverisë dhe institucioneve shtetërore, arritën kulmin në vjedhjen masive të depove ushtarake, instalimeve, armëve dhe municioneve. Burimet e qeverisë shqiptare raportuan rreth 550.000 armë të vjedhura, së bashku me 20.000 tonë eksploziv dhe 1.5 miliardë fishekë dhe predha artilerie. Amnisty International raportoi në vitin 1998 se, u vranë përafërsisht 1.600 njerëz. Gjatë kësaj kohe, Qeveria humbi kontrollin mbi pjesën më të madhe të vendit dhe mbizotëroi krimi, pasiguria dhe kaosi.

Pas fundit të krizës në mes të vitit 1997, që çoi në zgjedhjet e përgjithshme, qeveria shpalli amnistinë për ata, të cilët i kthyen armët për të nisur trajtimin e problemit të shtetasve të pajisur me armë të rënda. Disa pushkë dhe municione u gjetën, megjithatë shifrat mbetën në nivel të ulët në krahasim me numrin e pushkëve të humbura, duke përbërë zyrtarisht vetëm 10% të totalit në fund të vitit 1997. Mungesa e ligjit dhe e rendit në disa pjesë të territorit kontribuoi në trafikimin e paligjshëm të armëve jashtë Shqipërisë, të paktën në periudhën menjëherë pas krizës.

Më 7 shkurt të vitit 1998, Qeveria kërkoi zyrtarisht ndihmën e Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë një shtytje të re dorëzimit vullnetar të armëve dhe për të përfituar nga përvoja e Kombeve të Bashkuara me çarmatimin e vendeve të tjera. Në qershor të vitit 1998, një mision i udhëhequr nga Nën-Sekretari i Përgjithshëm për çështjet e çarmatimit, vizitoi Shqipërinë dhe rekomandoi lidhjen e programeve të mbledhjes së armëve me stimujt për zhvillim të komuniteteve përfituese në tërësi, që çoi në projektin pilot të Gramshit (GPP).

Në gusht të vitit 1998, Qeveria e Shqipërisë miratoi një ligj të ri të përgjithshëm "Mbi mbledhjen e armëve dhe municioneve ushtarake", për të caktuar tipat e armëve të lejuara për pronësi private nga civilët, së bashku me masat e përcaktuara qartë kundër shpërdorimit të tyre. Ajo vendosi një fazë 2-vjeçare vullnetare për dorëzimin e armëve, që u shtri deri në gusht të vitit 2002, e ndjekur nga një fazë e mëvonshme e detyrueshme. Në shkurt të vitit 2000, qeveria paraqiti një Program Kombëtar mbi Kontrollin e Armëve (WCP), në përgjigje të suksesit që pati GPP.

Autoritetet shqiptare kanë trajtuar, gjithashtu, problemin e shkatërrimit të armëve. Në shtator të vitit 2000, në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi midis qeverisë Gjermane, Norvegjisë dhe Shteteve të Bashkuara, duke specifikuar përgjegjësitë për shkatërrimin e armëve në Shqipëri. Qeveria e arriti synimin e shkatërrimit të 100.000 armëve nga programi i saj i mbledhjes, në Shtator të vitit 2001. Në vitin 2002, Forcat e Armatosura kryen gjithashtu shkatërrimin e mbi më shumë se 1,600,000 minave anti-person.

Arritjet në grumbullimin e armëve dhe municioneve pasqyrojnë përpjekjet e mëdha kombëtare të bëra deri tani. Vlerësohet se janë mbledhur mbi 1/3 e armëve dhe se më pak se 1/3 janë nxjerrë kontrabandë jashtë vendit, që prej vitit 1997. Sidoqoftë, prania e vazhdueshme në duart e civilëve e rreth 1/3 të armëve të humbura, në vitin 1997, përbën një kërcënim të drejtëpërdrejtë ndaj rendit publik dhe sigurisë së njeriut. Kjo është një sfidë që duhet trajtuar tani, përderisa zbatimi i Ligjit mbi Amnistinë do të përfundojë në Gusht të vitit 2002 dhe mbajtja e armëve pas afatit të përcaktuar do të konsiderohet një krim.

7.3.2 ANALIZË

Megjithëse armët nuk i shkaktojnë konfliktet në të cilat ato përdoren, përhapja dhe gjetja e lehtë e tyre përkeqëson shkallën e dhunës, duke rritur vdekshmërine e zgjatjen e konflikteve dhe duke nxitur dhunën e jo zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Kultura që vjen si pasojë e dhunës, pengon ndërtimin e paqes dhe rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale, në shoqërinë e pas-luftës. Pa çarmatimin e duhur – që përfshin mbledhjen e armëve të vogla të mbetura dhe ruajtjen e armëve në pronësi të shtetit në zonat e mbrojtura – programi për rehabilitimin dhe zhvillimin kombëtar nuk mund të ketë mbështetje.

Për Shqipërinë, zotërimi i paligjshëm i një numri të konsiderueshëm armësh ende në duart e shtetasve, është një nga pengesat kryesore për objektivin e qeverisë në vendosjen e rendit publik, përderisa është një faktor domethënës në përkeqësimin e sigurisë së njeriut dhe marrëdhënieve sociale; ai pengon rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale, përderisa vendi nuk është në gjendje të tërheqë fondet e jashtme të nevojshme. Ky fakt, i ndërthurur me praninë e krimit të organizuar e trafikimin dhe korrupsionin e përhapur, rrit kërcënimet dhe krijon një nevojë të dukshme për Shqipërinë dhe partnerët e saj për të trajtuar probleme të tilla.

Asistenca e ofruar nga sistemi i Kombeve të Bashkuara lidhur me armatimet e lehta ka krijuar një rol dhe ka fituar forcë në kuadrin e sfidave të zhvillimit të Shqipërisë si dhe harmonizohet me përparësitë aktuale të sigurisë rajonale dhe të Shqipërisë. Kombet e Bashkuara kanë fituar një eksperiencë në trajtimin e armatimeve të lehta, si pjesë e operacioneve të paqes dhe nëpërmjet hetimeve të tyre, mbi blerjen e paligjshme të armëve. Në Deklaratën e Mijevjeçarit të Kombeve

të Bashkuara, miratuar në Samitin e Mijëvjeçarit (6-8 shtator, 2000) në Nju Jork, Shtetet Anëtare vendosën të "ndërmerrnin veprime të bashkërenduara për t'i dhënë fund trafikut të paligjshëm të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, sidomos duke i bërë transfertat më transparente dhe duke mbështetur masat mbi çarmatimin rajonal, duke marrë parasysh të gjitha rekomandimet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë e Paligjshme të Armëve të Vogla dhe Armatimeve të Lehta".

Të autorizuara nga Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 50/70 B dhe 52/38 J për të trajtuar problemin e armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, Kombet e Bashkuara kanë caktuar 5 objektiva mbështetës që janë të zbatueshëm në kuadrin e Shqipërisë:

- Të vijojnë përfshirjen e problemit të armëve të vogla në një program botëror, duke dalë si katalizator dhe agjenci informacioni të iniciativave të ndryshme;
- Të mbajnë një rol koordinues për kanalizimin e shqetësimit të rritur ndërkombëtar rreth armëve të vogla drejt objektivave realistë dhe të arritshëm;
- Të nxisin përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile në krijimin e qëndresës institucionale ndaj përdorimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta;
- Të fuqizojnë aftësinë e Kombeve të Bashkuara për t'iu përgjigjur me shpejtësi dhe efektivitet kërkesave për ndihmë nga zonat e prekura nga armatimet e lehta dhe trafiku i paligjshëm i tyre;
- Të sigurojnë që objektivat e mësipërm ndiqen brenda kuadrit të objektivave të Kombeve të Bashkuara në fushën e çarmatimit.

7.3.3 REKOMANDIME

(Marrë nga Seminari Rajonal mbi Sigurinë e Njeriut dhe Kontrollin e Armëve në Vendet e Evropës Juglindore, i Organizuar nga UNDP, Shqipëri 4-5 Prill, 2002).

KONTROLLI DHE ULJA E NUMRIT TË ARMËVE

- Është e nevojshme që të mblidhen dhe shkatërrohen armët e paligjshme dhe të kontrollohet zotërimi e lëvizja e armëve. Ulja e numrit të armëve dhe kontrolli i tyre duhet të ndiqen paralelisht. Nëse dikush vetëm sa i mbledh armët pa kontrolluar burimet e tyre, kjo nuk do të krijojë përfitime të qëndrueshme dhe afatgjata. Në këtë mënyrë, është shumë e rëndësishme që prodhimi i armëve në rajon të zvogëlohet dhe të mbikqyret në mënyrë të rreptë. Vendosja e një moratoriumi në prodhimin e armëve është një strategji, që duhet parë me kujdes.
- Qeveritë duhet të rishikojnë ligjin për zotërimin, lëvizjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit për të parë nëse duhet legjislacion i ri që të vendoset një kontroll më efektiv i armëve.
- Ato duhet, gjithashtu, të rishikojnë agjencitë e tyre për të parë nëse nevojiten reforma apo organe të tjera për një kontroll efektiv të armëve. Për shembull, ekziston nevoja për një regjistër kombëtar elektronik të armëve të ligjshme që mbahen nga personat privatë dhe një nevojë për menaxhim të sigurtë dhe transparent të rezervave shtetërore.
- Për të zbatuar kontrollin mbi armët, qeveria duhet të rrisë e nxisë trajnimin dhe pajisjen me aparatura të zyrtarëve të zbatimit të ligjit.
- Media, Shoqëria Civile dhe mbarë popullsia duhet të ofrojnë mbështetje të madhe ndaj qeverive në përpjekjet e tyre për kontrollin e armëve.

RUAJTJA E RENDIT PUBLIK, RESPEKTIMI I LIGJIT DHE ZGJIDHJA PAQËSORE E KONFLIKTEVE

- Një nivel i përshtatshëm i rendit publik është i rëndësishëm për kontrollin e armëve dhe sigurinë njerëzore. Kjo është një përgjegjësi e qeverisë, në mënyrë specifike detyrë e forcave të policisë, të mbështetura nga zyrtarët e kontrollit kufitar dhe personelit tjetër të zbatimit të ligjit.
- Masat për nxitjen e një qeverisjeje, transparence dhe përgjegjësie të mirë, do të rrisin sigurinë e njeriut dhe kontrollin e armëve, pasi sigurojnë qytetarët e bindur ndaj ligjit se mbrojtja e tyre është e sigurt dhe ndalon thyerjen e ligjit mbi armët nga të tjerët.
- Organet e zgjedhura përfaqësuese janë forumi më i mirë për zgjidhjen paqësore të konflikteve politike. Masat për nxitjen e efektivitetit të tyre do të jenë në interes të sigurisë së njeriut dhe të kontrollit të armëve.
- Një sistem gjyqësor i drejtë, i pavarur dhe efektiv është rruga më e mirë për zgjidhjen e konflikteve private dhe të përbashkëta dhe luan një rol kyç në parandalimin e zotërimit të ligjit nga individë.
- Zbatimi i ndëshkimeve ligjore duhet të bëhet sipas ligjit dhe të jetë i drejtë e njerëzor, por i rreptë.

FORMIMI I AFTËSIVE

- Masat dhe iniciativat e propozuara këtu u kërkojnë qeverive dhe shoqërisë civile që të luajnë një rol më aktiv dhe efektiv në nxitjen e

kontrollit të armëve dhe të sigurisë së njeriut. Në shumë raste, atyre do t'u duhet të përmirësojnë dhe zgjerojnë aftësitë e tyre për përballimin e këtyre problemeve. Qeveritë duhet të bëjnë ligje, të krijojnë agjenci, të trajnojnë personelin, të blejnë pajisje dhe të marrin masa administrative për të qenë të aftë në kontrollin efektiv të armëve. Ndërsa shumica e vendeve të këtij rajoni kanë një kuadër ligjor dhe mekanizmat bazë administrative për këtë qëllim, efektiviteti i tyre pengohet nga mungesa e trajnimit, e pajisjeve dhe e fondeve. Kjo duhet përmirësuar.

- Po kështu, shoqëria civile duhet të rrisë kapacitetin e saj në përballimin e problemit të përhapjes së armëve dhe pasigurisë. Është e nevojshme të ndërmerren masat për të fuqizuar e trajnuar anëtarët e organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesit e medias, për t`i trajtuar këto probleme në një mënyrë më të informuar dhe efektive.
- Komuniteti ndërkombëtar duhet të mbështesë aktivisht përpjekjet për një formim të tillë të aftësive në Qeveri dhe Shoqërinë Civile duke siguruar nxitje, ekspertizë dhe financim, por përfituesit potencialë duhet të përcaktojnë qartë përparësitë dhe nevojat e tyre.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Shërbimet e përbashkëta: Vendet e rajonit duhet të përpiqen të shfrytëzojnë së bashku shërbimet si qendra për shkatërrimin e armëve të tepërta, qendrat e trajnimit etj.
- Shkëmbimi i informacionit: Është i nevojshëm një studim i mëtejshëm për problemet e armëve dhe pasigurisë, i cili duhet të ndërmerret në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Institucionet rajonale të informimit do të shërbejnë si një forum për shkëmbim informacioni dhe ekspertize, prandaj duhen përdorur aktivisht.
- Bashkërendimi: Është e vështirë, por e dëshirueshme për vendet e rajonit që të përpiqen të harmonizojnë ligjet e tyre dhe zbatimin e politikave në zonat e kontrollit të armëve. Kjo do të ndihmojë në ndalimin e kontrabandistëve dhe terroristëve për shfrytëzimin e një vendi si strehë të sigurtë për aktivitetet kriminale në vende të tjera të rajonit.

7.4 Sistemi i strehimit te emigrantëve

7.4.1 PËRKUFIZIM

Konventa e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve e përkufizon një refugjat si "një person, i cili, i shtyrë nga frika e persekutimit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie me një grup të veçantë shoqëror ose bindjeje politike, është jashtë vendit të tij ose të saj dhe nuk është i aftë ose nuk dëshiron të gjejë mbrojtje nga ai vend". Ligji i Shqiptar i Strehimit pranon të njëjtin përkufizim. Në të njëjtën kohë krijoi dy kategori të tjera për azilin: Mbrojtje të Përkohshme për arsye humanitare dhe Mbrojtje të Përkohshme në Rastet e Flukseve Masive. Me kalimin e viteve, disa Rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme, të autorizuara nga komuniteti ndërkombëtar, i kërkuan Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, të merrej me personat që janë jashtë vendit të tyre të origjinës nga shkaku i persekutimit, konflikteve me armë, ose dhunës së përgjithësuar që i detyrojnë të largohen.

Sipas Nenit 12 të Ligjit mbi Strehimin, refugjatët në Shqipëri gëzojnë statusin ligjor të miratuar në CSR të vitit 1951 dhe protokollin e vitit 1967, të gjitha të drejtat në marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë bën pjesë, si dhe të drejtat për të huajt në përgjithësi të pranuara nga legjislacioni shqiptar. Personat që marrin Mbrojtje të Përkohshme, gëzojnë të drejta të njëjta si refugjatët, përveç dokumentit të udhëtimit në rastet e atyre që merren në mbrojtje për arsye humanitare. Për ata që hyjnë te flukset masive, të drejtat e tyre mund të kufizohen sipas shqetësimeve publike të ligjshme për një periudhë maksimale prej tre vitesh.

7.4.2 VLERËSIM

Strehimi i refugjatëve u bë realitet në vendin tonë për herë të parë gjatë krizave të Kosovës të viteve 1998 dhe 1999, kur rreth 465.000 kosovarë u strehuan në Shqipëri, shumë nga të cilët janë kthyer me kohë. Prej fillimit të vitit 2002, rreth 300 refugjatë janë të regjistruar dhe 40 persona që kërkuan strehim mbetën në Shqipëri. Shumë nga ata janë Kosovarë, por janë edhe rreth 50 shqiptarë të Maqedonisë dhe një numër i vogël irakenësh, turqish dhe kurdësh nga Turqia si dhe nga kombësi të tjera. Përbërja demografike e popullsisë refugjate korrespondon me përfshirjen normale 50% femra.

Në përgjigje të rrjedhës së emigrantëve përmes Shqipërisë, UNHCR përpunoi zgjidhjen Trishkallëshe për të trajtuar pjesët përbërëse të fenomenit të emigrimit të çrregullt. Metoda Trishkallëshe e Vlerësimit, sikurse është pranuar nga Zyra e UNHCR, Tiranë, e sheh migracionin e çrregullt nëpërmjet Shqipërisë me natyrë të ndërlikuar – ekzistojnë 3 sisteme

Sistemi Para-monitorues

Shërbimet referuese dhe shërbimet pritëse për kërkuesit e azilit janë bazat për funksionimin e sistemit të azilit. Sistemi Para-monitorues është në marrëdhënie të ngushtë me metodën tre dimensionale. Pas lajmërimit nga policia në rastin e kapjes se të huajve për hyrje ilegale në Shqipëri, skuadra mbikqyrëse (e përbërë nga Zyra Shqiptare për Refugjatët, UNHCR ose ICMC/ IOM për trafikimin e femrave), i merr në pyetje dhe i vendos të huajt para sistemit të së drejtës: (duke përfshirë këtu femrat e trafikuara) që me dëshirën e tyre duan të kthehen në vendin e lindjes, ndihmohen nga IOM/ICMC; personat që kërkojnë azil këshillohen nga Zyra e Refugjatëve për të filluar proçedurat e azilit; të tjerët janë subjekt i proçedurave normale ligjore për të huajt që hyjnë në vend në mënyrë të paligjshme

të pavarura ndonëse të ndërthurura për personat që janë pjesë e fluksit të paligjshëm: persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare (kërkues azili/refugjatë), emigrantë ekonomikë dhe persona të trafikuar për prostitucion. Secila kategori e këtyre personave duhet të shfrytëzojë sistemin e duhur të referimit, i cili ka për qëllim arritjen e zgjidhjeve të qëndrueshme, duke përfshirë kthimin në origjinë apo integrimin lokal atyre të cilëve iu takon në përputhje me ligjin Shqiptar dhe atë Ndërkombëtar. Qeveria miratoi zbatimin e një sistemi të agjencive të brendshme para-monitoruese (shih pasqyrën), duke përdorur metodën trishkallëshe. Situata e refugjatëve në Shqipëri nuk është problematike në numër, por shkalla e përputhjes me standardet ndërkombëtare të strehimit, mund të jetë një tregues i vlefshëm i respektimit të të drejtave të njeriut.

Të drejtat e refugjatëve në Shqipëri respektohen përgjithësisht, edhe pse është më e vështirë që këto të drejta të respektohen nga refugjatët Shqiptarë jo etnikë. Në thelb, Qeveria e Shqipërisë është e përgjegjshme për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj refugjatëve. Si një vend që ndesh vështirësi vetjake ekonomike të konsiderueshme, ekziston një mungesë burimesh dhe kapaciteti administrativ, që bën të nevojshëm ndërhyrjen e UNHCR. Për të përmbushur këtë boshllëk të rëndësishëm, dy OJQ lokale përgatitën një projekt mbi Integrimin lokal të Personave që janë Strehuar në Shqipëri, i cili u mbështet nga Grupi i Punës (shih më poshtë). Mbas miratimit nga Ministria e

Një nga sfidat kryesore lidhur me strehimin në Shqipëri është krijimi i mundësive për integrimin lokal të personave që marrin të drejtën e strehimit.

Drejtësisë dhe nga Ministria e Financës, vendimi pritet që të miratohet nga Këshilli i Ministrave në vitin 2002. Ky vendim plotëson më tej strukturën ligjore të strehimit, duke siguruar të drejtat e personave që marrin strehim, si të drejtën për arsim dhe për punë, asistencë sociale, kujdesin për shëndetin dhe banesë.

7.4.3 ANALIZË

Qeveria e Shqipërisë është e përgjegjshme për mbrojtjen dhe asistencën ndaj refugjatëve, ndërsa UNHCR këshillon dhe kontrollon zbatimin nga vendi të parimeve të mbrojtjes ndërkombëtare dhe monitoron procedurën e përcaktimit të Statusit të Refugjatit. Megjithatë, përsa u përket të drejtave dhe përfitimeve të refugjatëve, siç njihen nga Ligji Shqiptar, mbetet shumë për të bërë që këto të drejta të bëhen reale për refugjatët në Shqipëri. Në një vend që ka probleme ekonomike të konsiderueshme, mungesa e burimeve dhe kapacitetit administrativ e bën të nevojshëm ndërhyrjen e UNHCR-s dhe të partnerëve.

Qeveria shpalli zyrtarisht futjen e sistemit të strehimit si një nga përparësitë e saj në proçesin e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian. Pas ndryshimeve në qeveri, Këshilli i Ministrave krijoi në tetor 2001 një Grup Pune të shumëpritur për zbatimin e Sistemit të Strehimit. Ky organ përfshin përfaqësuesit e shtatë ministrive, UNHCR, tre OJQ të specializuara dhe tre organizatorë ndërkombëtarë si vëzhgues. Objektivi i tij është i dyfishtë: përmirësimi i kuadrit ligjor të strehimit dhe përmirësimi i kapacitetit institucional dhe i aftësive, sidomos nëpërmjet trajnimit të autoriteteve të Shtetit, që u takon zbatimi i legjislacionit të strehimit. Puna e këtij Grupi drejtohet nga Plani i Veprimit Kombëtar të Strehimit, duke u bazuar në Analizimin e të metave të bërë në periudhën 1999-2000. Ky plan u hartua nga UNHCR-ja në bashkëpunim me qeverinë dhe u mbështet nga ky Grup. Pritet që Grupi i Punës të përfshihet në Migrimin SP dhe Iniciativën e Strehimit, sapo të nisë punën në Shqipëri.

Vëmendja ndërkombëtare lidhur me problemet e strehimit në Shqipëri po rritet gjithmonë e më shumë. Disa iniciativa ndërkombëtare kanë një ndikim direkt në zhvillimin dhe në zbatimin e një kuadri për strehimin dhe emigrimin në Shqipëri, duke

përfshirë ndërmjet të tjerëve Proçesin e Stabilitetit dhe Asociimit, Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, Grupin e Punës të Nivelit të Lartë të Bashkimit Evropian mbi Azilin dhe Migrimin, si dhe grupin Miqtë e Shqipërisë. Këto iniciativa ndërkombëtare ndihmojnë në vendosjen e standardeve në fushën e strehimit dhe ndihmojnë Qeverinë e Shqipërisë në përmbushjen e tyre.

7.4.4 REKOMANDIME

- UNHCR, Qeveria e Shqipërisë, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare duhet të zbatojnë plotësisht gjithë proçedurën para-monitoruese, me qëllim që t'u sigurojnë mbrojtje dhe asistencë kërkuesve të strehimit, personave të trafikuar dhe migrantëve me një qëndrim të përbashkët. Filtrimi duhet të shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke përfshirë pikat kufi.
- Legjislacioni i dytë, sidomos në vendet e integrimit lokal, ka nevojë te shqyrtohet nga Qeveria e Shqipërisë, në mënyrë që t'u lejojë refugjatëve respektimin e të drejtave të tyre humane dhe sociale.
- Zyrtarët Qeveritarë që hyjnë në kontakt me refugjatët dhe kërkuesit e strehimit (Zyra e Refugjatëve të MPLD - Ministria e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit, policia kufitare dhe e rendit publik, autoritetet lokale, zyrtarë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë) duhet që të kualifikohen për legjislacionin e strehimit dhe zbatimin e tij.
- Zyra për Refugjatët (MPLD) duhet të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e personave që kanë marrë strehim në Shqipëri. Për këtë qëllim, ajo duhet të ri-integrohet në strukturat e MPLD dhe stafi i saj duhet të përgatitet mirë për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe menaxhimin e pritjes për kërkuesit e strehimit.

8 Siguria Politike

Konventa të Rëndësishme të Kombeve të Bashkuara dhe Dokumente të Tjera

- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
- Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Kushtetuta e Shqipërisë, 1998

Siguria Politike do të thotë të mos ketë frikë prej shtypjes së shtetit dhe dhunimit të të drejtave kryesore të njeriut.[152] Kërcënimi është më i lartë në kohët e konfliktit dhe paqëndrueshmërisë politike, siç përjetoi Shqipëria së fundmi në vitet 1997-1998, tregues i gjendjes së dobët kronike të shtetit. Pasiguria mund të destabilizojë lehtësisht përmasat e tjera të Sigurisë Njerëzore.

Për të garantuar Siguri Politike më të sigurtë është e nevojshme të arrihet funksionimi i duhur i institucioneve dhe sektorëve të shumtë në shoqëri: njerëzit duhet të aftësohen të mbështeten në një Shërbim Civil dhe Administrim Publik kompetent dhe të pakorruptuar; njerëzit duhet të aftësohen të veprojnë mbi Qeverinë dhe çdo përgjegjës tjetër përmes procedurave efektive elektorale dhe juridike; njerëzit kanë nevojë të marrin informacion dhe mbështetje të pavarur përmes medias dhe shoqërisë civile, si një kundërpeshë ndaj pushtetit qeveritar, i cili është mjaft i decentralizuar për të qenë përgjegjës ndaj nevojave të tyre dhe atyre të komunitetit të tyre. Mbi të gjitha do ta ndihmonte sigurinë politike nxitja e një mjedisi politik bashkëveprues, sesa e një mjedisi politik konfliktual.

8.1 Korrupsioni

8.1.1 PËRKUFIZIM

Korrupsioni përfshihet në përkufizimin e krimit ekonomik të përdorur nga Departamenti i Krimit Ekonomik pranë Ministrisë së Rendit Publik. Në Shqipëri disa forma të korrupsionit konsiderohen si vepra penale, duke përfshirë trafikimin e influencës dhe ryshfetet aktive apo pasive të zyrtarëve publikë vendas. Është e nevojshme të dallohet niveli i ulët i korrupsionit (siç është ryshfeti për të shkurtuar kryerjen e një veprimi zyrtar), nga niveli i lartë i korrupsionit (i cili nxitet më tepër nga lakmia, sesa nga nevoja ekonomike dhe pasiguria), përderisa shkaqet dhe zgjidhjet ndryshojnë. Korrupsioni shfaqet në shumë forma

Masat e Ministrive dhe Institucioneve Qendrore Janar-Tetor[153]

Masat disiplinore	1075
- "vërejtje"	54
- "vërejtje me paralajmërim"	365
- "shkarkim nga detyra"	58
- "pushim nga puna"	282
- "ulje page"	119
- "transferim"	89
- "masa të tjera"	103
- "pezullimi të drejtës së ngritjes në detyrë"	5
Masat administrative (gjoba)	984
Numri i padive penale	109

përveç asaj të rryshfeteve, siç janë: vjedhja e pasurisë shtetërore, abuzimi në shërbime dhe abuzimi në procesin e tenderit për prokurimin publik dhe privatizimin.

8.1.2 VLERËSIM

Korrupsioni në Shqipëri është i dëmshëm për individët, dhe pengon zhvillimin e vendit.[154] Banka Botërore dëshmon se rezultatet e vrojtimeve empirike në rajon "japin një tablo tronditëse të korrupsionit në përgjithësi, që godet mirëqenien publike, rëndon veprimtarinë e sektorit privat dhe është thellësisht i institucionalizuar".[155] Një sërë vrojtimesh mbi korrupsionin e kanë transformuar dhe përqendruar debatin politik në përparësitë specifike të vendit, duke filluar me një

[152] Për të patur informacion mbi të drejat e njeriut në Ballkan, dërgo një e-mail në: balkanhr-subscribe@egroups.com ose vizito: http://www.greekhelsinki.gr
[153] Raport Ad Hoc, Nëntor 2001, ACMG
[154] Për një pasurim të informacionit mbi korrupsionin në Shqipëri shih: http://www.nobribes.org/rc _albania.htm
[155] Kufij të Rinj, Banka Botërore, 1998

vëzhgim[156], që nxjerr në pah korrupsionin e vazhdueshëm në gjykatë. Ky vëzhgim, gjithashtu, zbuloi se 53 % e firmave do të dëshironin të paguanin taksa më të larta, nëse korrupsioni do të eliminohej dhe vlerësoi koston e korrupsionit si të njëvlerëshme me 7 % të të ardhurave të firmave, që pranojnë të paguajnë ryshfete.

Vëzhgime: % e të intervistuarve që thanë se "pothuajse të gjithë" ose "shumica" e grupeve të mëposhtme janë të përfshirë në korrupsion[157]	
Nëpunësit e doganave	86.6
Nëpunësit e taksave	79.0
Mjekët	71.6
Juristët	70.6
Nëpunësit bashkiakë	69.1
Ministrat	67.8
Nëpunësit në Ministri	66.2
Nëpunësit e Administratës në sistemin e drejtësisë	63.0
Anëtarët e Parlamentit	61.8
Nëpunësit e policisë	56.4
Këshilltarët bashkiakë	55.2
Udhëheqësit e Partive politike	54.7
Hetuesit	52.7
Udhëheqësit politik lokalë	49.6
Profesorët dhe nëpunësit e Universiteteve	46.0
Biznesmenët	42.6
Bankierët	24.4
Përfaqësuesit e OJQ-ve	23.1
Gazetarët	18.8
Mësuesit	11.6

Pothuajse gjysma e firmave shqiptare të vëzhguara në një vrojtim[158] të mëvonshëm raportonin se zyrtarëve publikë u japin ryshfete për t'u shpëtuar taksave dhe rregullave. Një pjesë e vogël njoftuan se i blejnë vendimet e gjykatës dhe të komisioneve arbitrare, votat e parlamentit dhe dekretet e presidentit. Raporti e kategorizoi Shqipërinë si një vend me "shthurje shtetërore"[159] mesatare, (duke treguar përgjegjësi të pamjaftueshme[160]) dhe "Korrupsion Administrativ"[161] të lartë (që tregon aftësi të ulta[162]). Pasqyra e masave disiplinore dhe atyre të tjera të marra nga institucionet pushtetare qendrore dhe ministritë, tregojnë se veprimet janë marrë nga ministritë për të ndëshkuar shkelësit e njohur, përfshirë heqjen nga puna dhe padi penale.

Mbështetja e kuadrin ligjor dhe institucional bëjnë pjesë në veprimtarinë e organizatave, përfshirë Miqtë e Shqipërisë, KSHKK[163] dhe Sistemet Ndërkombëtare të Menaxhimit.

Siç tregon kjo pasqyrë, nga vrojtimi i vitit 2001, jo të gjithë sektorët e ekonomisë dhe degët e pushtetit janë perceptuar si të prekura në mënyrë të njëjtë nga korrupsioni. Një nga fushat më problematike është ajo e mjekësisë, ku shumica e shqiptarëve e dinë se duhet të paguajnë një pagesë jozyrtare për shërbimet, që janë zyrtarisht falas. Në disa poste të administratës publike, siç është kontrolli i doganave, ka qenë e zakonshme për një që kërkonte punë të paguajë punëmarrësin për postin e ri.

Jashtë Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Rumanisë dhe Jugosllavisë, që u vrojtuan në të njëjtin raport, të intervistuarit shqiptarë kishin nivelin më të lartë të: (a) presionit mbi shtetasit nga zyrtarët publikë për kërkimin e shpërblimeve, (b) tolerancës në parim për korrupsionin, (c) përfshirjes në praktika të korrupsionit dhe (d) pesimizmit për aftësinë e vendit të tyre në përballimin e korrupsionit, ende brenda pesimizmit të moderuar. Të intervistuarit shqiptarë kanë gjithashtu nivelin e dytë më të lartë të: (a) perceptimit të shtrirjes së korrupsionit mes nëpunësve të sektorit publik, (b) dëshirës për të shkelur vlerat e anti-korrupsionit në situata praktike, dhe (c) perceptimin se korrupsioni po bëhet një mjet efektiv në zgjidhjen e problemeve personale[164].

8.1.3 ANALIZE

Përveçse në Shqipëri, korrupsioni ekziston edhe në vende të tjera në tranzicion. Shkaqet direkte të korrupsionit janë dëshira për të përdorur pushtetin për përfitime dhe dëshira për të patur shërbime, që nuk gjenden lehtësisht. Burimet më të thella janë papunësia e lartë, ekonomia informale e zgjeruar, përqendrimi i pushtetit, toleranca e institucioneve ndërkombëtare, institucionet e dobëta (veçanërisht mbikëqyrëse, detyruese, juridike), një Shoqëri Civile dhe media e dobët,

[156] Raporti empirik i Shqipërisë, 1998, Banka Botërore & QShKE
[157] Indekset e Korrupsionit, Mars 2001. Një shembull përfaqësues kombëtar i 1001 Shqiptarëve mbi 18 vjeç, intervistim ballë për ballë, Shtator 2000-Shkurt 2001 http://www.seldi.net/seldi_e.htm
[158] Një vrojtim i Mjedisit të Biznesit dhe Funksionimit të Ndërmarrjeve në vitin 1999, në 22 vende nga Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, analizonte: Masat e Anti-Korrupsionit në Evropën Jug-Lindore-Rivlerësimin dhe përparësitë e reformave në vend. Shtator 2001. Pakti i Stabilitetit për Inisiativën e Anti-Korrupsionit (SPAI).
[159] Aftësia e njerëzve për të ndikuar në formulimin e politikave qeveritare në favor të tyre, përmes ryshfetit
[160] Aftësia e shtetasve për t`i bërë përgjegjës zyrtarët publikë në kthimin e preferencave të tyre në rezultate, nëpërmjet sistemit elektoral, ndarjes së pushtetit mes minoriteteve, përfshirjes në shoqërinë civile dhe vendim-marrjeve të decentralizuara.
[161] Shkalla në të cilën zbatimi i politikave ekzistuese është i ndikuar nga pagimi i ryshfeteve, zyrtarëve publikë
[162] Aftësia e qeverisë për t'u siguruar shtetasve shërbimet themelore sociale dhe rregulluese, kur mjetet e menaxhimit si buxheti, apo standardet etike profesionale, merren seriozisht
[163] Koalicioni Shqiptar kundër Korrupsionit http://www.acac.info/
[164] Po aty

Kuadri ligjor dhe institucional

- Korrupsioni politik konsiderohet një krim në Kodin Penal të vitit 1992, por ky përkufizim nuk ishte i përshtatshëm dhe efektiv. Kodi Penal, i rishikuar në vitin 1995, përmirësoi kuadrin ligjor për luftimin e korrupsionit me nene mbi nëpunësit publikë, drejtësinë, kontributet e shtetit, përfitimet nga interesi, tenderat publikë, ryshfetet dhe fushatat elektorale.
- Ligji i vitit 1995 mbi Deklarimin e pasurive të zotëruara nga zyrtarët e zgjedhur dhe disa drejtues e nëpunës civilë. Ky informacion akoma nuk është përdorur nga prokuroria.
- 1996 Kodi i Procedurës Penale
- 1996 Akti i Shërbimit Civil
- Kodi i Procedurave Administrative
- Ligji mbi Krimet Administrative
- 1998 Ligji mbi Buxhetin
- 1998 Strategjia qeveritare për Anti-Korrupsionin e rishikuar në vitin 2000, po rishikohet në vitin 2002
- 1998 Ligji mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës
- 1999 Ligji mbi Statusin e Nëpunësit Civil përfshin: punësimin transparent (për të ndaluar praktikat e pagimit për poste të ndryshme) dhe, ngritjen në detyrë të bazuar në vjetërsinë dhe meritat (që gjithashtu përmirëson sigurinë e punës, kushtet ku një nëpunës civil mund të shkarkohet ligjshmërisht dhe parimet e profesionalizmit).
- 2000 Ligji mbi Policinë Gjyqësore
- 2000 Ligji mbi Krijimin e Politikave Financiare
- 2000 Ligji mbi Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë
- 2001 Ligji mbi Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit
- 2001 Ligji mbi Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë
- Komisioni i Shërbimit Civil - nxit procedurat e punësimit dhe sigurinë e punës
- Inspektoriati Juridik i Këshillit të Lartë te Drejtësisë.
- Shqipëria ka ngritur shërbime të specializuara për anti-korrupsion, siç është sektori për krimin ekonomik dhe financiar pranë Ministrisë së Rendit Publik, i cili përfshin Njësinë e Luftës kundër Vjedhjes dhe Falsifikimit, Njësinë e Luftës kundër Krimeve Financiare dhe Pastrimit të Parave dhe Njësinë e Luftës kundër Korrupsionit. Sektori ka gjithashtu një zyrë rajonale në secilën nga 12 Drejtoritë e Policisë së Prefekturave.
- Komisioni Ndër-Ministror për Anti-Korrupsionin koordinon dhe përgatit Planin për Anti-Korrupsion
- ACMG, Grupi i Monitorimit të Anti-Korrupsionit, përbëhet nga nëpunës civilë të nivelit të lartë, të cilët monitorojnë zbatimin e Planit per Anti-Korrupsionin

opozitë joefektive ndaj qeverisë, kërcënimet dhe krim i organizuar, mungesë e stabilitetit dhe pasiguri e punës, paga të ulta të nëpunësve publikë dhe transparencë e ulët. Shkaqe themelore janë varfëria, sikurse dhe qendrimet publike dhe ndërgjegjësimi shoqëror. Marrë në kompleksitet, lufta efektive e korrupsionit, në afat të gjatë, do të kërkojë një qëndrim të gjithanshëm kundrejt zhvillimit bashkë me masat e synuara.

Megjithëse pushteti është duke u decentralizuar gradualisht në Shqipëri, pushteti mbetet shumë i përqendruar në nivel qendror dhe decentralizimi i pushtetit financiar, si një element përbërës i aftësisë së qeverive lokale për të zbatuar fuqitë e reja të saj, po ecën shumë ngadalë. Shqipëria disa herë njihet si një shoqëri farefisnore, përderisa njerëzit shpesh ndërveprojnë mbi baza të lidhjeve dhe marrëdhënieve personale, të karakterizuara nga besnikëria dhe varësia dhe jo të ndërtuara mbi baza të pastra të profesionalizmit dhe transparencës. Ndonëse sigurisht ka aspekte pozitive të kësaj karakteristike kulturore, ajo gjithashtu e bën më të vështirë reduktimin e korrupsionit. Korrupsioni është gjithashtu i vështirë për t'u hetuar, sepse është në interes të të korruptuarve, korruptuesit dhe ndërmjetësit, nëse ekziston, për ta mbajtur të fshehtë transaksionin.

Në kohën që jemi duke shkruar, korrupsioni është në qendër të debatit politik me shumë akuza të larta, dorëheqje dhe shkarkime. Sfida është gjetja e rrugëve të reja për lidhjen e rekomandimeve, që nxirren nga vrojtime dhe analiza empirike, me vullnetin politik për zbatimin e tyre. Tendenca e natyrshme është më tepër fokusimi i disa individëve, dhe jo trajtimi i dobësive sistematike, por kjo nuk ka të njëjtën thellësi ndikimi sikurse kryerja e ndryshimeve të duhura në politika dhe institucione, me mbështetjen publike të politikanëve të njohur.

Mendimet e qytetarëve janë pak të nderlikuara. Ata nuk e mendojnë veten si taksapagues me të drejtën ligjore për t'u interesuar për përdorimin e taksave të tyre. Kjo lidhet me tranzicionin e Shqipërisë nga një shoqëri me një kontroll të plotë shtetëror. Shumë njerëz janë të ndërgjegjshem ndaj korrupsionit dhe ankohen për të, por shumë nga po këta njerëz ndihmojnë në vazhdimësinë e tij, duke paguar ryshfete.

Në perspektivën afat-mesme, mund të shpresohet për përparim mbi korrupsionin, jo për fitore. Ka qëndrime të ndryshme:(a) Duke ulur pushtetin për t`u përfshirë në korrupsion (p.sh. masa për zvogëlimin e shkallës të pushtetit të shtetit, duke përfshirë hapësira, të tilla si: ndërhyrje shtetërore dhe subvencionime, pushtet i fshehtë i nëpunësit civil, tarifat doganore, kërkesat për licenca, monopolet qeveritare dhe pronësitë publike, transparencë e llogaridhënie, dhe decentralizim e delegim); (b) duke ulur motivimin ose nevojën për përfshirjen në korrupsion (përfshirë vlerat profesionale dhe etike, njohje e kostove sociale, frika e kostove/rreziqeve personale, nevoja financiare, aftësia për t'i rezistuar presionit/dhunës, siguria e punës etj).

8.1.4. REKOMANDIME[165]

- Të vazhdohet lëvizja drejt specializimeve të shumta, trajnimeve dhe bashkërendimit midis agjencive kundër korrupsionit.
- Të trajnohen nëpunësit civilë në prokurimet publike dhe të vazhdojë forcimi i Agjencisë së Prokurimit Publik
- Të forcohen standardet e revizionit, agjencitë dhe aftësitë e kontrollit
- Të krijohet një Shkollë e Administrimit Publik
- Të rëndësisë së parë janë iniciativat e ndërgjegjësimit, që inkurajojnë njerëzit për t'u bërë qytetarë aktivë jo pasivë.
- Ka vend për ndreqje, por kodi penal ekzistues është i mjaftueshëm. Më i rëndësishëm është inkurajimi i profesionistëve të përkushtuar dhe krijimi i vullnetit të fortë politik për të luftuar korrupsionin nga lart poshtë.
- Moment kritik për përparimin është një mirëkuptim i gjerë midis njerëzve të përfshirë dhe të interesuar në reduktimin e korrupsionit, me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, biznesit dhe qeverisë.
- Organe mbikqyrëse të besueshme dhe të pavarura janë të nevojshme për të monitoruar korrupsionin dhe për të patur një mbulim të medias. Në përgjithësi, ka nevojë për të ndërtuar mekanizma institucionalë për nxitjen e mediave agresive dhe të pavarura dhe, për të përfshirë një shoqëri civile të zhvilluar më mirë (shoqata biznesi, OJQ etj.) në hartimin e politikave.
- Ndjekja penale mund të lehtësohet nga një amendament, që u jep lehtësi njerëzve të përfshirë në korrupsion për të denoncuar veten dhe partnerët e tyre. Një tjetër mundësi është të quhet vepër penale edhe inkurajimi i dikujt për t'u korruptuar. Ndërhyrja nga Prokuroria është gjithashtu thelbësore.

Qeveria e Shqipërisë hartoi një **Matricë të Planit Anti Korrupsion** në vitin 2002. Ajo përmban 16 objektiva dhe masa specifike, me afate të përfundimit, institucione përgjegjëse, rezultate të pritura, rreziqet dhe tregues të suksesit.

Objektivat ndahen në këto kategori:

- Reforma Institucionale
  - Reforma e Shërbimit Civil
  - Kontrolli i Lartë i Shtetit
- Përmirësimi i Legjislacionit dhe konsolidimi i shtetit ligjor
  - Përmirësimi i Legislacionit
  - Reforma në polici
  - Reforma në Prokurorinë e Përgjithshme
- Menaxhimi i Financave Publike
  - Buxheti
  - Taksat
  - Doganat
- Nxitja e Transparencës dhe Integritetit në Operacionet e Biznesit
  - Privatizimi
- Informimi Publik
  - Nxitja e Inicitivave të Programit Anti-Korrupsion
  - Mbështetje e Transparencës

8.2 Fuqizimi i Institucioneve

8.2.1 VLERËSIM

INSTITUCIONET DEMOKRATIKE: Në Shqipëri duket se kanë një prirje në rënie të numrit të votuesve, derisa vetëm 55% e votuesve të regjistruar votuan aktualisht në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Në përputhje me Vlerësimin Cilësor të Varfërisë në vitin 2001, njerëzit në të gjitha vendet e marra në studim, përgjithësisht duan, por nuk besojnë se kanë një qeveri të aftë për të zgjidhur probleme dhe

[165] Disa nga këto rekomandime dhe të tjera mund të gjenden në: "Masat e korrupsionit në Evropën Juglindore - Rishikime të vendit dhe Përparësitë për Reforma", Iniciativa Antikorrupsion e Paktit të Stabilitetit.

për të krijuar mundësi. Një kombinim i faktorëve - prania e pamjaftueshme e qeverisë, menaxhimi i dobët i funksioneve të qeverisë, korrupsioni dhe një mungesë e besimit në aftësinë e zgjedhjeve, për të përmirësuar kushtet kanë sjellë në një nivel të ulët të besimit tek Qeveritë. Kjo përputhet me përceptimet e të rinjve, ku vetëm "58% e fëmijëve mendojnë se votimi është një rrugë shumë efektive për përmirësimin e gjërave në vendin e tyre"[166]. Shih seksionin mbi Fuqizimin e Gruas, Pasqyrën 17 Gratë e Zgjedhura në Pushtetin Lokal dhe Pasqyrën 18 Anëtarët e Parlamentit sipas Gjinisë për një diskutim të pjesëmarrjes së grave në sistemin elektoral dhe në parlament.

Profesionalizmi dhe transparenca e Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ) u konsiderua se ishte përmirësuar gjatë zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2001. Parregullsitë elektorale mund të kenë prekur shpërndarjen e vendeve në parlament, por jo aq sa të ndryshonte radhitja se cila parti kishte dalë e para dhe që partia opozitare të bënte bojkotimin e zgjedhjeve. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) ka monitoruar dhe rapotuar mbi zgjedhjet në Shqipëri që në vitin 1996.[167] Për rezultatet elektorale shih Pasqyrën 35 Zgjedhjet në Shqipëri.

Parlamenti Shqiptar (Kuvendi Populllor) është i përbërë nga 140 deputetë të zgjedhur për katër vite. Ai ka autoritetin që të zgjedhë Presidentin e Republikës; të miratojë kandidatin për Kryeministër, të rishikojë dekretet presidenciale; të miratojë emërimin për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të largoje gjykatësit nga Gjykata Kushtetuese; të emërojë Prokurorin e Përgjithshëm; të bëjë rishikime të Kushtetutës; të miratojë ligje që ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare, etj. Ai funksionon në përputhje me rregulloret e miratuara nga shumica e të gjithë deputetëve. Mbledhjet e Parlamentit (seancat plenare dhe punimet e Komisioneve) janë të hapura për publikun. Administrata parlamentare varet prej Kryetarit dhe Kryesisë së Parlamentit. Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është kryetari i përgjithshëm.

Organi operativ drejtues i Parlamentit është Kryesia, e cila përfshin: Kryetarin, zëvendësit e tij dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Kuvendi Populllor zgjedh komisionet e përhershme dhe gjithashtu krijon komisione të posaçme. Sot ka 13 komisione: Bujqësia dhe Ushqimi; Çështjet Ligjore dhe Kushtetuese; Mbrojtja; Ekonomia, Financa dhe Privatizimi; Arsimi, Kultura, Shkenca dhe Sporti; Politika e Jashtme dhe

Praktikisht, ka një mungesë të besueshmërisë publike në sistemin gjyqësor dhe është shpesh e pamundur të gjendet një dëshmitar, qoftë edhe për krimet më serioze. Shtetasit kanë frikë të deklarojnë ankesat dhe rastet e dyshimta.

Burimi: Masat Anti-Korrupsion në Evropën Juglindore

Marrëdhëniet Ndërkombëtare; Të drejtat e Njeriut dhe Minoritetet; Imuniteti, Mandatet dhe Rregullorja; Industria, Transporti, Punët Publike dhe Tregtia; Problemet e Punës dhe ato Sociale; Shëndeti Publik dhe Mbrojtja Mjedisore; Informimi Publik (Mass Media); Rendi Publik dhe Siguria Kombëtare.

SISTEMI JURIDIK: Studime të ndryshme empirike të kryera nga viti 1998 deri në vitin 2002 i rendisin gjyqtarët dhe sistemin gjyqësor ndër tre sektorët më të korruptuar (Doganat, Gjykatat, Zyrat e Taksave), sipas perceptimit të njerëzve që punojnë në administratë publike dhe publikut

Ligjet Kryesore lidhur me Administratën Publike dhe Pushtetin Lokal[170]

- Ligji për Prokurimin Publik, 1995
- Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Bashkiake/Të Komunës, 1997
- Ligji për Sistemin e Taksave në Republikë, 1998
- Ligji për Planifikimin Urban, 1998
- Ligji për Buxhetin Lokal, 1998
- Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, 1999
- Ligji për organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal, korrik 2000
- Ligji për Ndarjen Administrative Territoriale, 2000
- Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë së Tiranës, 2000
- Ligji për Pronësinë Shtetërore të Paluajtshme, 2001
- Ligji për Transferimin e Pronësive Publike Shtetërore të Paluajtshme tek Pushteti Lokal, 2001

të përgjithshëm. Një raport i Shteteve të Bashkuara, i vitit 2001 shkruante: "Sistemi juridik është joefiçent dhe subjekt i korrupsionit. Presionet ekzekutive mbi gjyqësorin vijojnë, por kanë rënë pak. Ka ankesa për gjyqtarët e pakualifikuar dhe joprofesionalë dhe ka të dhëna të besueshme për gjyqtarë të kërcënuar, apo që

[166] Zëri i të Rinjve, UNICEF, 2001.
[167] http://www.osce.org/odihr/documents/reports/election_reports/al/

u jepen ryshfete nga kriminelët e fuqishëm".[168]

Plani Antikorrupsion i jep rëndësi këtij sektori, megjithëse ka akoma shumë për të bërë. Raste të thjeshta janë zgjatur shpesh për muaj, në vend të disa javëve, ligjet e reja nuk zbatohen gjithmonë nga ana e gjyqtarëve dhe shumë gjykatës nuk janë të vëmendshëm për çështjet e të drejtave e njeriut. Vendimi i shumë partive politike për të përdorur gjyqet për kundërshtimin e vendimeve të KQZ gjatë zgjedhjeve Parlamentare të 2001, tregoi besim të përmirësuar, por gjyqtarët nuk hetuan totalisht parregullsitë në Lushnjë. Në vitin 2000 janë bërë apele gjyqësore të 4555 çështjeve civile.[169]

DECENTRALIZIMI: Decentralizimi po kërkohet me forcë nga komuniteti ndërkombëtar dhe nga disa aktorë, brenda Shqipërisë, të cilët e konsiderojnë decentralizimin si një çelës të zhvillimit demokratik të vendit, si një mënyrë për të sjellë më afër shërbimet ndaj komunitetit ndërkombëtar, për të përmirësuar kontrollin demokratik/përfshirjen qytetare, për të arritur kursime, mundësisht për të ulur korrupsionin dhe për ta çliruar qeverisjen qendrore për t'u marrë me përpunimin e politikave. Për më tepër, kontrolli lokal mund të çojë në garantimin e shërbimeve më të mira dhe të balancuara, të cilat mund të zvogëlojnë presionin e migrimit.

Rreziqet e lidhura me procesin përfshijnë mundësinë që cilësia e kushteve të shërbimit publik mund të bjerë nëse pushteti lokal është i papërgatitur, nuk ka burimet njerëzore të nevojshme, nuk ka burime të nevojave financiare dhe i mungon vullneti politik. Meqë Raporti i Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së, 2002, përqëndrohet në decentralizimin, ky seksion jep vetëm një vështrim të shkurtër. Shih Pasqyrën 32: Përgjegjësitë Lokale të Synuara për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike.

Qeveria e Shqipërisë ka një Komitet Kombëtar për Decentralizimin (KKD) dhe ka të zyrtarizuar me dekret Qeveritar, Strategjinë Kombëtare për Decentralizim dhe Autonominë Lokale, të hartuar nga Grupi i Ekspertëve për Decentralizimin (GED). Viti 2002 është viti i tretë i zbatimit të kësaj strategjie. Në vitin 2001 Qeveria deklaroi se: "decentralizimi është harmonizuar dhe integruar me strategjitë dhe veprimtaritë e tjera të Qeverisë, sikurse Kuadri i Shpenzimeve Afat- Mesme

Për qëllime të qeverisjes lokale, territori i Shqipërisë është i ndarë në: 12 prefektura/ rajone, 65 bashki dhe 309 komuna. 65 nga 74 qytetet e shpallura zyrtarisht të Shqipërisë kanë bashki. Bashkitë ndahen në lagje me të paktën 15.000 banorë dhe bashkitë rurale janë ndarë në fshatra me të paktën 200 banorë. Komunat, zakonisht rurale, janë të ndara në fshatra dhe disa herë në qytete.

(MTEF), Strategjia e Rritjes Ekonomike dhe Uljes së Varfërisë, e gjithashtu dhe strategjitë e sektorëve".

ZYRTARËT PUBLIKË: Reformimit i Administratës Publike dhe Shërbimit Civil i është dhënë përparësi, në mënyrë që të përmirësohet efiçenca dhe profesionalizmi, të pakësohet qëndrimi partiak dhe të rritet besimi te Qeveria. Numri i punonjësve të Administratës Qëndrore Publike[171], në mesin e vitit 2001, ishte

Siguria e punës e nëpunësve civilë është përmirësuar për shkak të zbatimit më të mirë të ligjit mbi Statusin e Nëpunësit Civil dhe përmirësimit të funksionimit të Komisionit të Nëpunësve Civilë. Mënyra e punësimit e përfshirë në këtë ligj ka rritur pjesën e Nëpunësve Civilë të punësuar mbi bazën e kualifikimit të tyre. Ministritë duhet të bëjnë publike vendet bosh dhe të ngrenë komisione me përfaqësues nga Administrata Publike, bota akademike dhe shoqëria civile. Aplikantët i nënshtrohen një testi të shkruar, pa i njohur pyetjet paraprakisht dhe rezultatet vlerësohen në mënyrë anonime. Kandidatët në listën e shkurtër më pas merren në intervistë me gojë. Komiteti voton për tre kandidatë, për t'u radhitur dhe paraqitur Ministrit, i cili mendohet se do të përcaktojë dikë nga lista. Përndryshe, një Ministër mund të emërojë dikë, por vetëm maksimalisht për 6 muaj me kontratë të përkohshme.

124,590, 3.66% të popullsisë[172]. Numri i Punonjësve Civilë të Administratës Qëndrore[173] ishte 1.017, me një shtesë 1.811 punonjësish civilë në administratën lokale[174], për një total

[168] Raporti i vendeve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut-2000: Shqipëri, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2001: http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2000/eur/668pf.htm
[169] Komunikimi direkt me Ministrinë e Drejtësisë ,2001
[170] Qeveria Lokale ne Shqiperi, 2001
[171] Duke përjashtuar ushtrinë, shërbimin mjekësor, arsimin dhe nivelin lokal
[172] Monitorimi i Treguesve të Funksionimit Institucional: Projekti PAR Shqipëri, 2001
[173] Në Këshillin e Ministrave, Ministrive, Zyrës së Presidentit dhe Kuvendin Popullor
[174] Në bashki, rrethe dhe rajone

prej 2.27% të punësimit publik[175].

Avokati i Popullit (Ombudsman), i krijuar në vitin 1999, është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga veprimet e padrejta brenda Administratës Publike. Një përmirësim në nivelin e pagave hyri në fuqi në Janar 2002 për gjykatësit dhe nëpunësit civilë, ndërsa punonjësit e shëndetësisë presin një rritje shumë shpejt.

MEDIA: Liria e fjalës është garantuar në nenin 22 të Kushtetutës së vitit 1998, neni 23 garanton të drejtën për informacion, kodi penal ndëshkon shpifjet dhe përgojosjen e figurave publike dhe ekziston një Kod Etike, por media priret të jetë e njëanshme dhe militante për atë çfarë ajo raporton duke e përzgjedhur ose trillon fakte dhe merr shumë nga informacionet e saj prej partive politike. Media e shkruar Shqiptare ndonjëherë përdor "gjuhën e urrejtjes", që pasqyron një atmosferë të kundërshtive politike, dhe jo mungesën e tolerancës fetare apo etnike. Ekzistojnë disa gazeta të minoriteteve. Ligji i vitit 1998 për Median Elektronike krijoi Këshillin Kombëtar të Radios dhe TV; ky ligj parandalon partitë politike, Shtetin dhe grupet fetare në krijimin e TV ose Radiostacioneve private.

Ratifikimi nga Shqipëria i Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut në 1995, u bën të mundur qytetarëve shqiptarë, të cilëve u janë shkelur këto të drejta, duke përfshirë edhe lirinë e të shprehurit, ta paraqesin çështjen e tyre në Strasburg, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gazetaria hetimore ka filluar të shfaqet, si psh. mbi korrupsionin. Shumë gazetarë janë relativisht të rinj. 37% e shqiptarëve kanë një televizor dhe 93% e shqiptarëve shohin televizor çdo ditë. Televizioni pasohet për popullaritetin nga radioja (57% dëgjojnë çdo ditë) dhe gazeta (21% lexojnë çdo ditë)[176]. Shih Pasqyrën 34 Qarkullimi i Medias së Shtypur.

SHOQËRIA CIVILE: Shoqëria Civile përfshin shumë forma të kapitalit shoqëror dhe Organizata të Shoqërise Civile (CSO), por ky seksion do të përqendrohet tek OJQ-të. Sektori i OJQ-ve është rritur me shpejtësi gjatë 10 viteve të fundit, duke patur një bum gjatë krizës së Kosovës. Ekziston një regjistër Kombëtar për OJQ-të brenda Sistemit Gjyqësor dhe Ligji i 2001-it mbi Organizatat Jo-fitimprurëse, përmiresoi kuadrin ligjor, por trajtimi dhe këshillimi për problemet ligjore te OJQ-ve është përqendruar në Tiranë. Vlerësimet mbi numrin e OJQ-ve varion gjerësisht dhe vetëm 1/5 e 500 OJQ të marra shembull në një studim të QShKE ishin sporadikisht aktive. Shoqëria Civile është duke u rritur, por ende nuk është në gjendje të balancojë dhe monitorojë në mënyrë të pavarur dhe efektivisht pushtetin e Qeverisë dhe të kontribuojë rregullisht në vendim-marrje. Një rrjet i qendrave financiare të OJQ-ve është ngritur në rajone të ndryshme të Shqipërisë për të mbështetur OJQ-të.

8.2.2 ANALIZË

INSTITUCIONET DEMOKRATIKE: Shqipëria ka shpenzuar dekadën e kaluar duke ndërtuar institucione demokratike: vëmendja tani duhet të përqendrohet në funksionimin e tyre, që duhet të rrisë besimin e publikut në institucione dhe dëshirën për të marrë pjesë lirisht. Institucionet zyrtare përkatëse përfshijnë legjislativin, Sistemin Gjyqësor, Komisionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatin e Popullit, etj,. Institucionet jozyrtare përfshijnë median, Shoqërinë Civile, sindikatat, partitë politike etj. Debati duhet të përqendrohet rreth problemeve të tilla si: cilësia shtetit ligjor; stimujt dhe mjedisi menaxherial në të cilin veprojnë nëpunësit civilë; pushteti i shoqërisë civile si një balancë ndaj kontrollit qeveritar; perceptimet publike të legjimitetit të shtetit, sjellja e zyrtarëve të lartë ndaj korrupsionit, përgjegjësia dhe transparenca; rregulla dhe praktika të shpërndarjes së informacionit dhe struktura ekonomike përfshirë natyrën e centralizuar të pushtetit ekonomik. Parlamenti i të Rinjve, i cili do të mbulojë përgjithësisht 12 Prefektura që nga shtatori 2002, u ofron të Rinjve një shans në vendim-marrje dhe në perceptimin e rolit që ata kanë për të luajtur në zhvillimet e Shqipërisë.

Parlamenti Shqiptar (Kuvendi Popullor) ende nuk e ka fituar kapacitetin e tij të synuar për realizimin e rolit të tij kushtetues në një mënyrë efektive dhe të frytshme. Ai duhet të harmonizohet me publikun që të sigurojë se vendimet që ai merr, janë të përshtatshme për interesat e segmenteve të ndryshme të popullit shqiptar. Anëtarët e Parlamentit Shqiptar ndeshen me vështirësi në përmbushjen e funksioneve të tyre ligjore, të mbikqyrjes dhe përfaqësuese. Anëtarët e Parlamentit nuk i kuptojnë plotësisht rolin e tyre, përgjegjësitë dhe veprimet parlamentare dhe duhet të kenë njohuri më të gjera rreth çështjeve për të cilat

[175] Monitorimi i Treguesve të Performancës Institucionale: Projekti PAR Shqipëri, 2001
[176] Vrojtime të KAPB mbi Njohuritë, Metodat, Praktikat dhe Besimet/Mendimet, 2001.

ata janë thirrur për të bërë ligjet. Personeli parlamentar ka nevojë për më tepër mjete dhe burime intelektuale, në mënyrë që të sigurojë një mbështetje të frytshme për Anëtarët e Parlamentit. Metoda e punës së parlamentit, duke përfshirë organizimin dhe funksionimin e sekretariatit, ka nevojë të rishikohet. Është e qartë që Parlamenti, si një institucion demokratik i ri ka nevojë për mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar, por një mbështetje e tillë nevojitet që të jepet në një mënyrë te koordinuar për ndikim maksimal, duke ndihmuar vendosjen e shtetit ligjor dhe qeverisjen e mirë.

SISTEMI GJYQËSOR: Sistemi gjyqësor shqiptar ndesh pengesa të mëdha, duke përfshirë zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe bashkëpunimin me policinë.[177] Rritja e Pagës në Janar 2002 ishte një hap përpara. Vonesat e mëdha në procedimet gjyqësore shkaktohen shpesh kur avokatët, të pandehurit, prokurorët ose dëshmitarët nuk paraqiten në gjyq[178]. Strukturat e një sistemi drejtësie ekzistojnë tashmë, problemi qëndron në mbrojtjen transparente të zbatimit të ligjit. Reformimi i gjyqtarëve dhe i ligjeve dhe shërbimeve të tjera të rendit është një kërkesë e rëndësishme për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë, së bashku me forcimin e Shoqërisë Civile dhe kuadreve legjislative. Përparësi në sistemin gjyqësor duhet të jenë forcimi i pavarësisë, profesionalizmi, legjislacioni, si dhe roli i Zyrës së Inspektimit të Lartë Juridik.

DECENTRALIZIMI: Pengesat e ndeshura deri tani, përfshijnë burimet njerëzore dhe transferimin jo të vazhdueshëm të pushtetit dhe të burimeve.

Ka mungesë të njerëzve të kualifikuar në nivelin lokal, për të kryer përgjegjësitë e reja. Decentralizimi, po dëmton kapacitetin e Qeverisë Lokale në përgjithësi dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në veçanti, për zbatimin e reformave. Kjo kërkon përfshirjen e një numri më të madh të të arsimuarve dhe të kualifikuarve. Pak njerëz të arsimuar kanë mbetur në zonat rurale, kështu që mbështetja e qeverisjes lokale do të jetë një sfidë e madhe. Vullneti politik është gjithashtu një shqetësim në të dy krahët dhe detyrat ndonjëherë delegohen pa shoqërimin e decentralizimit fiskal, duke e bërë qeverinë lokale të paaftë për të zbatuar përgjegjësi të reja.

Dobësitë në gjyqësor çojnë në korrupsion dhe vijnë prej:

- **Influencës politike në emërimet dhe shkarkimet e gjyqësorit;**
- **Arsimit të dobët ligjor, duke përfshirë arsimin juridik;**
- **Pagave të ulëta;**
- **Procedurave dhe teknikave të dobëta gjyqësore dhe të trajtimit të rasteve;**
- **Mungesës së personelit gjyqësor të trajnuar;**
- **Infrastrukturës fizike të papërshtatshme;**
- **Dhe mungesës së mundësisë për të përdorur informacionin ligjor më të fundit.**

Burimi: Shqipëri, Raporti i Vendit, SELDI, http://www.seldi.net/albania_index.htm

ZYRTARËT PUBLIKE: Shpresohet që punësimi i njerëzve i bazuar në kualifikimin e tyre, duke përmirësuar shpërblimin e tyre financiar dhe duke i garantuar për sigurinë e punës së tyre, do të çojë në një rritje të përkushtimit dhe një vullneti të madh për t'u ruajtur nga sjellja e korruptuar. Ndryshimet e mëdha të nëpunësve publikë pas zgjedhjeve, veçanërisht që prej vitit 1992, kur u pastruan shumë zyrtarë të ish administratës komuniste, dobësuan rëndë standardet e funksionimit. Zyrtarët kanë sigurim të ulët pune dhe paguhen më pak se punonjësit në sektorin privat dhe Shoqërinë Civile.

MEDIA: Media vuan nga një mungesë fondesh për veprimet e përditshme dhe investime, nga mungesa e teknologjisë moderne jashtë Tiranës, kushte të këqija pune dhe paga të ulta, trajnim i pakët, një mungesë gazetarësh analistë ekonomikë, të ardhura të vogla reklamash në zonat rurale dhe varësia nga bizneset dhe partitë politike për mbështetje financiare direkte dhe indirekte. Infrastruktura e rrugëve është në gjendje shumë të keqe. Kjo e bën më të vështirë shpërndarjen e medias së shtypur në zonat rurale dhe shumica e njerëzve nuk kanë mundësi të abonohen. Gazetarët kërkojnë vetë-rregullim, por kjo nuk ka të ngjarë të arrijë sukses nëse gazetarët nuk çlirohen prej kërkesave të drejtuesve dhe botuesve të gazetës së tyre. Partitë politike favorizojnë disa kanale lajmesh, duke u treguar përkrahësve të tyre se ku t'i vendosin reklamat e tyre dhe qeveria përdor kanalet e preferuara të lajmeve për të reklamuar aktivitetet e korporatave shtetërore.

SHOQËRIA CIVILE: Edhe pse të përqendruara në Tirane, OJQ ka edhe në qytete të tjera të vendit. Komunitetet rurale nuk mund

[177] Raporti gjashtëmujor i UNDCP, 2001.
[178] Sistemet Juridike dhe e Drejta e Njeriut në Rajonin e OSCE, në 2001, IHF, Prill 2002 http://www.ihf-hr.org/reports/Warsaw%202002%20Report.pdf

të presin që shteti të rregullojë situatën e tyre; problemet e tyre nuk mund të kapërcehen pa bashkëpunimin e organizatave vullnetare jo-qeveritare dhe bizneseve të komuniteteve, fermerët, bizneset bujqësore, etj. Përfitimet nga bashkëpunimi mund të jenë organizimi, komunikimi, projekte dhe zgjidhje të përbashkëta. Tashmë ekzistojnë me qindra shoqata rurale, pjesa më e madhe e të cilave janë shoqata të përdoruesve të ujit (SHPU), por shumë fshatra nuk kanë ende ndonjë organizatë dhe kanë një nivel të ulët të mirëkuptimit në lidhje me nevojën për organizim dhe burime të përbashkëta. Shoqatat e bizneseve rurale kanë tendencë të jenë më të qëndrueshme sesa shoqatat e fermerëve. OJQ-të rurale përballen me tre probleme kryesore: vështirësi për të bindur njerëzit që të bëhen anëtarë të shoqatës; mungesa e infrastrukturës kufizon aktivitetin e tyre dhe ata nuk kanë burime të mjaftueshme financiare, përderisa anëtarët i shohin kontributet më shumë si dhurata sesa si detyrë. OJQ-të rurale kanë nevojë të shkëmbejnë informacion dhe të bashkëpunojnë më shumë me njëra-tjetrën, për shembull duke përdorur OJQ-të "çadër".

Konflikti i interesave ka një ndikim të madh për mungesën e pavarësisë së Shoqërisë Civile, siç shihet nga anëtarët e bordit në Shoqërinë Civile, qeveri dhe biznesin privat, që mund të pengojnë kritikat dhe të kalojnë fondet në drejtim të klientëve të preferuar.

OJQ-të në përgjithësi kanë nevojë për krijim të aftësive nga pikëpamja e menaxhimit, krijimit të koalicioneve dhe grupeve mbështetëse. Shumë OJQ janë të varura nga fonde të huaja të financimit dhe shpesh nuk kanë zyra dhe pajisje. Shpesh mediat shqiptare nuk u referohen OJQ-ve si burime informacioni. Ato kanë një antarësim të vogël dhe kanë mungesë të përgjegjësisë dhe shumë OJQ funksionojnë në një mënyrë nga lart-poshtë.

Shpesh OJQ-të bashkëpunojnë me partitë politike. Arsyeja më e madhe e dobësisë së shoqërisë civile është humbja e përgjithshme e besimit brenda shoqërisë Shqiptare dhe diskreditimi i të ashtuquajturave aktivitete vullnetare me pjesëmarrje të detyruar.

8.2.3 REKOMANDIME

INSTITUCIONET DEMOKRATIKE

- Përsa u përket zgjedhjeve, raporti i 2001 i OSCE/ODIHR thekson dy probleme kryesore.[179] I pari është që zgjedhjet duhet të mbahen vetëm në një raund, për të shmangur problemet e shkaktuara nga raundet e shumta, siç u pa nga eksperienca e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2001. I dyti, të rishikohen dhe përmirësohen ligji i zgjedhjeve dhe infrastruktura. Shembuj të masave specifike që duhet të ndermerreshin janë: kutitë dhe fletët e votimit të jenë më të sigurta dhe të transportohen më shpejt, qendrat e votimit mund të monitoroheshin me kamera dhe Qeveria mund të parandalonte ndërhyrjet e panevojshme të anëtarëve të shërbimit policor dhe atij të fshehtë.
- Në lidhje me Parlamentin Shqiptar (Kuvendi Popullor), nevojitet që Kuvendi të forcojë kapacitetin e tij dhe të përqendrohet te mënyrat e përmirësimit të ekspertizës dhe njohurive të Anëtarëve të Parlamentit dhe personelit parlamentar në mënyrë që (a) Të rrisë cilësinë e legjislacionit, rolin mbikëqyrës e përfaqësues të parlamentit; (b) Të nxisë ndërveprim më të gjerë ndërmjet Parlamentit dhe elektoratit, duke i dhënë më shumë publicitet punimeve të Parlamentit; (c) Të nxisë lidhje më të ngushta midis Parlamentit dhe shoqërisë, me një theks të veçantë në rolin e parlamentit në buxhet dhe procesin e uljes së varfërisë; (d) Të përmirësojë aftësinë e personelit për të siguruar shërbime me cilësi të lartë ndaj deputetëve; dhe (e) Të nxisë përdorimin e teknologjisë së re informative e të komunikimit; etj.

SISTEMI GJYQËSOR

- Kombet e Bashkuara duhet të mbështesin përpjekjet që po bën Qeveria në këto fusha të përcaktuara nga SELDI:[180] Publikimi dhe shpërndarja e informacionit ligjor; forcimi i pavarësisë juridike; përgatitja e Kodit të Etikës për gjykatësit; forcimi i mekanizmave zyrtarë dhe të drejtë të detyrimit; rritja e njëtrajtshmërisë së projektligjeve; përmirësimi i nivelit bazë të arsimimit bazë dhe të mëtejshëm për magjistraturën; përmirësimi i kapacitetit institucional dhe programit të Fakultetit të Drejtësisë; eliminimi i vonesave të qëllimta në procedimet gjyqësore që inkurajojnë ryshfetin; eliminimet e vonesave të qëllimta në procedimet gjyqësore, që inkurajojnë ryshfetin; përcaktimi dhe zbatimi i sanksioneve për gjyqtarët, të cilët qëllimisht vonojnë çështjet gjyqësore pa ndonjë arsye ligjore; dhe permirësimi i infrastrukturës fizike të gjykatave.
- Të monitorohet dhe mbështetet ndarja e prerë e pushtetit të ekzekutivit nga ai i gjyqësorit.
- Të vazhdohet forcimi i Zyrës së Inspektimit Gjyqësor.

[179] http://www.osce.org/odihr/documents/reports/election_reports/al/alb_june2001_efr.php3
[180] Raporti i Vendit, Shqipëri, http://www.seldi.net/albania_2.htm

DECENTRALIZIMI

- Të përpunohen e të shihen të tjera plane për reforma të qeverisjes lokale.
- Të mbështetet zbatimi i decentralizimit duke ndihmuar për probleme si përgatitja e burimeve njerëzore lokale.
- Të mbështeten kanalet e rregullta dhe transparente të komunikimit ndërmjet njësive të qeverisjes lokale për të diskutuar zbatimin e decentralizimit dhe ecurinë e të drejtave dhe detyrave të qeverisjes lokale.

ZYRTARËT PUBLIKË

- Të vazhdojnë përpjekjet për të sqaruar përgjegjësitë, dhënien e llogarisë dhe autoritetin e zyrtarëve të institucioneve publikë dhe të rritet dallimi midis statutit politik dhe atij civil.
- Te përmirësohet transparenca, duke rritur mundësinë e shtetasve për informacion.
- Ndërtimi i kapacitetit dhe asistenca teknike janë tepër të nevojshme në shumë departamente, por donatorët duhet të jenë të kujdesshëm me trajnimet, sipas një plani të përbashkët të përgatitur nga Qeveria, në mënyrë që të shmangin dyzimet e kota të përpjekjeve apo mosmarrëveshjeve për metodologjinë që do të përdoret.

MEDIA

- Mediat duhet të gjejnë mënyra që të veprojnë si një biznes profesional i pavarur nga influencat e partive politike, ndërhyrjet dhe klanet. Vetëm atëherë kualifikimi dhe standardet e etikës luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së mediave.
- Qeveria duhet të heqë dorë nga përdorimi i fondeve publike për të influencuar median.
- Ekziston një hapësirë për bashkëpunim ndërmjet medias dhe OJQ-ve për të luftuar korrupsionin dhe abuzimin e të drejtave të njeriut dhe për të monitoruar aktivitetin e Qeverisë.
- Reporterët duhet të bëhen më të ndjeshëm për çështjet e dhunës së brendshme dhe trafikimin e grave dhe fëmijëve, në vend që të vijojnë me stereotipat dhe të përbuzin viktimat.

ORGANIZATAT JO-QEVERITARE

- Punësimi i personelit lokal është më i mirë sesa varësia totale te konsulentët e huaj, por punësimi i personelit lokal mundet gjithashtu të dobësojë institucionet lokale ekzistuese, kështu që komuniteti ndërkombëtar duhet të marrë në konsideratë të punojë më shpesh me këto insitucione dhe fuqizimin e tyre.
- Duhet pranuar se ato programe ndërkombëtare, të cilat nuk shfrytëzojnë OJQ-të lokale, rrallë lënë pas shumë njerëz të përgatitur ose kapacitete kur programet përfundojnë.
- Duhet pranuar se politika e disa donatorëve ndërkombëtarë për të mënjanuar marrëdhëniet me OJQ-të të cilat kanë filluar punë, në mënyrë që të nxisin OJQ-të e reja, mund të shkaktojnë një "uri" në fondet e OJQ-ve të themeluara dhe ndonjëherë të shkaktojnë mbylljen e tyre.
- Në disa raste, OJQ-të e reja në fillimet e tyre nuk kanë aftësi për t'iu përgjigjur kërkesave dhe proçedurave të donatorëve ndërkombëtarë. OJQ –të e njohura mund t'i ndihmojnë, përkrahin dhe të ndërtojnë aftësitë e OJQ-ve të reja, duke luajtur rolin e ndërmjetësve me donatorët ndërkombëtare në partneritet.
- Të rritet aftësia dhe marrja e informacionit nga OJQ-të në zonat urbane dhe rurale jashtë Tiranës, duke ngritur më shumë qendra burimore OJQ-sh, që bëjnë të mundur shërbimet e mëposhtme ndaj OJQ-ve: informacion për kuadrin ligjor të OJQ-ve, mundësitë për t'u specializuar brenda dhe jashtë Shqipërisë, mundësitë financiare; përkrahjen për të ndërtuar marrëdhënie me OJQ-të shqiptare të konsoliduara dhe ato ndërkombëtare, kualifikim për menaxhimin e OJQ-ve; trajnime në hartimin e propozimeve; dhe monitorim, vlerësim dhe raportim.
- Programe të vogla donacionesh mund të shfrytëzohen për t'i drejtuar fondet përmes këtyre qendrave drejt OJQ-ve jashtë Tiranës. Menaxhimi i fondeve mund të kryhet nga qendrat e burimeve dhe duhet të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe i hapur me kandidatë të paaprovuar paraprakisht.
- Donatorët duhet t'i inkurajojnë OJQ-të që të kryejnë aktivitete përfituese tregtare e ekonomike të lejuara nga ligji i ri, në mënyrë që të kompesojnë uljen e fondeve të huaja dhe të shkojnë drejt vetë-mbështetjes ose vetë-financimit, në të ardhmen. Donatorët mund të sigurojnë " fonde fillestare" për t'i aftësuar OJQ-të që të fillojnë aktivitetin ekonomik.
- OJQ-të duhet të përpiqen të përfshijnë më shumë rininë, veçanërisht në drejtimin e brendshëm të tyre.
- Komunitetet rurale duhet të përfitojnë nga edukimi për të mirat e nismave të kooperimit në shoqërinë demokratike dhe OJQ-të ekzistuese rurale kanë nevojë të trajnohen

për t'u ndeshur me sfidat dhe metodat alternative të zhvillimit të një OJQ-je, bashkë me shkëmbimin më të mirë të informacionit dhe rrjetit të punës.

- Kombet e Bashkuara dhe donatorët e tjerë duhet të rrisin përgjegjësitë dhe të zvogëlojnë korrupsionin në sektorët e OJQ-ve, duke kërkuar dhe siguruar ndërtimin e kapaciteteve për kontrollin e OJQ-ve, nëpërmjet kontrollit jo të plotë dhe duke bërë verifikim në vend (Për shembull (a) të verifikojë nëse një OJQ realisht i paguan pagat e punonjësve të saj ose nënkontraktorët në përputhje me kontratën, ose (b) të zbulojë nëse vrojtuesit e punësuar janë me të vërtetë duke plotësuar një pyetësor përfaqësues apo i plotësojnë vetë pyetësorët).
- Qeveria dhe Kombet e Bashkuara duhet të konsultohen rregullisht me forumet e OJQ-ve rurale dhe shoqatat, disa nga të cilat mund të ofrojnë ekspertizë profesionale mbi temat e specializuara të zhvillimit. Këto marrëdhënie konsultuese kanë nevojë të institucionalizohen, dhe jo të jenë sporadike dhe të kota.

9 Përfundime

